REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ", GJIROKASTËR
FAKULTETI EKONOMIK
NJËSIA BAZË E POLITIKAVE EKONOMIKE DHE TURIZMIT

# RAPORTI I VLERËSIMIT TË BRENDSHËM

## Programi i Studimit të Ciklit të Dytë "Master Profesional" në Turizëm

Grupi i Vlerësimit të brendshëm:

1. Prof. Asoc. Lorenc Koçiu (Kryetar)
2. Prof. Asoc. Enkela Caca (Anëtar)
3. Dr. Irena Boboli (Anëtar)
4. Dr. Daniela Qiqi (Anëtar)
5. Elja Peshkëpia (Studente) (Anëtar)

Shtator, 2023

Adresa: Lagjia 18 Shtatori
Rruga « Studenti », Gjirokastër
Tel:+355 (842) 63 408
E-mail: rektori@uogj.edu.al
Web site: www.uogj.edu.al

REPUBLIKA E SHQIPERISE
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR

# PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË BRENDSHËM

Universiteti "Eqrem Çabej", Gjirokastër është themeluar në vitin 1971 dhe është një institucion i rëndësishëm i Arsimit të Lartë në vend, për arsye të eksperiencës shumë vjeçare. Në vitin1996 u krijua Departamenti Ekonomik i cili fillimisht ofronte programin 4-vjeçar të studimit "Ekonomist në Kontabilitet-Financë, më tej "Ekonomist në Administrim Publik" dhe në vitin 2005 filloi të ofronte programin e studimit "Ekonomist në Turizëm". Në vitin 2015, Departamenti Ekonomik u riorganizua në Fakultet Ekonomik me tre Njësi bazë të cilat aktualisht ofrojnë Programe Studimi të ciklit të parë Bachelor, ciklit të dytë Master Profesional dhe Master Shkencor, Progame me karakter professional 2-vjeçare dhe për vitin akademik 2023-2024, do të ofrohen edhe dy programe të përbashkëta në ciklin e parë "Bachelor" me Universitetet italiane të Molises dhe Salentos.

Njësia Bazë e Politikave Ekonomike dhe Turizmit (NJBPET) është një nga tre Njësitë Bazë të Fakultetit Ekonomik (FE). Ajo është përgjegjëse dhe ofron Programin e studimit "Bachelor" në Turizëm, "Master Profesional" në Turizëm, Progamin 2-vjeçar me karakter professional "Asistent menaxher në shërbimet turistike" dhe për vitin akademik 2023-2024, është miratuar nga MAS Programi i studimit "Bachelor" në "Diplomë e Dyfishtë në Menaxhim i Turizmit të Qëndrueshëm" me Universitetin e Molises. NJBPET ka një staf akademik të kualifikuar dhe të përkushtuar i cili kontribuon jo vetëm në formimin e profesionistëve të së ardhmes në fushën e turizmit, por edhe në formimin e studentëve si anëtarë të denjë të komunitetit e mbarë shoqërisë.

Mbështetur në Ligjin 80/2015, ky program studimi është i përfshirë në proçesin e akreditimit, në përputhje me Standardet Shtetërore të Cilësisë dhe Kodin e Cilësisë në Arsimin e Lartë. Grupi vlerësimit të brendshëm ka realizuar vlerësimin e këtij programi studimi duke analizuar VI fusha kryesore:

I. Ofrimi i programit të studimit dhe përputhshmëria e tij me interesat kombëtare, misionin dhe vizionin e njësisë kryesore dhe bazë;
II. Mënyra e organizimit, drejtimit dhe administrimit të programit të studimit në përputhje me bazën ligjore në fuqi;
III. Niveli i mësimdhënies e mësimnxënies, vlerësimit të studentëve dhe kompetencat e fituara prej tyre (metodat dhe praktikat) që sigurojnë arritjen e rezultateve;
IV. Mbështetja e programit të studimit me burimet e nevojshme njerëzore, financiare, infrastrukturore dhe logjistike për realizimin e tij;
V. Politikat dhe proçedurat që ndiqen për mbështetjen e studentëve;
VI. Sigurimi i cilësisë së programit të studimit.

Nga analiza e kryer për vlerësimin e brendshëm të cilësisë, Grupi i Vlerësimit konkludon që programi i ofruar në ciklin e parë të studimeve Bachelor në "Turizëm", përmbush plotësisht standardet në të gjashtë fushat, pra ai përmbush plotësisht standardet për t'u akredituar.
Nga analiza e kryer për vlerësimin e brendshëm të cilësisë, Grupi i Vlerësimit konkludon që programi i ofruar në ciklin e parë të studimeve "Bachelor në Turizëm", përmbush plotësisht standardet në të gjashtë fushat, pra ai përmbush plotësisht standardet për t'u akredituar.

## PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË BRENDSHËM;

Procesi i vlerësimit të brendshëm për programin e studimit të Ciklit të Parë "Bachelor" në Turizëm ka nisur me propozim të Njësisë bazë Politikave Ekonomike dhe Turizmit, si njësi përgjegjëse e këtij programi për akreditim. Ky aplikim është kryer nga Koordinatorja institucionale në sistemin AMS në datën 14.12.2023 dhe është përcjellë zyrtarisht pranë ASCAL me shkresën nr. 1685 prot datë 15.12.2022. ASCAL me shkresën nr. 117/1 prot, datë 06.03.2023 "Konfirmim i aplikimit për akreditimin e 20 programeve të studimit", ka konfirmuar aplikimin e UGJ dhe nëpërmjet sistemit AMS është dërguar Axhenda e fazës së vlerësimit.

Bazuar në sa më lart, u ngrit GVB me vendim nr. 26 datë 28.09.2023 bazuar në propozimin e drejtuesit të njësisë bazë të Politikave Ekonomike dhe Turizmit dhe Vendimin Nr 04, datë 13.04.2023 të Dekanit të Fakultetit Ekonomik me përbërje si më poshtë:

1. Prof. Asoc. Lorenc Koçiu (Kryetar)
2. Prof. Asoc. Enkela Caca (Anëtar)
3. Dr. Irena Boboli (Anëtar)
4. Dr. Daniela Qiqi (Anëtar)
5. Elja Peshkëpia(Studente) (Anëtar)

Grupi mori pjesë në trajnimin me përfaqësuesit të ASCAL të zhvilluar në datën 11. 09.2023, ku u njoh me procedurat, dokumentacionin, aspekte e këshilla të tjera të nevojshme për realizimin e procesit.

Në hartimin e raportit grupi i punës ka patur si qëllim të përshkruajë e të nxjerr në pah përmbushjen e standarteve të cilësisë, sipas përcaktimeve të Kodit të Cilësisë miratuar me vendimin nr. 824, datë 24.12.2021.

Ky raport është produkt i një procesi gjithëpërfshirës që ka si qëllim sigurimin e një vlerësimi sa më korrekt dhe të matshëm të përmbushjes së standarteve dhe garantimit të cilësisë së programit të studimit.

Ky Raport Vlerësimi i Brendshëm (RVB) për programin e ciklit të parë të studimit "Bachelor në" Turizëm, është përgatitur nga grupi i vlerësimit të brendshëm, i ngritur me Vendim Dekani, shkresa Nr 14 Prot, dt.13.04.2023, "Për miratimin e grupeve të vlerësimit të bendshëm, për akreditimin e programeve të studimit në Fakultetin Ekonomik", në përputhje me dispozitat ligjore të MAS, ASCAL dhe Statutin e UGJ-së.

Grupi përbëhet nga anëtarë me grada dhe tituj shkencorë, të cilët janë përzgjedhur mbi bazën e aftësive dhe kompetencave të tyre profesionale lidhur me mësimdhënien, kërkimin shkencor dhe administrimin e informacionit. Ata janë persona me integritet dhe të aftë për të analizuar në mënyrë të paanëshme dokumentacionin dhe informacionin e nevojshëm për kryerjen e proçesit të akreditimit. Anëtare e grupit është edhe një studente në përputhje me kuadrin përkatës ligjor.

Për realizimin e këtij procesi vlerësimi, GVB është bazuar në kërkesat ligjore të Ligjit Nr. 80/2015 "Për arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", aktet ligjore e nënligjore përkatëse, udhëzimet dhe manualet e ASCAL-it, Statutin, Rregulloret dhe Vendimet e Senatit Akademik të UGJ-së. Procesi ka kaluar në disa faza duke filluar me ndarjen e detyrave dhe përgjegjësive midis anëtarëve të

grupit, grumbullimin analizën e shkëmbimin e informacioneve, në nivel institucioni, fakulteti, njësie bazë dhe vlerësimin e dokumentacionit ekzistues që lidhej me plotësimin e kritereve për çdo fushë vlerësimi. Objektivi kryesor i GVB ishte arritja e përfundimeve objektive dhe reale në funksion të vlerësimit të cilësisë të këtij programi studimi. Në raportin e hartuar janë përfshirë të gjitha gjetjet, të cilat janë pasqyruar sipas rubrikave në secilën prej fushave sipas modelit të hartuar nga ASCAL në përputhje me kërkesat ligjore për sigurimin e cilësisë në IAL-të. Pra, RVB është i strukturuar në gjashtë fusha me standardet dhe kriteret përkatëse, mbi bazën e të cilave, referuar dhe në dokumentacionin mbështetës faktik, është bërë vlerësimi i përmbushjes të standardeve të cilësisë ndaj programit të ofruar. Raporti shoqërohet edhe me Listën e Evidencave mbështetëse për çdo vlerësim të kritereve dhe çdo fushë të vlerësuar.

## Lista e shkurtimeve

| | |
|---|---|
| **UGJ** | **Universiteti i Gjirokastrës** |
| **FE** | **Fakulteti Ekonomik** |
| **NJBPET** | **Njësia Bazë e Politikave Ekonomike dhe Turizmit** |
| **MAS** | **Ministria e Arsimit dhe Sportit** |
| **MASH** | **Ministria e Arsimit dhe Shkencës** |
| **SA** | **Senati Akademik** |
| **NJSBC** | **Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë** |
| **SSCK** | **Sektori i Standarteve të Cilësisë dhe Kurrikulave** |
| **BA** | **Bordi i Administrimit** |
| **DSHNA** | **Drejtoria e Shërbimeve Ndihmëse dhe Administrative** |
| **QSHA** | **Qendra e Shërbimeve Arsimore** |
| **RASH** | **Rrjeti Akademik Shqiptar** |
| **AADF** | **Albanian -American Development Foundation** |

REPUBLIKA E SHQIPERISE · UNIVERSITETI "E. ÇABEJ" GJIROKASTËR

Adresa: Lagjia 18 Shtatori
Rruga « Studenti », Gjirokastër
Tel:+355 (842) 63 408
E-mail: rektori@uogj.edu.al
Web site: www.uogj.edu.al

## Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master Profesional në "Turizem"

## I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT

| Standardi I.1<br>**Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare, si dhe në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të tij.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare. | Universiteti 'Eqrem Çabej, Gjirokastër (UGJ), ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare. Këto programe studimi synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.<br>Institucioni synon të jetë model i arsimit të lartë publik, të arrijë standarte cilësore në fushën akademike dhe të përgatisë profesionistë të zotë sipas programeve përkatëse të studimit, të rritë cilësinë e kërkimit në fushat prioritare të kërkimit shkencor, teknologjisë dhe inovacionit, të jetë qendër e rëndësishme e zhvillimit të qëndrueshëm të Rajonit Jugor .<br>Institucioni ka si mision: të krijojë, të zhvillojë, të përcjellë dhe të mbrojë dijet përmes mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe shërbimeve, si edhe të formojë specialistë të lartë dhe shkencëtarë të rinj; të ofrojë mundësi për të përfituar nga arsimi gjatë gjithë jetës; të kontribuojë në zhvillimin ekonomik, social dhe kulturor në nivel kombëtar dhe rajonal, si dhe në forcimin e sigurisë publike dhe kombëtare; të kontribuojë në rritjen e standarteve të demokracisë e të qytetërimit të shoqërisë dhe në përgatitjen e studentëve për një shoqëri të tillë **[Evidenca I.1 Statuti i Universitetit "Eqrem Çabej", Gjirokastër, Neni 2, Neni 3, Neni 5, Neni 8]**. |
| **Kriteri 2.** Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë. | Programet e studimeve hartohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e UGJ-së, të shprehura në Statutin e UGJ-së **[Evidenca I.1 Statuti i Universitetit "Eqrem Çabej", Gjirokastër, Neni 4, Neni 5, Neni 8]**, në Strategjinë e zhvillimit te UGJ-së **[Evidenca I.2 Strategjia e zhvillimit të Universitetit të Gjirokastrës 2020-2025, Misioni, fq 8, Vizioni fq 8]**, në Strategjinë e Zhvillimit të Fakultetit Ekonomik (FE) **[Evidenca I.3 Strategjia e zhvillimit të Fakultetit Ekonomik, Misioni & Vizioni fq 5]**.<br>Edhe programi i studimit Master Profesional në "Turizëm" **[Evidenca I.4. Urdhri i hapjes se Programit te Studimit Master Profesional ne Turizëm]** është plotësisht në përputhje me vizionin dhe misionin e UGJ-së si dhe me fushën e veprimtarisë së tij.<br>Programi i studimit Master Profesional në "Turizëm" synon të ofrojë një formim të thelluar profesional në sektorët kryesorë të turizmit, i cili do të shërbejë për studentët e diplomuar në këtë program studimi qoftë në aspektin e punësimit, qoftë si bazë për të vazhduar kualifikimin e mëtejshëm në programe të tjera të studimeve në këtë degë apo programe të tjera përkatëse integruese **[Evidenca I.5. Rregullore Mësimore e Programit të Studimit Master Profesional në Turizëm, Neni 3]**. |
| **Kriteri 3.** Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit dhe në përputhje me fushat e drejtimet | Programi i studimit Master Profesional në Turizëm është hartuar dhe ofrohet në zbatim të strategjisë së zhvillimit së Universitetit **[Evidenca I.2. Strategjia e zhvillimit të Universitetit të Gjirokastrës 2020-2025, Misioni, fq 8, Vizioni fq 8]**, të Statutit të UGJ-së **[Evidenca I.1 Statuti i Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastër, Neni 62, Neni 63, Neni 66]** dhe Rregullores së UGJ-së **[Evidenca I.6 Rregullore e Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastër, Neni** |

| | |
|---|---|
| akademike së Institucionit. | **42, Neni 46, Neni 50, pika 1 dhe 3]** si dhe me fushat e drejtimet akademike të UGJ-së.<br>Programi është hartuar në përputhje me misionin e UGJ-së që është, të krijojë, zhvillojë, të përcjellë dhe të mbrojë dijet përmes mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe shërbimeve, të formojë specialiste të lartë dhe shkencëtarë të rinj; të ofrojë mundësi për të përfituar nga arsimi i lartë gjatë gjithë jetës; të kontribojë në zhvillimin ekonomik social dhe kulturor në nivel kombëtar dhe rajonal, të kontribojë në rritjen e standardeve të demokracisë e qytetërimit të shoqërisë dhe në përgatitjen e studentëve për një shoqëri të tillë **[Evidenca I.1 Statuti i i Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastër, Neni 5]**.<br>Programi i studimit Master Profesional në "Turizëm" synon të ofrojë një formim të thelluar profesional në sektorët kryesorë të turizmit, i cili do të shërbejë për studentët e diplomuar në këtë program studimi qoftë në aspektin e punësimit, qoftë si bazë për të vazhduar kualifikimin e mëtejshëm në programe të tjera të studimeve në këtë degë apo programe të tjera përkatëse integruese **[Evidenca I.5. Rregullore Mësimore e Programit të Studimit Master Profesional në Turizëm, Neni 3]**. |
| **Kriteri 4.** Programi i studimit hartohet e zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe prirjet globale të zhvillimit mbështetur në dokumentacionin përkatës vendas dhe atë ndërkombëtar. | Zhvillimet social-ekonomike në vendin tonë gjatë viteve të fundit, diktojnë nevojën e përgatitjes të specialistëve të aftë për tregun e punës në nivel kombëtar, rajonal apo ndërkombëtar. Në Shqipëri, sektori i turizmit bazuar dhe në Strategjinë Kombëtare për Zhvillimin e Qëndrueshëm të Turizmit 2019-2023, konsiderohet si një nga sektoret prioritare të zhvillimit të vendit. Programi i studimit "Master Profesional" në Turizëm, ka si qëllim të ofrojë një formim të thelluar profesional dhe synon të kontribuojë në arritjen e një zhvillimi të qëndrueshëm të ekonomisë shqiptare dhe më specifikisht të industrisë turistike, duke përgatitur specialistë të fushës, të aftë për të zbatuar me sukses strategjitë dhe politikat e turizmit të qëndrueshëm **[Evidenca I.5. Rregullore Mësimore e Programit të Studimit Master Profesional në Turizëm, Neni 3]**.<br>Misioni i UGJ-se përqëndrohet në qëllimin kryesor, që lidhet me nevojën për ndryshim e transformim dhe për krijimin e kapaciteteve reale për shoqërinë. UGJ-ja do të vazhdojë të jetë qendër e fuqishme për arsimin dhe kërkimin shkencor të orientuar nga tregu i punës, nga reformat social ekonomike dhe nga standartete e reja të integrimit europian **[Evidenca I.2. Strategjia e zhvillimit të Universitetit të Gjirokastrës 2020-2025, Misioni, fq 8, Vizioni fq 8]**. |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| **Standardi I.2**<br>**Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Institucioni demonstron se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë. | UGJ-ja është një Institucion i Arsimit të Lartë i kategorisë Universitete, themeluar në vitin 1971 **[Evidenca I.7 Vendimi i hapjes se ILP-se; Evidenca I.8 Vendimi mbi krijimin e Universitetit Eqrem Çabej Gjirokastër]**.<br>UGJ-ja ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike për ofrimin e programit "Master Profesional" në Turizëm **[Evidenca I.9 Vendim i Akreditimit Institucional periodik]**. |
| **Kriteri 2.** Fusha e përgjithshme | Programi i studimit Master Profesional në Turizëm është program i nivelit 7 |

| | |
|---|---|
| dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. | sipas Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve dhe është hartuar në përputhje me misionin e UGJ-së **[Evidenca I.1 Statuti i Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastër, Neni 5, Neni 63]**.<br>Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit Master Profesional në Turizëm është në përputhje me fushën akademike e kërkimore të Fakultetit Ekonomik **[Evidenca I.3 Strategji e zhvillimit të Fakultetit Ekonomik, Misioni, Vizioni dhe prioritete strategjike, fq 5-6]** dhe me fushën akademike kërkimore dhe shkencore të personelit akademik mësimdhënës në këtë program studimi.<br>NJBPET, bazuar në nenin 86 të ligjit nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" dhe Vendimin Nr. 310, datë 11.5.2022 "Për Specifikimet dhe Përmbajtjen e Kodifikimit të Programeve të Studimit të Ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë të Republikën e Shqipërisë" të Keshillit të Ministrave ka propozuar kodifikimin kombëtar të programit të studimit Master Profesional në Turizëm dhe është në pritje të aprovimit nga Ministria e Arsimit, Sportit (MAS). **[Evidenca I.10 Përcjellja në MAS e propozimeve për kodifikimin e programeve; Evidenca I.10.1 Pasqyrimi i propozimeve për kodifikimin e programeve të FE]**. |
| **Kriteri 3.** Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje. | Programi i studimit Master Profesional në Turizëm është program i nivelit 7 sipas Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve dhe është hartuar në përputhje me misionin e UGJ-së **[Evidenca I.1 Statuti i Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastër, Neni 5, Neni 63]**.<br>Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit "Master Profesional" në Turizëm është në përputhje me fushën akademike e kërkimore të Fakultetit Ekonomik **[Evidenca I.3 Strategji e zhvillimit të Fakultetit Ekonomik, Misioni, Vizioni dhe prioritete strategjike, fq 5-6, I.3.2 Strategji e Zhvillimit 2020-2025 NJBPET, Misioni, Vizioni dhe Prioritete strategjike fq.4]** dhe me fushën akademike kërkimore dhe shkencore të personelit akademik mësimdhënës në këtë program studimi.<br>Në Statutin e UGJ-se përcaktohen njësitë kryesore dhe njësitë bazë të UGJ-së, si dhe në Rregulloren e UGJ-së përcaktohet organizimi i brendshëm, NJBPET është një nga njësitë bazë të FE-së **[Evidenca I.1 Statuti i Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastër, Neni 11; Evidenca I.6 Rregullore e Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastër Neni 5]**.<br>Programi "Master Profesional" në Turizëm nuk është program ndërdisiplinor. |
| **Kriteri 4.** Në rastet kur institucioni ofron program "Master profesional" në një drejtim specifik, jashtë profilit të institucionit, cilësia e tij garantohet nga institucionet partnere. | Për programin "Master Profesional" në Turizëm nuk ka nje drejtim specifik jashtë profilit të institucionit.. |
| **Kriteri 5.** Institucioni i arsimi të lartë ofron trajnime profesionale të mëtejshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit. | UGJ ofron trajnime të mëtejshme profesionale për studentët, bashkëpunon me partnerë dhe mundëson pjesmarrjen e studentëve në takime të ndryshme me kompani e punëdhënës, trajnime, workshop-e etj **[Evidenca II.21.1 Informacion nga Zyra e Alumnit dhe Këshillimit të Karrierës]**.<br>Impact Week është një aktivitet shumë i rëndësishëm i cili këtë vit u organizua në UGJ, në partneritet me operatorë ndërkombetarë dhe lokalë dhe pjesmarrjen e përfaqesuesve të biznesit. Stafi dhe studentë të UGJ-së ishin pjesë e trajnimeve nga trajnerë ndërkombetarë **[Evidenca II.26 Impact Week 2023, Gjirokastra, Albania]**. |



Gjeshkëpijey

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | Një tjetër bashkepunim i rëndësishëm është ai me Ambasadën e SHBA-së në Shqipëri dhe Naron Travel Albania në kuadër të programit Ambassadors Fund for Summer Work and Travel, ku studentë të UGJ-së janë pjesmarrës për të dytin vit rradhazi. Gjatë qëndrimit në USA studentët do të punojnë dhe do të jenë pjesmarrës në aktivitete të ndryshme. **[Evidenca II.24 Work and Travel].** | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | **X** |

| **Standardi I.3**<br>**Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimit profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësive përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre. | Për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programeve të studimit, marrëdhëniet e bashkëpunimit brenda institucionit rregullohen përmes Statutit dhe Rregullores së UGJ-së dhe janë në zbatim të Ligjit Nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë". Veprimtaria e UGJ -së drejtohet e kontrollohet nga autoritetet dhe organet drejtuese të saj, që veprojnë sipas hierarkisë, me kompetenca të përcaktuara në Ligjin e arsimit të lartë, në Statut, në Rregullore dhe në aktet e brendshme vetërregulluese të institucionit **[Evidenca I.1 Statuti i Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastër, Kreu II, III, IV, dhe V; Evidenca I.6 Rregullore e Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastër, Kreu II, III, IV dhe V].**<br><br>NJBPET siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit **[Evidenca I.1 Statuti i Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastër, Neni 10, Neni 47; Evidenca I.11 Organograma e Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastër; Evidenca I.12 Organograma e Fakultetit Ekonomik; Evidenca I.13 Organograma Njësisë bazë të Politikave Ekonomike dhe Turizmit].**<br><br>Veprimtaria akademike, ndihmës akademike dhe administrativo-financiare e institucionit, pasqyrohet në raportet vjetore institucionale **[Evidenca I.14. Raporti vjetor Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastër viti akademik 2019-2020; Evidenca I.14.2 Raporti vjetor Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastër viti akademik 2020-2021; Evidenca I.14.4 Raporti vjetor Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastër viti akademik 2021-2022].**<br><br>NJBPET për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit të studimit, siguron marrëdhënie bashkëpunimi brenda institucionit mes Fakultetit Ekonomik, Fakultetit të Shkencave të Natyrës dhe Fakultetit të Edukimit dhe Shkencave Shoqërore, si dhe brenda Njësisë Kryesore me Njësinë Bazë të Kontabilitet Financës dhe Njësinë bazë të Administrimit Publik **[Evidenca I.15 Tabela treguese e angazhimit të personelit akademik, lëndët dhe ngarkesa përkatëse, Evidenca I.16 Praktike bashkepunimi me Fakultetin e Edukimit dhe Shkencave Shoqërore].** |
| **Kriteri 2.** Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni | Institucioni ka të përcaktuara qartë, në strategjinë e zhvillimit të tij institucional, prioritetet e politikës së tij të bashkëpunimit **[Evidenca I.2. Strategjia e zhvillimit të Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastër 2020-2025, Lidhjet** |


Geshkëpijey

| | |
|---|---|
| vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj. | **komunitare dhe kombëtare fq.31, Roli Ndërkombëtar fq. 32]**. UGJ, realizimin me sukses të misioneve të tij e lidh ngushtësisht dhe me procesin e ndërkombëtarizimit, i vlerësuar si një dimension prioritar për zhvillimin **[Evidenca I. 17 Strategjia e UGJ për Ndërkombëtarizimin]**.<br>Këto prioritete reflektohen në marrëveshjet e bashkëpunimit me universitete të tjera kombëtare dhe ndërkombëtare si dhe me institucione lokale, kombëtare dhe ndërkombëtare **[Evidenca I.18 Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit të Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastër; Evidenca I.19 Lista e projekteve të Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastër; Evidenca I.20 Lista e mobiliteteve të Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastër]**. Nëpërmjet marrëveshjeve, sigurohen marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi ku përfitues janë studentët dhe personeli akademik. Aktivitetet e kryera në kuadër të marrëveshjeve të bashkëpunimit, pasqyrohen edhe në raportet vjetore institucionale. **[Evidenca I.14. Raporti vjetor Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastër viti akademik 2019-2020; Evidenca I.14.2 Raporti vjetor Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastër viti akademik 2020-2021; Evidenca I.14.4 Raporti vjetor Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastër viti akademik 2021-2022]**. |
| **Kriteri 3.** Për realizmin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj,dhe bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, për realizimin e kërkimeve shkencore dhe mobilitetit të personelit akademikt dhe studentëve. | UGJ ka një sërë marrëveshje bashkëpunimi me aktorë dhe partnerë të ndryshëm të sektorit publik dhe atij privat. Nëpërmjet marrëveshjeve, sigurohen marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi ku përfitues janë studentët dhe personeli akademik **[Evidenca I.18 Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit të Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastër]**.<br>Praktikat profesionale zhvillohen në terren, në institucione ekonomike, në ndërmarrje shtetërore ose private, sipas profilit të përgatitjes së studentit dhe nën drejtimin e pedagogeve të caktuar nga departamenti përkatës **[Evidenca II.6 Rregullore e Fakultetit Ekonomik, Neni 29]**.<br>UGJ ka një sërë marrëveshje bashkëpunimi me IAL brenda dhe jashtë vendit si dhe institucione publike dhe jopublike në vend. Si rezultat i këtyre marreveshjeve me universitete të huaja janë realizuar mobilitete për stafin akademik dhe studentët në kuadër të programeve Erasmus+. Gjatë periudhës 2020-2023, u është mundësuar studentëve të FE, të zhvillojnë mësim një semestër në universitete të huaja. Gjatë kësaj periudhe ka patur dhe mobilitete të stafit akademik **[Evidenca I.20 Lista e mobiliteteve të Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastër]**. |
| **Kriteri 4.** Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit. | NJBPET në kuadër të marrëveshjeve të bashkepunimit në funksion të realizimit të programit të studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga këto marreveshje. Këto të dhëna pasqyrohen edhe në raportet e veprimtarisë mësimore-kërkimore vjetore të NJBPET **[Evidenca I.14.12 Raport vjetor i veprimtarisë mësimore-kërkimore NJBPET 2019-2020, I.14.13 Raport vjetor i veprimtarisë mësimore-kërkimore NJBPET 2020-2021, I.14.14 Raport vjetor i veprimtarisë mësimore-kërkimore NJBPET 2021-2022]**. |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| **Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

REPUBLIKA E SHQIPËRISË UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR



Gjeshkëpije

## II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË

| **Standardi II.1**<br>**Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatore.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, veprimtaritë formuese, të vlerësuara në kredite, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). | Programi i studimit Master Profesional në Turizëm është një program studimi i ciklit të dytë. Forma e studimeve është me kohë të plotë dhe gjuha e mësimdhenies është gjuha shqipe.<br>Programi i studimit Master Profesional në Turizëm është i organizuar në lëndë mësimore, në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Ky program ka kohëzgjatje normale 2(dy) vite akademike/4 (katër) semestra dhe një total prej 120 ECTS. **[Evidenca II.1 Rregullore e studimeve në "Eqrem Çabej", Neni 13, pika 3; Evidenca I.5 Rregullore Mësimore e Programit të Studimit Master Profesional në Turizëm, Nenet, 1 dhe 6; Evidenca II.2 Plan mësimor Master Profesional në Turizëm 2021-2022].**<br>Elementet e programit të studimit Master Profesional në Turizëm janë në përputhje të plotë me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 41, datë 24.01.2018, "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë", Vendimin Nr. 879, datë 18.12.2019 "Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin Nr. 41, datë 24.1.2018, të Këshillit të Ministrave, "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë" dhe Vendimin Nr. 185, datë 25.3.2021 Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin Nr. 41, datë 24.1.2018, "Për Elementet e Programeve të Studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë", të Ndryshuar **[Evidenca II.3 VKM Nr. 41, datë 24.01.2018; Evidenca II.3.1 VKM Nr. 879, Datë 18.12.2019; Evidenca II.3.2 VKM Nr. 185, datë 25.03.2021].** Në përfundim të këtij programi studimi, studentit i jepet diplomë "Master Profesional" në Turizëm **[Evidenca II.1 Rregullore e studimeve në UGJ, Neni 13, pika 3, germa b; Evidenca I.5 Rregullore Mësimore e Programit të Studimit Master Profesional në Turizëm, Neni 6; Evidenca II.4 Model diplome Master Profesional në Turizëm].** |
| **Kriteri 2.**Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionesh e specialitetesh, jep njohuri të përparuara në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuara në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale. | Qëllimi i programit të studimit Master Profesional në Turizëm është të ofrojë një formim të thelluar profesional në sektorët kryesorë të turizmit, i cili do të shërbejë për studentët e diplomuar në këtë program studimi qoftë në aspektin e punësimit, qoftë si bazë për të vazhduar kualifikimin e mëtejshëm në programe të tjera të studimeve në këtë degë apo programe të tjera përkatëse integruese **[Evidenca I.5 Rregullore Mësimore e Programit të Studimit Master Profesional në Turizëm, Neni 3].**<br>Në programin "Master Profesional" në Turizëm janë përfshirë lëndë të cilat i pajisin studentët me njohuri të thelluara teorike dhe praktike duke synuar të zgjerojnë njohuritë e fituara në ciklin e parë të studimeve. Nëpërmjet veprimtarive formuese, **[Evindenca II.2 Plani mësimor Master Profesional në Turizëm 2021-2022; Evidenca II.5 Programet lëndore (syllabuset) të Programit të studimit Master Profesional në Turizëm 2022-2023]** të parashikuara në planin mësimor studentët pajisen me njohuri bashkekohore të cilat janë të nevojshme për studime më të thelluara dhe i shërbejnë formimit të aftësive dhe kompetencave akademike ose profesionale, të nevojshme për t'ju përgjigjur sa më mirë kërkesave të tregut të punës. |

Adresa: Lagjia 18 Shtatori
Rruga « Studenti », Gjirokastër
Tel:+355 (842) 63 408
E-mail: rektori@uogj.edu.al
Web site: www.uogj.edu.al



Qeshkëpijej

| | |
|---|---|
| | Objektivat formuese të këtij programi synojnë:<br>- përgatitjen e plotë profesionale të studentëve si specialistë të turizmit për të gjitha subjektet private dhe publike;<br>- fitimin e njohurive të thelluara në fushën e turizmit si specialistë të aftë për të zbatuar me sukses strategjitë dhe politikat e turizmit të qëndrueshëm;<br>- aftësimin e studenteve për t'u integruar me sukses në drejtimin dhe funksionimin me sukses të të gjitha sipërmarrjeve në industrinë turistike;<br>- aftësimin e studentëve për të hartuar dhe menaxhuar produkte cilësore turistike;<br>- marrjen e njohurive të zgjeruara në lidhje me tregjet turistike kombëtare dhe ndërkombëtare.<br>**[Evidenca I.5. Rregullore Mësimore e Programit të Studimit Master Profesional në Turizëm, Neni 3].** |
| **Kriteri 3.** Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse. | Programi Master Profesional në "Turizëm" në përputhje të plotë me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 41, datë 24.01.2018, "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë", Vendimin Nr. 879, datë 18.12.2019 "Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin Nr. 41, datë 24.1.2018, të Këshillit të Ministrave, "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë" dhe Vendimin Nr. 185, datë 25.3.2021 Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin Nr. 41, datë 24.1.2018, "Për Elementet e Programeve të Studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë", të Ndryshuar **[Evidenca II.3 VKM Nr. 41, datë 24.01.2018; Evidenca II.3.1 VKM Nr. 879, Datë 18.12.2019; Evidenca II.3.2 VKM Nr. 185, datë 25.03.2021]**, në planin mësimor të tij përmban zhvillim të praktikës së detyruar profesionale 12 kredite/ 300 orë.<br>Plani mësimor i programit të studimit Master profesional në Turizëm si dhe Rregullorja e Programit të Studimit Master Profesional në Turizëm përcaktojnë qartë detyrimet përmbyllëse.<br>Bazuar në Rregulloren e UGJ-se, **[Evidenca I.6 Rregullore e Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastër, Neni 93, pika 1]**, Rregulloren e FE-së **[Evidenca II.6 Rregullore e Fakultetit Ekonomik, Neni 39, pika 1, pika 2]** dhe Rregulloren e Programit të Studimit në Master Profesional në Turizëm **[Evidenca I.5 Rregullore Mësimore e Programit të Studimit Master Profesional në Turizëm, Neni 11]** studentët e ciklit të dytë të studimeve Master Profesional në Turizëm diplomohen me provim të përgjithshëm përfundimtar ose punim diplomë dhe përfaqësojnë 18 kredite-15% të numrit total të krediteve **[Evidenca II.2 Plan mësimor Master Profesional në Turizëm 2021-2022]**. Me fillimin e semestrit të parë të vitit të dytë të studimeve të tij, studenti që do të mbrojë punim diplome zgjedh një pedagog udhëheqës. Ai, në bashkëpunim me të, përcakton fillimisht temën e punimit të tij. Udhëheqësi është anëtar i stafit akademik të departamentit që organizon programin, ose pedagog i ftuar i angazhuar në programin e studimit.<br>Në lidhje me modalitetet e mbrojtjes së punimit referimi bëhet tek Rregullorja e Brendshme e Universitetit dhe Rregullorja e Brendshme e Fakultetit Ekonomik **[Evidenca I.5 Rregullore Mësimore e Programit të Studimit Master Profesional në Turizëm, neni 11].** |
| **Kriteri 4.**Programet e ciklit të dytë "Master" në Mësuesi, që formojnë mësues të arsimit fillor janë plotësim i ciklit të parë Master Profesional në arsimin Fillor. Programet Master në Mësuesi për formimin e mësuesve të arsimit të mesëm të ulët dhe të lartë | Programi Master Profesional në "Turizëm" nuk është program i ciklit te dytë në "Mësuesi" |

REPUBLIKA E SHQIPERISE - UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" - GJIROKASTËR



Geshkepija

| | |
|---|---|
| organizohen si programe të ciklit të dytë të studimeve "Master", sipas fushave përkatëse të formimit. | |
| **Kriteri 5.**Programet "Master" në fushën e mësuesisë organizohen me 120 kredite dhe duhet të përmbajnë 25 për qind të krediteve në shërbim të formimit të përgjithshëm psiko-pedagogjik. Programet "Master", që formojnë mësues të së njëjtës fushë të mësuesisë, duhet të kenë së paku 80 për qind të kurrikulës me përmbajtje të ngjashme. | Programi Master Profesional në "Turizëm" nuk ështe program i ciklit të dytë ne "Mësuesi" |
| **Kriteri 6.**Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara në kuadrin ligjor të ministrisë përgjegjëse për arsimin. | Forma e organizimit të studimeve në programin e studimit Master Profesional në Turizëm është studime me kohë të plotë **[Evidenca II.1 Rregullore e Studimeve në Universitetin "Eqrem Çabej" Gjirokastër, Neni 8; Evidenca I.5 Rregullore Mësimore e Programit të Studimit Master Profesional në Turizëm, Neni 7].**<br>Rregullorja e UGJ-se dhe Rregullorja e Programit të studimit Master Profesional në Turizëm përmbajnë të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, dhe ekuivalentimit të studimeve **[Evidenca I.6 Rregullore e UGJ, neni 51, neni 61, neni 65; Evidenca II.1 Rregullore e studimeve në UGJ, Kreu VI; Evidenca II.6 Rregullore e FE, Neni 18; Neni 30; Neni 31; Evidenca I.5 Rregullore Mësimore e Programit të Studimit Master Profesional në Turizëm, Neni 5].**<br>Modelet e financimit të studentëve përfshijnë financimin nëpërmjet bursave dhe financimin nëpërmjet përjashtimit nga tarifat e studimit. Financimi bëhet për dy kategori. Financimi për studentët me rezultate të shkëlqyera dhe financimi i studentëve përfitues sipas kritereve të tjera të vendosur me aktet nënligjore. Në fillimin e çdo viti akademik, realizohen procedurat përkatëse, sipas vendimit të Bordit të Administrimit UGJ-së **[Evidenca II.7 Vendimet e Bordit te Administrimit për bursat dhe mbështetje për kategoritë e veçanta; 2020-2023].** |
| **Kriteri 7.** Programet e studimit, të ciklit të dytë Master, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind. | Program i studimit "Master profesional" në Turizëm referuar programeve të studimit Master Profesional, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, cikël si dhe me të njëjtën emërtesë në Universitetet publike në Shqipëri nuk ka përmbajtje të ngjashme në masën 70 për qind. |
| **Kriteri 8.**Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit. | NJBPET bazuar në nenin 86 të Ligjit Nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" dhe Vendimin Nr. 310, datë 11.5.2022 "Për Specifikimet dhe Përmbajtjen e Kodifikimit të Programeve të Studimit të Ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë të Republikën e Shqipërisë" të Këshillit të Ministrave ka propozuar kodifikimin kombëtar të programit të studimit master Profesional në Turizëm dhe është në pritje të aprovimit nga Ministria e Arsimit dhe Sportit **[Evidenca I.10 Percjellja ne MAS e propozimeve për kodifikimin e programeve; Evidenca I.10.1 Pasqyrimi i propozimeve për kodifikimin e programeve FE].**<br>Më tej do të propozohet dhe kryhet kodifikimi i lëndëve të programit. |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Kriteri 9.** Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi. | NJBPET përgjegjëse për programin e studimit Master Profesional në Turizëm synon në të ardhmen edhe hartimin e programeve të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe/ose të huaj. | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | **X** |

| **Standardi II.2**<br>**Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin. | FE dhe NJBPET, përmbushin detyrimet ligjore për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike, vlerësim dhe akreditim.<br>Fakulteti Ekonomik është hapur me Urdher te MAS Nr.126, datë 20.03.2017 **[Evidenca II.8 Urdhër për hapjen e FE].**<br>NJBPET është njësia bazë përgjegjëse e punës mësimore, kërkimore dhe shkencore për realizimin e Programit te Studimit Master Profesional në "Turizëm dhe është riorganizuar me vendim Senati Akademik, Nr.3, dt. 11.06.2015 **[Evidenca II.9 Riorganizimi i departamentit ekonomik].**<br>Fakulteti Ekonomik **[Evidenca I.1 Statuti i Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastër, Neni 11; Evidenca II.6 Rregullore e Fakultetit Ekonomik, Neni 5]** përbëhet nga 3(tre) njesi baze: Njësia Bazë e Politikave Ekonomike dhe Turizmit; Njësia Bazë e Kontabilitet-Financës, Njësia Bazë e Administrimit Publik, të cilat, bazuar në Nenin 25 të Ligjit Nr. 80/2015 të Arsimit të lartë , kanë në përbërjen e tyre të paktën shtatë anëtarë, të punësuar me kohë të plotë, si personel akademik, nga të cilët të paktën tre me grada shkencore / tituj akademike, personel ndihmës akademik me karakter administrativ si dhe personel ndihmes akademik me karakter mesimor **[ANEKS-TABELAT PËRMBLEDHËSE-(Tabela 1)].** Njesitë bazë në Fakultetin Ekonomik nuk janë të organizuara në grupe mësimore **[II.9.1 Urdhër për organizimin e njësive bazë dhe të grupeve mësimore]..**<br>Programi i Studimit Master Profesional në Turizëm është hapur me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 795, datë 062.10.2010 **[Evidenca I.4. Urdhri i hapjes së Programit të Studimit Master Profesional në Turizëm].** NJBPET përbëhet prej 7(shtate) anëtarë personel akademik efektiv nga të cilët 2 (dy) mbajnë titullin Prof.asoc.Dr., 2(dy) janë me titullin/gradën shkencore Dr., 3(tre) janë me gradën shkencore Msc, si dhe 1(një) personel ndihmës akademik me karakter mësimor me gradën shkencore Msc duke përmbushur në këtë mënyrë kërkesat ligjore për funksionimin e kësaj njësie bazë **[ANEKS-TABELAT PËRMBLEDHËSE-(Tabela 2)].**<br>Programi i Studimit Master Profesional në "Turizëm" është riorganizuar sipas vendimeve të mëposhtme:<br>• Vendim Senati Akademik Nr. 16, datë 23.10.2018 **[Evidenca II.10 Vendim Rektorati për riorganizimin e planeve mësimore 2018-2019]**<br>• Vendim Senati Akademik Nr. 17, datë 08. 07. 2021 **[Evidenca II.2.1 Vendim SA për riorganizimin e planeve mësimore 2021-2022]** |

| | |
|---|---|
| | UGJ-ja ka marrë akreditimin periodik institucional me Vendim Nr.55, datë 16.12.2021 të Bordit të Akreditimit të ASCAL. **[Evidenca I.9 Vendim i Akreditimit Institucional periodik]** |
| **Kriteri 2.** Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj. | Fakulteti Ekonomik/ NJBPET përgjegjëse për programin e studimit Master Profesional në Turizëm përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi [Ligji Nr. 80/2015 i Arsimit të Lartë, Neni 25, pika 4], duke angazhuar 1(nje) personel ndihmës akademik me karakter mësimor, për realizimin e punëve laboratorike **[Evidenca I.13 Organograma NJBPET; Evidenca II.12 Rregullore per punësimin dhe përzgjedhjen e stafit akademik dhe atij administrativ në Universitetin "Eqrem Çabej" Neni 7, Neni 8, Neni 9; ANEKS-TABELAT PËRMBLEDHËSE- (Tabelat 1 dhe 2)].** |
| **Kriteri 3.** Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij. | Roli i koordinatorit për programin e studimit Master Profesional në Turizëm mbulohet nga përgjegjëssi i njësisë bazë, i cili është autoriteti drejtues akademik i saj **[Evidenca II.6 Rregullore e Fakultetit Ekonomik, Neni 11; Evidenca II.13 Rregullore e Njësisë bazë të Politikave Ekonomike dhe Turizmit, Neni 5, Neni 6 pika 1 dhe 5].**<br>Përgjegjësi i departamentit drejton e kontrollon punën mësimore-shkencore në departament; miraton komisionet e provimeve si dhe tezat e tyre; i propozon dekanit komisionet e mbrojtjes së diplomave; drejton punën për diskutimin e ligjëratave dhe teksteve mësimore; miraton programet e lëndëve përkatëse dhe ndjek planifikimin e aktiviteteve shkencore; analizon çdo vit realizimin e detyrave të punës mësimore-shkencore të personelit akademik; propozon në Dekanat për të ftuar personel akademik për periudha semestrale ose një vjeçare të përsëritshme sipas nevojave të departamentit; përgatit shpërndarjen e ngarkesës mësimore që miratohet në Departament; ushtron kontrolle për cilësinë e mësimdhënies; propozon masa administrative dhe disiplinore sipas rregulloreve të miratuara dhe të akteve ligjore e nënligjore ndaj personelit deri në lirimin nga detyra dhe studentëve deri në përjashtimin nga Universiteti **[Evidenca II.13 Rregullore e Njësisë bazë të Politikave Ekonomike dhe Turizmit, Neni 6, pika 5; Evidenca I.14.12 Raport vjetor i veprimtarisë mësimore-kërkimore NJBPET 2019-2020; I.14.13 Raport vjetor i veprimtarisë mësimore-kërkimore NJBPET 2020-2021; I.14.14 Raport vjetor i veprimtarisë mësimore-kërkimore NJBPET 2021-2022].** |

| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| Standardi II.3<br>**Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të dytë, disponon informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit. | FE/ NJBPET përgjegjëse për programin e studimit Master Profesional në Turizëm, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e këtij programi. Programi i studimit në përputhje me Ligjin e Arsimit të Larte 80/2015, me Vendimin Nr. 41, datë 24.1.2018 "Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë", Vendimin Nr. 879, Datë 18.12.2019 "Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin Nr. 41, datë 24.1.2018, të Këshillit të Ministrave, "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë", me |

| | |
|---|---|
| | Vendimin Nr. 185, datë 25.3.2021 Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin Nr. 41, datë 24.1.2018, "Për Elementet e Programeve të Studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë", të Ndryshuar si dhe me Statutin **[Evidenca I.1 Statuti i Universitetit Eqrem Çabej, Neni 66, pika 1, 3, 4 dhe 6]** dhe Rregulloren e Universitetit **[Evidenca I.6 Rregullore e UGJ, Neni 50, pika 1 dhe 3, Neni 66]** disponon:<br>• Rregulloren e Njësisë Bazë te Politikave Ekonomike dhe Turizmit **[Evidenca II.13 Rregullore e Njësisë bazë të Politikave Ekonomike dhe Turizmit ]**<br>• Rregulloren e programit të studimit Master Profesional në Turizëm **[Evidenca I.5. Rregullore Mësimore e Programit të Studimit Master Profesional në Turizëm]**<br>• Planin mësimor të programit të studimit Master Profesional në Turizëm **[Evidenca II.2 Plani mësimor i programit të studimit Master Profesional në Turizëm 2021-2022]**<br>• Programet (syllabuset) e lëndëve mësimore **[Evidenca II.5 Programet lëndore (syllabuset) të Programit të studimit Master Profesional në Turizëm 2022-2023]**<br>• Modeli i diplomës Master Profesional në Turizëm **[Evidenca II.4 Modeli i diplomës Master Profesional në Turizëm]**<br>• Suplementi i diplomës **[Evidenca II.4.3 Suplementi i diplomës]**<br>• Struktura mësimore 2022-2023 **[Evidenca II.14 Struktura mësimore e programit të studimit 2022-2023]**<br>• Personeli akademik i angazhuar në programin e studimit Master Profesional në Turizëm<br>• **[Evidenca I.15 Personeli akademik i angazhuar në programin e studimit Master Profesional në Turizëm 2022-2023]**<br>• **[ANEKS-TABELAT PËRMBLEDHËSE Cilësia e stafit mësimdhënës për programin e studimit (Tabelat 6)]**<br>• Programi i provimit të përgjithshëm përfundimtar **[Evidenca II.15 Program i provimit të përgjithshëm përfundimtar MP në Turizem]**<br>• Programi i provimit të përgjithshëm përfundimtar **[Evidenca II.15.1 Lista me fushat e përgjithshme për punimin e Diplomës në MP në Turizem]** |
| **Kriteri 2.** Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestral, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit. | Programi i studim Master Profesional në Turizëm përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i mëposhtëm:<br>• Format e veprimtarive mësimore (mësim, provime), numri i javëve mësimore sipas semestrave, numri total i provimeve sipas semestrave<br>• Ndarjen e lëndëve mësimore sipas viteve dhe semestrave<br>• Ndarjen e lëndëve mësimore sipas aktiviteteve formuese<br>• Ngarkesen në kredite, numrin total të orëve, numrin e orëve në auditor dhe jashtë auditorit dhe orëve në javë<br>• Komponentët mësimorë për secilen lëndë<br>• Formën e vlerësimit<br>**[Evidenca II.2 Plani mësimor Master Profesional në Turizëm 2021-2022]** |
| **Kriteri 3.** Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen | Rregullorja UGJ **[Evidenca I.6 Rregullore e UGJ-së, neni 51, neni 61, neni 65], Rregullorja e studimeve në UGJ [Evidenca II.1 Rregullore e studimeve ne UGJ, Kreu VI]** Rregullorja e Fakultetit Ekonomik **[Evidenca II.6** |

| | |
|---|---|
| me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve. | **Rregullore e FE, Neni 18, Neni 30, Neni 31]**, përmbajnë të gjithë informacionin e nevojshëm për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.<br>Kriteret specifike dhe kuotat e pranimit të studentëve, kuotat dhe kriteret e transferimit të studentëve në ciklin e dytë të studimit Master Profesional në Turizëm, propozohen nga NJBPET, në zbatim të Ligjit të Arsimit të Lartë, Rregullores së UGJ-së, Statutit të UGJ, dhe Udhëzimeve të MAS [ **Evidenca II.16.1 Kuotat e propozuara të pranimit të studentëve 2020-2021;Evidenca Evidenca II.17.1 Kuotat e propozuara të pranimit të studentëve 2021-2022; Evidenca Evidenca II.17.5 Kuotat e propozuara të pranimit të studentëve 2022-2023; Evidenca II.18.1 Kuotat e propozuara të pranimit të studentëve 2023-2024;].** |
| **Kriteri 4.** Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikat, seminaret apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara. | Programet lëndore (syllabuset) të Programit të studimit Master Profesional në Turizëm përmbajne gjithë elementet e nevojshem në përputhje me formatin e përcaktuar në VKM Nr.41, datë 24.01.2018 "Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë", VKM Nr. 879, datë 18.12.2019, për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 41, datë 24.1.2018, të Këshillit të Ministrave, "Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit te Lartë" dhe Vendimin Nr. 185, datë 25.3.2021 Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin Nr. 41, datë 24.1.2018, "Për Elementet e Programeve të Studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë", të Ndryshuar.<br>**[Evidenca II.2 Plani mësimor Master Profesional në Turizëm 2021-2022; Evidenca II.5 Programet lëndore (syllabuset) të Programit të studimit Master Profesional në Turizëm 2022-2023.]**<br>Programet lëndore (syllabuset) përmbajnë emërtimin e lëndës, emrin e titullarit të lëndës, numrin e krediteve, numrin e orëve mësimore në klasë, leksion, seminar dhe praktika, viti akademik/semestri kur zhvillohet lënda, lloji i lëndës, programi i studimit ku ofrohet lënda, objektivat dhe aftesitë që lënda i jep studentit. Temat e detajuara të lëndës mundësojnë formimin teorik dhe praktik të studentit. Programet lëndore (syllabuset) përmbajnë gjithashtu formën e kontrollit të dijeve, detyrimet e studentit për lëndën, si dhe literaturen bazë të detyrueshme dhe atë të rekomanduar.<br>Programet lëndore hartohen nga titullari i lëndës dhe miratohen në njësinë përkatëse. Studentët informohen nga pedagogët në lidhje me përmbajtjen e programit të lëndës, zhvillimin e leksioneve, seminareve, ushtrimeve, esseve/detyrave të kursit dhe mënyrat e vlerësimit, etj **[Evidenca II.13 Rregullore e NJBPET, Neni 15; Evidenca II.5.3 Praktikë miratimi i programeve lëndore].** |
| **Kriteri 5.** Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në shqip dhe anglisht. | Përmbajtja e programit të studimit Master Profesional në Turizëm është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.<br>Riorganizimi bëhet sipas udhëzimeve të MAS. Miratimi i ndryshimeve bëhet me vendim senati, pasi këto ndrsyhime propozohen nga njësia bazë dhe përcillen nga njësia kryesore. **[Evidenca II.13 Rregullore NJBPET, neni 14, Evidenca II.10 Vendim Rektorati për riorganizimin e planeve mësimore 2018-2019; Evidenca II.11 Plani mësimor MP në turizëm 2018-2019; Evidenca II.11.1 Praktikë për riorganizim të planit mesimor në njësinë bazë; Evidenca II.11.2 Dërgim në MAS për riorganizimin e planeve mësimore; Evidenca II.11.3 Kthim përgjigje nga MASR për riorganizimin e planeve mësimore; Evidenca II.11.4 Konfirmi nga MAS për vënien në dijeni të riorganizimit]** |

| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| Standardi II.4<br>**Struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve. | Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Master Profesional në Turizëm [**Evidenca II.2 Plan mësimor MP në Turizëm 2021-2022; Evidenca II.5 Programet lëndore (syllabuset) të Programit të studimit Master Profesional në Turizëm 2022-2023**] ka të përcaktuar qartë emërtimin, përmbajtjen e veprimtarive, shpërndarjen e lëndëve, duke grupuar lëndët sipas kategorive të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 41, datë 24.01.2018, "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë", Vendimit Nr. 879, datë 18.12.2019 "Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin Nr. 41, datë 24.1.2018, të Këshillit të Ministrave, "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë" dhe Vendimit Nr. 185, datë 25.3.2021 Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin Nr. 41, datë 24.1.2018, "Për Elementet e Programeve të Studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë", të Ndryshuar, në:<br>a) Lëndë bazë të programit të studimit që pajisin studentët me formim në fushën e Ekonomisë dhe Turizmit si: Ekonomiks Menaxherial, Menaxhim i burimeve njerëzore në industrinë e turizmit dhe mikpritjes.<br>b) Lëndë karakterizuese si: Tturizmi dhe Industria Turistike, Turizmi dhe Ttrashëgimia Natyrore, Turizmi dhe Trashëgimia Kulturore në Shqipëri, Menaxhim i destinacioneve turistike, Menaxhim i turizmit të qëndrueshëm, Menaxhimin e bizneseve familjare turistike, Turizmi dhe zhvillimi rural i qëndrueshëm, Ekonomi Turizmi.<br>c) Lëndë ndërdisiplinore dhe/ose integruese në një ose më shumë grupe disiplinash si: Marketingu i turizmit, Sjellja konsumatore në turizëm, Politikat në turizëm, Marketingu i shërbimeve, Menaxhimin e cilësisë në turizëm, Menaxhim projektesh, Sistemet e informacionit te menaxhimit.<br>d) Lëndë plotësuese të fokusuara në praktiken profesionale.<br>e) Detyrime përmbyllëse, që lidhen me provim Formimi/Punim Diplome.<br>Në përfundim të studimeve ky program i pajis studentët me njohuri, të cilat do t'u shërbejnë në aspektin e punësimit të tyre si specialistë të turizmit në sektorin publik dhe privat.<br>Mësimi në auditor është në funksion të interaktivitetit të studentëve me pedagogun e lëndës dhe në funksion të stimulimit të mendimit të tyre krijues/novator dhe kritik, duke ndihmuar studentin në përshtatjen më të mirë në tregun e punës dhe punësimin e tij [**Evidenca II.21 Të dhëna statistikore nga Zyra e Alumnit dhe Këshillimit të Karrierës, Evidenca II.22 Informacion mbi analizen e përshtatshmërisë së kurrikulave në UGJ,faqe 9**]. |
| **Kriteri 2.** Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e | Lëndët dhe shpërndarja e tyre në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore është bërë duke patur parasysh vështirësinë e konceptimit të tyre, hierarkinë e formimit të koncepteve si dhe ndërvarësinë e lëndëve me njëra tjetrën. Raportet leksion/seminar/ushtrime, rezultatet e të nxënit, dhe format e |

| | |
|---|---|
| objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe kërkimit shkencor. | kontrollit të dijeve të paqyruara në programet e lëndëve mundësojnë realizimin e objektivave formuese të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit. Njohuritë që merr studenti janë njohuri specifike për sektorin turistik të domosdoshme për integrimin në tregun e punës, duke e pajisur me aftësi me dhe formim të plotë për të ushtruar profesionin e specialistit në fushën e drejtimit dhe menaxhimit të turizmit, si specialist turizmi në subjekte private dhe publike. **[Evidenca II.2 Plan mësimor Master Profesional në Turizëm 2021-2022; Evidenca II.5 Programet lëndore (syllabuset) të Programit të studimit Master Profesional në Turizëm 2022-2023]** |
| **Kriteri 3.** Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare. Në rastet e programit të studimit "Master Profesional", ky program duhet të sigurojë aftësi, kompetenca dhe formim të thelluar profesional. | Organizimi i programit të studimit Master Profesional në Turizëm, është hartuar dhe rishikuar në referencë të programeve të ngjashme kombëtare/ndërkombëtare dhe në bazë të sistemit Europian të Transferimit dhe Mbledhjes së Krediteve (ECTS).<br>Struktura e programit, lëndët dhe emërtimi i tyre, raporti teori praktikë **[Evidenca II.2 Plan mësimor Master Profesional në Turizëm 2021-2022; Evidenca II.5 Programet lëndore (syllabuset) të Programit të studimit Master Profesional në Turizëm 2022-2023;Evidenca II.4 Model diplome Master profesional në Turizëm; Evidenca II.4.3 Suplementi i diplomës]** janë në përputhje me profilin e Programit të Studimit Master Profesional në "Turizëm", i cili i përket fushës së Shkencave Shoqerore dhe e përafërt me programe të ngjashme kombëtare / ndërkombëtare.<br>Kurrikula e programit të studimeve Master Profesional në Turizëm është organizuar në formë të tillë që studenti të ketë një ngarkesë të njëjtë përgjatë semestrave, 30 kredite për semestër. Raporti i orëve është 2/2 (2 orë leksion dhe 2 orë seminar), duke i dhënë rëndësi rritjes së aftësive të studentëve në ushtrimin dhe aplikimin e njohurive teorike të marra në përputhje me profilin e programit. Ngarkesa në kredite për çdo vit akademik është 60 ECTS, një praktikë kjo e njëjtë me programet të ngjashme ndërkombëtare.<br>Gjithashtu zhvillimi i praktikes profesionale përgjatë nje semestri i siguron studentëve aftësi, kompetenca dhe formim të thelluar profesional. |
| **Kriteri 4.** Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve. | Natyra e lëndëve të ofruara dhe ngarkesa e tyre në ECTS siguron një integrim të aspekteve teorike dhe praktike që jep një lëndë në përmbushje të objektivave formuese të programit. Në këtë program studimi mund të transferohen studentë nga IAL të tjera, studentë që e zgjedhin këtë program si program të dytë studimi **[Evidenca II.20 Lista e fituese në MP Turizëm si fakultet i dytë]**. Ndjekja e praktikës profesionale përgjatë një semestri synon që studenti të ketë aftesi për t'u përshtatur sa më shpejt në tregun e punës në përputhjë me njohuritë e marra gjatë periudhës së studimeve si dhe zhvillimin drejt një karriere të sukseshme në profesion **[Evidenca II.2 Plan mësimor "Master Profesional" në Turizëm 2021-2022; Evidenca II.21 Te dhena statistikore nga Zyra e Alumnit dhe Keshillimit të Karrierës; Evidenca II.22 Analizë mbi përshtatshmërinë e programeve të studimit të ofruara nga "Eqrem Çabej" ].** |
| **Kriteri 5.** Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit. | Programet lëndore (syllabuset) e programit të studimit përmbajnë të gjitha elementet sipas shtojcës përkatëse të Vendimit Nr. 879, Datë 18.12.2019 "Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin Nr. 41, Datë 24.1.2018, të Këshillit të Ministrave, "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë" duke filluar me pasqyrën informative të lëndës, rezultatet e të nxënit, konceptet themelore, temat e detajuara të lëndës, format e kontrollit të dijeve, frekuentimi, kontrolli i vazhdueshëm, literatura.<br>Hartimi i programeve lëndore bëhet nga titullari i lëndës. Në fillim të çdo viti akademik titullari i çdo lënde paraqet për miratim në Njësinë bazë programin lëndor. Studenti i nënshtrohet programit lëndor që është miratuar për vitin |

| | |
|---|---|
| | akademik që ai frekuneton **[Evidenca II.1 Rregullore e studimeve në UGJ, Kreu III, Neni 26, Pika 2 dhe 3]**. Para fillimit të lëndës çdo pedagog ju paraqet studentëve syllabusin e lëndës së bashku me modalitetet e përfshira në të për zhvillimin e mësimit.<br>Pjesa e literaturës në çdo syllabus përbëhet nga literaturë bazë e detyrueshme dhe literatura e rekomanduar. Botimet e reja të fushave përkatëse të studimit, rezultatet e punës shkencore, integrohen me koncepte në lëndët përkatëse. Literatura e detyrueshme dhe ajo e rekomanduar synohet të jetë bashkëkohore.Literarura bazë e detyrueshme miratohet nga Njësia bazë me propozimin e titullarit të lëndës **[Evidenca II.5 Programet lëndore (syllabuset) të Programit të studimit "Master Profesional" në Turizëm 2022-2023; II.5.1 Programet lëndore (syllabuset) të Programit të studimit Master Profesional në Turizëm 2021-2022; II.5.2 Programet lëndore (syllabuset) të Programit të studimit "Master Profesional" në Turizëm 2020-2021; Evidenca II.1 Rregullore e studimeve ne UGJ, Kreu III, Neni 27, Pika 2 dhe 3; Evidenca II.5.4 Vendimi i Njësisë bazë për miratimi e literaturës bazë të detyrueshme dhe literaturës së rekomanduar, për vitin akademik 2022-2023]** |
| **Kriteri 6.** Përmbajtja e programit të studimit garanton përftimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara. | Përmbajtja e programit të studimit Bachelor në Turizëm e organizuar me lëndë bazë, lëndë karakterizuese, lëndë ndërdisiplinore, lëndë plotësuese dhe detyrimet përmbyllëse, garanton përfitimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara, të pasqyruara në çdo program lëndor (syllabuset) në rubrikën Përmbledhje dhe rezultatet e të nxënit.<br>Rezultatet e të nxënit maten me anë të realizimit të objektivave të lëndës të cilat janë synimet që lënda tenton të arrijë në përfundim të saj, të ndara në njohuritë, aftësitë dhe kompetencat që studenti pritet të përvetësojë në përfundim të lëndës. **[Evidenca II.2 Plan mësimor Master Profesional në Turizëm 2021-2022; Evidenca II.5 Programet lëndore (syllabuset) të Programit të studimit "Master Profesional" në Turizëm 2022-2023]**.<br>Programi Master Profesional në Turizëm përgatit specialistë të aftë për t'iu përgjigjur nevojave bashkëkohore të tregut turistik. Pas pëfundimit të studimeve të diplomuarit do të jenë në gjendje të njohin funksionimin e sektorit dhe industrisë turitike dhe me një formim të plotë për të ushtruar profesionin e specialistit në fushën e drejtimit dhe menaxhimit të turizmit, si specialist turizmi në subjekte private dhe publike. |
| **Kriteri 7.** Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës. | Dinamika e zhvillimit të tregut turistik kërkon një përmirësim të vazhdueshëm të literaturës dhe përshtatjen me ndryshimet e teknologjisë së informacionit. Në një ekonomi tregu, programi i studimit duhet të përshatet me nevojat e tregut të punës dhe të përgatisë profesionistë për të ardhmen e tij. Sektori i turizmit në Shqipëri dhe vecanërisht në Gjirokastër është shume atraktiv. Turizmi është një nga fushat prioritare të zhvillimit ekonomik, e pasqyruar në rritjen e interesimit të biznesve për të investuar në këtë sektor **[Evidenca II.23 Analiza e tregut të punës]** dhe rrjedhimisht me çeljen e vendeve të punës në këtë sektor. Rajoni i Gjirokastrës është nje nga destinacionet kryesore turistike në vend, ndërkohë që sektori i turizmit konsiderohet jetik për ekonominë e qarkut. Një nga faktorët kryesore që ndikon në zhvillimin e turizmit është dhe kualifikimi i burimeve njerëzore.<br>Studentët e programit Master Profesioanl në Turizëm mund të përfshihen në këtë treg pune në nivelet që i përshtaten kësaj diplome. Kështu mundësohet përfshirja e tyre në nivele të sipërmarrjes në sektorin turistik, në tregun lokal, rajonal, kombëtar por dhe atë global. Gjithashtu diploma ju mundëson përfshirjen dhe në sektorin publik në nivel lokal apo qëndror. |

| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| Standardi II.5<br>Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre. | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës. | Politikat e zhvillimit të NJBPET rrjedhin nga politikat e zhvillimit të UGJ-së, të cilat janë hartuar në përputhje me strategjinë e zhvillimin ekonomik të vendit dhe nevojat e tregut të punës. UGJ ka synuar në përshtatjen e programeve me nevojat dhe ofertat e tregut të punës, nëpërmjet përmirësimit të kurrikulave mësimore **[Evidenca II.25 Vendim Senati Akademik për lëndën Manaxhim projektesh].**<br>Programi "Master Profesional" në Turizëm përgatit specialiste të aftë për t'iu përgjigjur nevojave bashkëkohore të tregut turistik dhe me një formim të plotë për të ushtruar profesionin e specialistit në fushën e drejtimit dhe menaxhimit të turizmit, si specialist turizmi në subjekte private dhe publike.<br>Njëkohësisht për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës NJBPET në bashkëpunim me zyrën e Këshillimit të Karrierës dhe Alumnit pranë UGJ është pjesmarrës në aktivitete të ndryshme, trajnime, seminare informuese, workshop-e të zhvilluar në bashkëpunim me kompani dhe biznese private dhe aktorë të tjerë nga tregu i punës, duke ndarë eksperiencat, për të konsultuar, bashkëbiseduar dhe për të marrë parasysh propozimet e tyre duke marre ide për të përmirësuar kurrikulën dhe për të ndihmuar studentët në karrierën e tyre **[Evidenca II.21.1 Informacion nga Zyra e Alumnit dhe Këshillimit të Karrierës].** |
| **Kriteri 2.** Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit. | UGJ nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre. Studentët janë të angazhuar në Senatin Akademik të UGJ **[Evidenca II.27.1 Lista e anëtarëve të Senatit Akademik]**, janë të organizuar në Këshillin Studentor të UGJ, **[Evidenca II.28.2 Lista e anëtareve të Këshillit Studentor]** dhe kanë statutin e funksionimit të tyre **[Evidenca II.28 Statuti i Këshillit Studentor].**<br>Nëpermjet zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Alumni, UGJ mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar për përmirësimin e programit të studimit **[Evidenca II.22 Informacion mbi analizën e përshtatshmërisë së kurrikulave në UGJ, faqe 9; Evidenca I.19.2 Informacion, Zyra e marrdhënieve me jashtë].** |
| **Kriteri 3.** Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private. | NJBPET përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim institucione publike e private.<br>UGJ dhe FE kane një sërë marrëveshje bashkëpunimi me aktorë dhe partnerë të ndryshëm të sektorit publik dhe atij privat, përfshirja e studenteve dhe stafit të UGJ-së në aktivitete të përbashkëta me biznese, operatorë turistikë si dhe përfshirja e stafit në projekte në bashkëpunim me shoqata, aktivitete, takime të fushës së turizmit ka bërë të mundur që NJBPET të marrë në konsideratë propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve për të përmirësuar përmbajtjen dhe modulet e këtij programi studimi me qëllimin rritjen e mundësive të punësimit të studentëve në tregun e punës **[Evidenca I.18 Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit; Evidenca I.19.2 Informacion, Zyra e** |

| | |
|---|---|
| | **marrdhënieve me jashtë; Evidenca II.26 Impakt Week 2023, Gjirokastra, Albania; Evidenca I.14.12 Raport vjetor i veprimtarisë mësimore-kërkimore NJBPET 2019-2020; I.14.13 Raport vjetor i veprimtarisë mësimore-kërkimore NJBPET 2020-2021; I.14.14 Raport vjetor i veprimtarisë mësimore-kërkimore NJBPET 2021-2022** ].<br>Pjesmarrja në aktivitete të ndryshme, trajnime, seminare informuese, Workshop-e të zhvilluar në bashkëpunim me kompani dhe biznese private dhe aktorë të tjerë nga tregu i punës, duke ndarë eksperiencat, për të konsultuar, bashkëbiseduar dhe për të marrë parasysh propozimet e tyre duke marrë ide për të përmirësuar kurrikulën dhe për të ndihmuar studentët në karrieren e tyre **Evidenca II.21.1 Informacion nga Zyra e Alumnit dhe Këshillimit të Karrierës].** |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| **Standardi II.6**<br>**Programi i studimit garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Programi i studimit përcakton qartë prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit dhe kërkimit shkencor në përputhje me objektivat madhorë të institucionit. | UGJ-ja si institucion i arsimit të lartë ka për mision: të mbështesë prioritetet strategjike dhe interesat e zhvillimit të vendit. **[Evidenca I.1. Statuti i Universitetit "Eqrem Çabej", Gjirokastër, Neni 8, pika 5].** Programet e studimeve hartohen në përputhje me vizionin dhe misionin e UGJ-së, të shprehura në Statutin e UGJ-se **[Evidenca I.1. Statuti i Universitetit "Eqrem Çabej", Gjirokastër, Nenet 4, 5, 8]**, në Strategjinë e zhvillimit të UGJ-së **[Evidenca I.2. Strategjia e zhvillimit të Universitetit të Gjirokastrës 2020-2025, Prioritete Strategjike fq 8-9.]**, në Strategjinë e zhvillimit të FE-së **[Evidenca I.3 Strategjia e zhvillimit të Fakultetit Ekonomik, Prioritetet Strategjike fq 5-6].**<br><br>Programi i studimit Master Profesional në "Turizëm" është plotësisht në përputhje me vizionin dhe misionin e UGJ-së si dhe me fushën e veprimtarisë së tij. Ky programi synon zhvillimin e aftësive që do ta bëjne të diplomuarin në këtë program studimi të aftë për t'u përgjigjur nevojave bashkëkohore të ekonomisë dhe të mund të vlerësojë përmbajtjen shoqërore të veprimtarisë sëëtyre **[Evidenca I.5. Rregullore Mësimore e Programit të Studimit Master Profesional në Turizëm, Neni 2].** |
| **Kriteri 2.** Njësia kryesore/bazë nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore ose artistike, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit. | FE/NJBPET nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit **[Evidenca I.5 Rregullore e Universitetit "Eqrem Çabej", Gjirokastër, Neni 6, pika 3].**<br>NJBPET mbështet, nxit dhe respekton stafin akademik në organizimin e veprimtarive të mësimdhënies, në punën e tyre kërkimore-shkencore, në pjesëmarrjen në studime dhe projekte të ndryshme në bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë vendas dhe të huaj si dhe në shkëmbimin e eksperiencave dhe kualifikimin e tyre **[Evidenca II.5 Programet lëndore (syllabuset) të Programit të studimit Master Profesional në Turizëm 2022-2023; Evidenca I.14.12 Raport vjetor mbi veprimtarinë mësimore-kërkimore NJBPET 2019-2020, I.14.13 Raport vjetor mbi veprimtarinë mësimore-kërkimore NJBPET 2020-2021, I.14.14 Raport vjetor mbi** |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | veprimtarinë mësimore-kërkimore NJBPET 2021-2022]. | | | |
| **Kriteri 3.** Programi i studimit mundëson, nxit dhe motivon studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore. | Studentët e programit të studimit MP në Turizem, janë nxitur gjithmonë dhe janë përfshirë në aktivitete dhe projekte të ndryshme. Studentët janë përfshirë në projekte të insitucionit, si dhe aktivitetete të tjera në bashkëpunim me partnerët e UGJ-së **[Evidenca I.19.1 Lista e projekteve të FE; Evidenca II.26 Impakt Week 2023, Gjirokastra, Albania ].** | | | |
| **Kriteri 4.** Për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore, njësia bazë mbështetet financiarisht nga institucioni dhe administron të ardhurat nga aktivitete të ndryshme. | Institucioni angazhohet që të mbështet aktivitetet kërkimore dhe studimore të njësive bazë, duke qënë se kërkimi dhe projektet kërkimore shkencore janë pjesë e objektivave që merren parasysh në hartimin e projekt buxhetit të institucionit. Njesitë bazë zhvillojne aktivitetin e tyre në përputhje me misionin dhe fushat prioritare të kërkimit shkencor, teknologjisë dhe inovacionit, si dhe në programet e zhvillimit në rang rajonal, kombëtar dhe ndërkombetar Institucioni mundëson botimin e aktivitetit shkencor të stafit të tij në Periodikun e UGJ-së **[Evidenca II.29 Strategjia për kërkimin shkencor në Universitetin "Eqrem Çabej" 2020-2025, Evidenca I.1 Statuti i Universitetit "Eqrem Çabej", Gjirokastër, Evidenca I.19.1 Lista e projekteve të FE-së, Evidenca II.30 Lista e botimeve në periodikun e UGJ-së ].** | | | |
| **0Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | **X** |

| **Standardi II.7** <br> **Programi i studimit garanton njohuri të thelluara, ndërkombëtarizim dhe kërkim shkencor.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Njësia përgjegjëse mbështet grupet lëndore dhe projektet kërkimore-shkencore të reja dhe siguron bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore për realizimin e objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor. | Stafi akademik i FE/ NJBPET është i angazhuar në projekte kërkimore-shkencore, të financuara nga fondet e UGj-së, AKKSHI ose Erasmus+, por njëkohësisht i përfshirë dhe në projekte të tjera të fushës së turizmit në pozicionin e ekspertit ose konsulentit në bashkepunim me institucione dhe organizata të tjera. Gjithashtu është përfshirë në aktivitete të ndryshme lokale, në fusnksion të realizimit të objektivave të programit të studimit **[Evidenca I.14.6 Raport vjetor mbi veprimtarinë mësimore, shkencore Fakulteti Ekonomik 2019-2020; I.14.8 Raport vjetor mbi veprimtarinë mësimore, shkencore Fakulteti Ekonomik 2020-2021; I.14.10 Raport vjetor mbi veprimtarinë mësimore, shkencore Fakulteti Ekonomik 2021-2022, Evidenca I.19.1 Lista e projekteve te FE-së].** |
| **Kriteri 2.** Njësia përgjegjëse angazhohet për t'iu përgjigjur kërkesave për analiza, studime e projekte me karakter kërkimor shkencor dhe angazhon personelin akademik dhe studentët për realizimin e këtyre objektivave. | Stafi akademik i FE/ NJBPET dhe studentët angazhohen në trajnime dhe aktivitete të ndryshme të organizuara nga UGJ. Gjithashtu është i angazhuar në studime e projekte të ndryshme kërkimore-shkencore. Stafi është gjithashtu i angazhuar në pozicionin e ekspertit ose konsulentit në bashkëpunim me institucione dhe organizata të tjera **[Evidenca I.14.6 Raport vjetor mbi veprimtarinë mësimore, shkencore Fakulteti Ekonomik 2019-2020; I.14.8 Raport vjetor mbi veprimtarinë mësimore, shkencore Fakulteti Ekonomik 2020-2021; I.14.10 Raport vjetor mbi veprimtarinë mesimore, shkencore Fakulteti Ekonomik 2021-2022].** |
| **Kriteri 3.** Në fushën e programit të studimit, njësia përgjegjëse organizon konferenca ose aktivitete, të cilat ndihmojnë personelin dhe studentët për arritjen e objektivave. | FE/NJBPET janë përfshire në disa projekte kërkimore në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar si dhe kanë një sërë marrëveshje me IAL jashtë vendit në kuadër të programeve Erasmus +, që mundësojnë mobilitete të stafit akademik dhe studentëve të këtij fakulteti. Gjithashtu personeli akademik i FE-se ka qene i angazhuar në Konferenca shkencore ndëruniversitare **[Evidenca I.14.6 Raport vjetor mbi veprimtarinë mesimore, shkencore Fakulteti Ekonomik 2019-** |



Geshkepjyl

| | |
|---|---|
| | **2020; I.14.8 Raport vjetor mbi veprimtarinë mësimore, shkencore Fakulteti Ekonomik 2020-2021; I.14.10 Raport vjetor mbi veprimtarinë mësimore, shkencore Fakulteti Ekonomik 2021-2022].** |
| **Kriteri 4.** Programi i studimit formon profesionistë konkurrues për tregun kombëtar dhe ndërkombëtar të punës. | UGJ zhvillon dhe transmeton dije si dhe përgatit specialist të cilët mund të kontribojnë në zhvillimet locale, rajonale apo kombëtare. UGJ bashkëpunon me partnerë ndërkombëtare dhe mundëson pjesmarrjen e studentëve në aktivitete ndërkombëtare. Studentëve të FE-së iu është mundësuar përfshirja në mobilitete në kuadër të programit Erasmus+. Një tjetër mundësi për studentët ofroi bashkëpunimi me Ambasadën e SHBA-së në Shqipëri dhe Naron Travel Albania, ku studentë të UGJ-së për të dytin vit rradhazi janë pjesmarrës në këtë program shkëmbimi. **[Evidenca I.20 Mobilitet e zhvilluara të Universitetit "Eqrem Çabej", II.24 Work and Travel].** |
| **Kriteri 5.** Njësia përgjegjëse merr parasysh dhe zbaton rekomandimet e nxjerra nga urdhrat, shoqatat profesionale, rrjetet profesioniste, për kompetencat e nevojshme për marrjen e licencës së profesionit përkatës, sipas akteve ligjore të fushës. | Për studentët që përfundojnë studimet në Master Profesional në Turizëm nuk parashikohet marrja e liçensës së profesionit, pasi nuk është profesion i rregulluar. |
| **Kriteri 6.** Programi i studimit për profesionet e rregulluara përputhet me aktet ligjore në vend dhe rekomandimet ndërkombëtare në direktiva dhe rregullore të Bashkimit Evropian (*p.sh. Professional QualificationsDirective, 2005/36/EU*). | Për studentët që perfundojnë studimet në Master Profesional në Turizëm nuk parashikohet marrja e liçenses së profesionit, pasi nuk është profesion i rregulluar. |

| **Shkalla e përmbushjes sëstandardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| **Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

REPUBLIKA E SHQIPERISE - UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR

## III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

| **Standardi III.1**<br>**Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira, me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminaret, punët laboratorike, detyrat e kursit/esetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni. | Në rregulloren dhe në planin mësimor të programit të studimit janë të përcaktuara metodat kryesore të mësimdhënies dhe kontrollit të dijes që janë leksionet, seminaret, ushtrimet, provimet e formimit/punimi i diplomës. Ndërsa në syllabuset e secilës lëndë jepen më të detajuara metodat e mësimdhënies, forma e kontrollit të dijeve në varësi të llojit të lëndës **[Evidenca I.5 Rregullore e programit të studimit Master Profesional në Turizëm; Evidenca II.2. Plani mësimor Master Profesional në Turizëm 2021-2022].**<br><br>Programi i studimit të ciklit të dytë M.P në Turizëm realizohet me 120 kredite dhe kohëzgjatje normale 2 vite akademike. Lëndet që ofrohen në këtë program janë të organizuara në kategori të klasifikuara nga A në E në përputhje me VKM 41, datë 24.01.2018 "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë". Format e mësimdhënies për këtë program studimi janë ato të miratuara nga institucioni, duke përfshirë:<br>- Leksionet: 450 orë mësimore në auditor<br>- Seminaret: 800 orë mësimore në auditor<br>- Provim formimi/Punim diplome: 50 orë në auditor, dhe<br>- Orë mësimore jashtë auditorit janë në total 1750<br>Gjithsej 120 kredite/ 1250 orë mësimore në auditor dhe 1750 orë mësimore jashtë auditorit.<br><br>Ndarja e lëndeve sipas kategorive nga A në E:<br>- Lënde të formimit të përgjithshëm (bazë) (simboli A) : 12 kredite<br>- Lënde të formimit karakterizues (simboli B): 48 kredite<br>- Lëndë ndërdisiplinore/integruese lëndë–nëndisiplina, profile dhe grup-lëndë me zgjedhje (simboli C): 30 kredite<br>- Lëndë plotësuese, Praktikë Profesionale, (simboli D): 12 kredite<br>- Provim formimi/Punim diplome (simboli E): 18 kredite<br>Gjithsej: 120 kredite<br><br>**[Evidenca II.2. Plani mësimor Master Profesional në Turizëm 2021-2022]** |
| **Kriteri 2.** Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies. | Personeli akademik i programit të studimit MP në Turizëm u përgjigjet më së miri nevojave të studentëve duke u ofruar metoda alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.<br><br>Mësimi zhvillohet në mënyrë interaktive, duke integruar shpjegimin e pedagogut me diskutimet e studentëve në mënyrë që ata të jenë sa më aktivë në seminare por edhe leksione gjithashtu. Në rregullore përcaktohet që elementët e vlerësimit të vazhdueshëm si: niveli i diskutimit në seminare, kolokiumi, provimi i ndërmjetëm, detyra kursi etj, përfaqësojnë deri në 20% të vlerësimit total. |

| | |
|---|---|
| | Bazuar në Rregulloren e Programit të Sudimit, **[Evidenca I.5 Rregullore e Programit të Studimit MP në Turizëm]** dhe duke pasur parasysh natyrën e programit të studimit dhe specifikën e çdo lënde të tij, mësimdhënia përfshin përveç metodave didaktike tradicionale, edhe metoda didaktike innovative, nëpërmjet përdorimit të teknologjive të informacionit dhe komunikimit në mësimdhënie.<br><br>**[Evidenca III.4 Udhëzues institucional mbi metodat innovative në mësimdhënie;**<br><br>Gjatë periudhës së pandemisë Covid-19, UGJ ofroi alternativën online të mësimdhënies dhe mësimnxënies nëpërmjet platformave elektronike të mësimit në distancë, Classroom, Edumeet, Microsot Office 365 dhe Microsoft Teams. Për një mësimdhënie sa më efektive UGJ krijoi kushtet e nevojshme për aksesimin, të studentëve dhe personelit akademik në këto platforma, nëpërmjet mbështetjes nga personeli IT i Universitetit si dhe ndihmoi me dokumentacionin e nevojshëm teknologjik (manuale) për përdorimin e këtyre platformave **[Evidenca III.1 Urdhër për platformën e mësimit online; Evidenca III.1.1 Implementimi i platformës së mësimit online Classroom; Evidenca III.1.2 Implementimi i platformës së mësimit online Edumeet; Evidenca III.1.3 Implementimi i platformës së mësimit online Office 365; Evidenca III.1.4 Manual i përdorimit të platformës TEAMS për stafin akademik; Evidenca III.1.5 Manual i përdorimit të platformës TEAMS për studentet; Evidenca III.1.6 Vendim për format e zhvillimit të procesit mësimor 2020-2021; Evidenca III.1.7 Rregullore për format e zhvillimit të provimeve 2020-2021; Evidenca III.1.8 Vendim Senati për miratimin e rregullores së provimeve 2020-2021;Evidenca III.1.9 Format e zhvillimit të provimeve 2020-2021; Evidenca III.1.10 Zhvillimi i sezonit të provimeve FE 2020-2021]; ANEKS-TABELAT PËRMBLEDHËSE:** (Tabela 17) Të dhëna të plota për platformat on-line/Struktura e teknologjisë së informacionit/ Biblioteka/ Biblioteka online, etj;<br><br>Gjithashtu Programi i studimit MP në Turizëm ka të përfshirë në planin mësimor, veprimtaritë formuese "Lëndë me zgjedhje", veprimatri alternative të kurrikulës që lejon studentin të zgjedhë një lëndë nga një grup lëndësh. **[Evidenca II.2 Plan mësimor MP në Turizëm 2021-2022]** |
| **Kriteri 3.** Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit. | Statuti i UGJ-së përcakton të drejtën e çdo anëtari të personelit akademik për të marrë pjesë në veprimtari kërkimore shkencore bazë apo të zbatuar, që është në përputhje me objektin e veprimtarisë të njësisë bazë ku bën pjesë. Gjithashtu, po në Statut, parashikohet edhe financimi i veprimtarisë kërkimore-shkencore sipas kërkesave të njësive bazë për pjesemarrje në projekte kërkimore shkencore. Një mënyrë për të avancuar në fushën akademike është e drejta që ka çdo anëtar i personelit akademik për t'u shkëputur nga angazhimi i tij në institucion për një periudhe kohore deri në 1 vit përmes vitit akademik sabatik. **[Evidenca I.1 . Statuti i UGJ, neni 53, 77, 78, 79, 80]**<br><br>Kërkimi shkencor në UGJ është në funksion të rritjes së cilësisë së mësidhënies e mësimnxenies nëpërmjet rritjes së kualifikimit të stafit akademik. Këtij qëllimi i shërben gjithashtu edhe mobilitetet e Stafit të UGJ-së përmes programeve Erasmus +, dhe mundësive që ofron ndërkombëtarizimi. |

| | |
|---|---|
| | **[Evidenca I.2. Strategjia e Zhvillimit të UGJ 2020-2025: Kërkimi dhe studimet shkencore; Evidenca I.19. Lista e projekteve të UGJ; Evidenca I.20. Lista e mobiliteteve të UGJ];**<br>**[Evidenca I.19.2 Informacion, Zyra e Marrdhënieve me Jashtë UGJ]** |
| **Kriteri 4.** Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë. Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre. | Bazuar në Ligjin Nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", Neni 59, pikat 3, 4, 5, 6, Programi i Studimit MP në Turizëm përmbush kërkesat ligjore në fuqi përsa i përket kualifikimit të personelit akademik që angazhohet për realizimin e tij. **[ANEKS-TABELAT PËRMBLEDHËSE Tabela 6. Cilësia e stafit mësimdhënës për programin e studimit]**. Aktualisht, për vitin akademik 2022-2023, personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi përbëhet nga 4(katër) anëtar personel akademik efektiv (PAE), të kategorive të mëposhtme:<br>• 2(dy) Pedagogë me titullin "Profesor i Asociuar"<br>• 2(dy) Lektorë me titullin/gradën shkencore "Doktor."<br>Niveli dhe lloji i kualifikimit akademik të këtij personeli **[Evidenca III.3 CV-të e Personelit Akademik dhe ndihmës akademik]**, është i duhur për shpjegimin e njohurive dhe koncepteve të lëndëve mësimore të programit të studimit, e reflektuar edhe në shpërndarjen e ngarkesës mësimore të personelit akademik.<br><br>**[ANEKS-TABELAT PËRMBLEDHËSE, Tabela 4. Ngarkesa totale e personelit akademik të programit MP në Turizëm në vitin akademik 2022-2023].**<br><br>Personeli akademik i NJBPET përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te studentët mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë.<br><br>Metodat që përdoren përgjithësisht sipas tipit të veprimtarisë mësimore janë:<br>• Leksione: shpjegim i shoqëruar me paraqitje në dërrasa apo në prezantime të tipit "Power point" nëpëmjet videoprojektorëve dhe diskutim interaktiv.<br>• Seminar: diskutim interaktiv në zgjidhjen e ushtrimeve si zbatime të teorisë.<br>Çdo student mbështetet në punën e tij nga këshilla dhe konsulta të vazhdueshme me pedagogun e lëndës gjatë orës së mësimit, ose në orët e konsultimeve të përcaktuar nga secili pedagog brenda orarit zyrtar të punës. Gjithashtu, studentët mund të komunikojnë me pedagogun e lëndës edhe elektronikisht nëpërmjet email-it institucional.<br><br>Kompetenca e stafit akademik të angazhuar në mësimdhënie vërtetohet edhe nga rezultatet e pyetësorëve të studentëve, ku më shumë se 92% e studentëve konfirmojnë vlerësimin mirë dhe shumë mirë përpyetjet që lidhen me aftësitë dhe të qënit kompetent të stafit akademik. Avancimi i mëtejshëm i stafit akademik përmes aktivitetit kërkimor shkencor në fushën përkatëse, plotëson kompetencat mësimdhënëse.<br><br>**Evidenca III.5. Pyetësor Studentor;** |
| **Kriteri 5.** Njësia përgjegjëse për ofrimin e progamit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e | Personeli akademik i NJBPET, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces |

| | |
|---|---|
| metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre. | dhe duke reflektuar mendimet e sygjerimet e tyre.<br><br>Në menyrë periodike NJSBC realizon me studentët pyetësorë për vlerësimin e mësimdhënies. Vlerësimet, mendimet dhe sugjerimet e studentëve merren parasysh për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies, trajtimit të lëndës, përdorimit të metodave dhe teknologjive bashkëkohore mësimdhënëse, vlerësimit etj. **[Evidenca III.5. Pyetësor Studentor; Evidenca III.6 Raport mbi rezultatet e pyetësorit studentor]** |
| **Kriteri 6.** Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja. | Bazuar në Statutin e UGJ-së **[Evidenca I.1 Statuti i Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastër, Neni 42]**, njësitë ndihmëse në funksion të proçesit mësimor-kërkimor janë:<br><br>a. Sektori i Standarteve të Cilësisë dhe Kurrikulave<br><br>b. Sektori i Kërkimit Shkencor dhe Marrëdhënieve me Jashtë<br><br>si pjesë përbërëse e Drejtorisë së Shërbimeve Ndihmës Akademike dhe Administrative, që promovojnë mësimdhënien dhe përmirësimin e vazhdueshëm të saj, koordinojnë dhe bashkërendojnë me Njësitë Kryesore/Bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies, mbështesin zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, **[Evidenca III.4 Udhëzues institucional mbi metodat innovative në mësimdhënie; [Evidenca I.20 Lista e mobiliteteve të UGJ]; [Evidenca I.19 Lista e projekteve të UGJ]**<br><br>UGJ ka revistën e tij shkencore "Kërkime Universitare" **[Evidenca II.30 Lista e botimeve në Periodikun e UGJ]** në format letër dhe në format elektronik, e pajisur me ISSN: 2226-082X, e cila pasqyron botimet më të fundit të Institucionit. **[Evidenca I.1 Statuti i Universitetit "Eqrem Çabej", Gjirokastër, Neni 84]** |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| **Standardi III.2**<br>**Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore dhe garanton zbatimin e tyre.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore përcaktohen në në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët. | Kriteret dhe mënyra e testimit, vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale, përcaktohen në:<br>• Rregulloren e UGJ **[Evidenca I.6 Rregullore e Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastër, Nent 68, 81, 82, 83]**<br>• Rregulloren e studimeve në UGJ **[Evidenca II.1 Rregullore e studimeve në Universitetin "Eqrem Çabej" Gjirokastër, Nenet 39, 40, 41, 62, 63, 64]**<br>• Rregulloren e FE-së **[Evidenca II.6 Rregullore e Fakultetit Ekonomik, Nenet 32, 33, 34, 35, 38,]**<br>• Rregulloren e NJBPET **[Evidenca II.13 Rregullore e Njësisë Bazë PET Nenet 28, 29, 30, 31, 32]** |

| | |
|---|---|
| | • Rregulloren e programit të studimit MP në Turizëm **[Evidenca I.5 Rregullore e Programit të Studimit MP në Turizëm, Nenet 10, 11]**<br>• **Programet Lëndore [Evidenca II.5 Programet lëndore (syllabuset) të programit të studimit MP në Turizëm {2022-2023]**<br>• si dhe Udhezimet institucionale **[Evidenca III.11. Vendim Senati Akademik për miratimin e tezës së provimeve; Evidenca III.7 Marrëveshje bashkëpunimi AADF-UGJ]**<br>Rregulloret e mësipërme janë të publikuara në faqen zyrtare web të UGJ-së, ku studentët mund të informohen në lidhje me kriteret e mënyrat e testimit dhe vlerësimit të njohurive. |
| **Kriteri 2.** Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit. | Bazuar në Rregulloren e studimeve në UGJ **[Evidenca II.1 Rregullore e studimeve në Universitetin "Eqrem Çabej" Gjirokastër, Neni 39, pikat 4, 5]** modalitetet e vlerësimit dhe detyrimet e studentit u bëhen të njohura studentëve me fillimin e procesit mësimor dhe janë të parashikuara në syllabuset e lëndëve nga titullari i lëndës. **[Evidenca II.5 Programet lëndore (syllabuset) të programit të studimit MP në Turizëm 2022-2023]** |
| **Kriteri 3.** Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara. | Rregullorja e UGJ, Rregullorja e studimeve në UGJ, Rregullorja e FE, Rregullorja e Njesisë Bazë Turizëm por edhe Rregullorja e programit të studimit MP në Turizëm përcaktojnë qartë mënyrat e vlerësimit të studentëve. Në programin lëndor shprehen modalitetet e vlerësimit dhe detyrimet e studentit, të cilat i bëhen të njohura studentëve me fillimin e procesit mësimor. Vlerësimi i studentit bëhet në dy pjesë: vlerësimi i vazhduar gjatë vitit për elementët e përcaktuara në programin e lëndës dhe provimi final. Vlerësimi i vazhduar përfaqëson 20% të vlerësimit përfundimtar. **[Evidenca II.1 Rregullore e studimeve në Universitetin "Eqrem Çabej" Gjirokastër, Neni 39, pikat 5, 6; Evidenca II.5 Programet lëndore (syllabuset) të programit të studimit MP në Turizëm 2022-2023]**<br><br>Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore në përfundim të lëndës zhvillohet me provim me shkrim. Numri i pyetjeve (pyetje teorike ose ushtrime/problema llogaritëse) që përmban një tezë e provimit me shkrim varet nga vëllimi i lëndës, numri i leksioneve dhe seminareve etj. Një tezë e provimit me shkrim përmban pyetje teorike dhe /ose ushtrime që vlerësohen në total me 80 pikë. Për çdo pyetje/ushtrim vihen pikët përkatëse, në varësi të karakterit të pyetjes/ushtrimit. Pyetjet përfshijnë në mënyrë tërësore lëndën përkatëse, duke qenë të formuluara qartë, jo me dykuptime, në mënyrë që studenti të jetë në gjendje të bëjë vetëvlerësimin për përgjigjet që ka shkruar. **[Evidenca III.11. Vendim Senati Akademik për miratimin e tezës së provimeve; Evidenca II.1 Rregullore e studimeve në Universitetin "Eqrem Çabej" Gjirokastër, Kreu V, Nenet 39, 40, 44; Evidenca II.5 Programet lëndore (syllabuset) të programit të studimit MP Turizëm 2022-2023]** |

| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

REPUBLIKA E SHQIPËRISË UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR

Adresa: Lagjia 18 Shtatori
Rruga « Studenti », Gjirokastër
Tel:+355 (842) 63 408
E-mail: rektori@uogj.edu.al
Web site: www.uogj.edu.al

| Standardi III.3<br>**Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit. | Rregullorja e studimeve në UGJ-së **[Evidenca II.1 Rregullore e studimeve në Universitetin "Eqrem Çabej" Gjirokastër, Kreu V]**, Rregullorja e FE-së **[Evidenca II.6 Rregullore e Fakultetit Ekonomik Kreu VI]**, por edhe Rregullorja e programit të studimit të MP në Turizëm **[Evidenca I.5 Rregullore e Programit të Studimit MP në Turizëm, Nenet 20]** përcaktojnë qartë mënyrat e vlerësimit të studentëve.<br><br>Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar i cili bëhet me notë. Shkalla e përvetësimit të programit lëndor vlerësohet me sistemin prej 10(dhjetë) notash. Nota më e ulët për kalimin në një lëndë është nota 5(pesë). Në format e kontrollit me shkrim përdoret sistemi i vlerësimit me pikë, rezultati i të cilit konvertohet në notë. Personeli akademik në programin lëndor shpreh modalitetet e vlerësimit dhe detyrimet e studentit, të cilat i bëhen të njohura studentëve me fillimin e procesit mësimor.<br><br>Bazuar në Rregulloren e studimeve në UGJ **[Evidenca II.1 Rregullore e studimeve në Universitetin "Eqrem Çabej" Gjirokastër, Neni 39, pika 5]** dhe në programin e lëndës **[Evidenca II.5 Programet lëndore (syllabuset) të programit të studimit MP në Turizëm 2022-2023]** vlerësimi përfundimtar i studentit përbëhet nga:<br><br>• Vlerësimi i vazhduar gjatë vitit i cili përbën 20 % të vlerësimit përfundimtar<br>• Vlerësimi në provim i cili përbën 80 % të vlerësimit përfundimtar **[Evidenca III.11.1 Model i unifikuar i tezës së provimeve]**<br>Bazuar në Rregulloren e UGJ-së **[Evidenca I.6 Rregullore e Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastër, Neni 81, pika 1]** në përfundim të procesit mësimor (në orën e fundit të mësimit) çdo pedagog që është përgjegjës lënde u komunikon studentëve :<br><br>• Fitimin ose jo të së drejtës për t'u futur në provimin e lëndës përkatëse.<br>• Rezultatin e vlerësimit të vazhduar.<br>Llogaritja e Vlerësimit përfundimtar bëhet sipas përcaktimeve në Rregulloren e Universitetit **[Evidenca I.6 Rregullore e Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastër, Neni 89]** |
| **Kriteri 2.** Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën. | UGJ zbaton prej disa vitesh edhe sistemin e automatizuar të korigjimit të provimeve, në sajë të projektit CLEANSCORE të financuar nga AADF.<br><br>Studenti është i njohur me metodologjinë e zhvillimit të provimit gjatë procesit mësimor. Personeli akademik asistohet nga koordinatori i AADF pranë Universitetit të Gjirokastrës, për korrigjimin e provimeve me këtë sistem elektronik. **[Evidenca III.7 Marrëveshje bashkëpunimi AADF-UGJ]**.<br><br>Gjatë periudhës së pandemisë "Covid 19", në kohën e mësimit "online", UGJ ka implementuar testimin përmes platformës elektronike Microsoft Teams, duke garantuar shpejtësi, transparencë, objektivitet dhe informim të menjëhershëm/të shpejtë të vlerësimit për studentët. Kjo është zbatuar dhe në |



Gjeshkëpijat

| | |
|---|---|
| | programin MP në Turizëm duke kryer me sukses dhe transparencë të plotë vlerësimin e studentëve. Personeli akademik i NjBPET ka marrë pjesë në trajnimet e organizuar nga UGJ për hartimin e tezës elektronike të provimit, shfaqjen e rezultateve, planifikimin e orarit të provimit online, etj. nëpërmjet platformës Ms TEAMS për të siguruar mbarëvajtjen e provimit (testimit online)<br><br>**[Evidenca III.1.7 Rregullore për format e zhvillimit të provimeve 2020-2021; Evidenca III.1.8 Vendim Senati për miratimin e rregullores së provimeve 2020-2021; Evidenca III.1.9 Format e zhvillimit të provimeve 2020-2021; Evidenca III.1.10 Zhvillimi i sezonit të provimeve FE 2020-2021]** |
| **Kriteri 3.** Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi. | Bazuar në Rregulloren e studimeve në UGJ **[Evidenca II.1 Rregullore e studimeve në Universitetin "Eqrem Çabej" Gjirokastër, Neni 39]** dhe në programin e lëndës **[Evidenca II.5 Programet lëndore (syllabuset) të programit të studimit MP në Turizëm 2022-2023]** vlerësimi përfundimtar i studentit përbëhet nga:<br><br>• Vlerësimi i vazhduar gjatë vitit, i cili përbën 20 % të vlerësimit përfundimtar<br>• Vlerësimi në provim i cili përbën 80 % të vlerësimit përfundimtar<br>**[EvidencaII.11.1 Model i unifikuar i tezës së provimeve]**<br>Bazuar në Rregulloren e UGJ **[Evidenca I.6 Rregullore e Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastër, Neni 81, pika 1]** në përfundim të procesit mësimor (në orën e fundit të mësimit) çdo pedagog që ëshrë përgjegjës lënde u komunikon studentëve :<br><br>• Fitimin ose jo të së drejtës për tu futur në provimin e lëndës përkatëse<br>• Rezultatin e vlerësimit të vazhduar<br>Llogaritja e Vlerësimit përfundimtar bëhet sipas përcaktimeve në Rregulloren e Universitetit **[Evidenca I.6 Rregullore e Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastër, Neni 89]** |
| **Kriteri 4.** Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen. | Vlerësimi i njohurive të studentëve kryhet nëpërmjet fazave të ndryshme të kontrollit gjatë semestrit (teste, provimi i ndërmjetëm, punë laboratori, detyrë kursi, provim final).<br><br>Korrigjimi i provimit me shkrim bëhet nga komisioni i provimit.<br><br>Njohja me rezultatet paraprake të provimit u behet me dije studentëve nëpërmjet publikimit online në librezën e tyre elektronike (në sistemin ESSE3, tashmë në sistemin Pitagora) ose pranë NJBPET brenda 6 diteve nga data e zhvillimit të tij **[Evidenca I.6 Rregullore e Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastër, Neni 90]**. Pas shpalljes së rezultateve, studentëve u jepet e drejta që të rishikojnë individualisht tezat e korrigjura prej pedagogut, duke parë në këtë mënyrë vlerësimin për secilën përgjigjë të tyre (të shoqëruara me komente / feedback, këshilla mbi procesin e të nxënit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen) dhe të paraqesin ankesat e tyre eventuale në lidhje me vlerësimin nga ana e pedagogut. Kjo e drejtë e studentëve garantohet në Rregulloren e studimeve në UGJ **[Evidenca II.1 Rregullore e studimeve në Universitetin "Eqrem Çabej" Gjirokastër, Neni 46]**. Deri 8 (tetë) ditë nga data e zhvillimit të provimit pedagogu gjeneron, publikon online dhe dorëzon në sekretarinë mësimore pasqyrën e rezultateve përfundimtare të provimit në rastet kur nuk ka proces ankimimi |



Geshkëpijet

| | |
|---|---|
| | për rezultatin e provimit nga studenti. |
| **Kriteri 5.** Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra. | Personeli akademik i NjBPET ndjekin rregulla strikte për të evituar çdo formë të plagjaturës, apo kopjimit në provime dhe detyra, për studentët që frekuentojnë programin.e studimit. Ata ndjekin dhe zbatojnë rregullat e provimeve të përcaktuara në rregulloren e studimeve në UGJ **[Evidenca II.1 Rregullore e studimeve në Universitetin "Eqrem Çabej" Gjirokastër, Neni 44, pikat 9, 10]**, në Rregulloren e UGJ-së **[Evidenca I.6 Rregullore e Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastër, Nenet 86, 87, 88]** në Kodin e Etikës **[Evidenca III.9 Kodi i Etikës dhe vendimi për miratimin e Kodit të Etikës, Nenet 23, 24]** dhe në syllabuset e cdo lënde nëpërmjet "Vërejtjeve përfundimtare nga pedagogu i lëndës", hapësira ku pedagogu parashtron mendime, rekomandime, vërejtje, kufizime, rezerva që lidhen me zhvillimin e lëndës në fjalë gjatë vitit akademik **[Evidenca II.5 Programet lëndore (syllabuset) të programit të studimit MP në Turizëm 2022-2023]**.<br><br>Studentët, janë të detyruar të respektojnë dispozitat e Kodit të Etikës së Universitetit "E.Çabej" Gjirokastër, për aq kohë sa gëzojnë statusin e studentit në këtë Universitet, përfshirë këtu edhe dispozitat që parashikojnë sjelljen e tyre (mos kopjimi, mos mashtrimi gjatë procesit mësimor, plagjiaturat e çdo forme, etj.), të përcaktuara në Kodin e Etikës. **[Evidenca III.9 Kodi i Etikës dhe vendimi për miratimin e Kodit të Etikës, Nenet 25, 26]** |
| **Kriteri 6.** Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse. | UGJ, u garanton studentëve të drejtën për vlerësimin dhe marrjen e rezultateve të kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale që bazohen mbi meritë **[Evidenca III.9 Kodi i Etikës dhe vendimi për miratimin e Kodit të Etikës, Neni 8, pika 2]**.<br><br>Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.Vlerësimi përfundimtar përbëhet nga vlerësimi i vazhduar dhe vlerësimi në provim.Vlerësimi i vazhduar u jepet studentëve në përfundim të procesit mësimor. **[Evidenca I.6 Rregullore e Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastër, Neni 81, pikat 1]**.<br><br>Teza e provimit, bazuar në Rregulloren e UGJ **[Evidenca I.6 Rregullore e Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastër, Neni 83, pikat 1, 2]**, përmban pyetje që përfshijnë në mënyrë tërësore lëndën përkatëse, dhe për çdo pyetje/ushtrim paraqiten pikët përkatëse.<br><br>Provimi i lëndës zhvillohet me sekretim. Përgjegjës për sekretimin e fletoreve është Përgjegjësi i departamentit ose një person i autorizuar prej tij. Sekretimi bëhet në prani të komisionit. **[Evidenca II.6 Rregullore e Fakultetit Ekonomik Neni 34, 35]**. Rezultatet e vlerësimit përfundimtar jepen në kohë sipas procedurës së parashikuar në Rregulloren e UGJ **[Evidenca I.6 Rregullore e Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastër, Neni 90]**, Rregulloren e FE-së **[Evidenca II.6 Rregullore e Fakultetit Ekonomik, Neni 34, pika 16]** dhe në Rregulloren e NJBPET **[Evidenca II.13 Rregullore e Njësisë Bazë PET, Neni 29]** |
| **Kriteri 7.** Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e | Studentët në Universitetin "E.Çabej" Gjirokastër, gëzojnë të drejtën të njihen me vlerësimin e dijeve dhe kërkesën për rishikim të vlerësimit për të gjitha format e kontrollit të dijes të përcaktuara në syllabusin e lëndës përpara se ky vlerësim të marrë formën përfundimtare dhe njëkohësisht në raste paqartësish, ata kanë të drejtë të rishikojnë personalisht tezën e korrigjuar në prezencë të komisionit të provimit, për të marrë sqarimet e duhura. **[Evidenca** |

| | |
|---|---|
| vlerësimit. | **I.6 Rregullore e Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastër, Neni 90; Evidenca II.1 Rregullore e studimeve në Universitetin "Eqrem Çabej" Gjirokastër, Nenet 45, 46]** |
| **Kriteri 8.** Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet. | Çdo kërkesë, ankimim në lidhje me saktësinë dhe korrektësinë e vlerësimit të dijeve nëpërmjet të gjitha formave të kontrollit, të bëra prezent prej studentëve, parashikohet hollësisht në Rregulloren e studimeve në UGJ **[Evidenca II.1 Rregullore e studimeve në Universitetin "Eqrem Çabej" Gjirokastër, Neni 46].**<br>Ankesa bëhet me shkrim brenda afatit të ankimimit dhe i drejtohet Dekanit të Fakultetit. Ai përcakton nëse kërkesa e studentit është e drejtë apo jo dhe merr vendimin përkatës. Në rast se vërtetohen praktika që bien ndesh me rregulloren ateherë me propozim të Përgjegjësit të Njësisë Bazë, Dekani vendos për ndryshimin e komisionit të provimit dhe ridhënien e provimit. **[Evidenca II.1 Rregullore e studimeve në Universitetin "Eqrem Çabej" Gjirokastër ,Neni 46, pika 2]** |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi III.4**<br>**Programi i studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët dhe synojnë zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale e shkencore tek studentët.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta shkencore të studentëve. | Programi i studimit "Master Profesional" në Turizëm eshte i organizuar në mënyrë të tillë që përgjatë kohëzgjatjes së studimeve studentët të fitojnë njohuri dhe aftësi të thelluara që i përkasin fushës së turizmit si në sektorin pubik ashtu edhe në atë privat.<br><br>Ky program jep një sistem të gjerë njohurish në fushën e ndërmarrjeve turistike, marketingut turistik, bazave të turizmit, strategjisë së turizmit, ciklit të jetës së produktit turistik etj. Për realizimin e objektivave, programi i studimit parashikon thellimin e njohurive në fushat bazë të tilla si turizmi dhe trashgimia natyrore, marketingu i turizmit, menaxhimi i turizmit të qendrueshem, politikat në turizëm, ekonomia e turizmit me të cilat studenti është njohur dhe ka fituar njohuritë themelore në programin e ciklit të parë.<br><br>**[Evidenca II.2. Plani mësimor MP në Turizëm për vitin akademik 2021-2022; Evidenca II. 5 Programet lëndore (syllabuset) M.P 2022-2023]** |
| **Kriteri 2.** Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj). | Programi i studimit MP në Turizëm" për vetë natyrën e tij, garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit.<br><br>Gjatë dy viteve të studimeve, pjesë e programit janë lëndë që zhvillojnë aftesitë e studentëve mbi menaxhimin e burimeve njerëzore në industrinë e turizmit dhe mikëpritjes; marketingun e turizmit; sistemet e informacionit të menaxhimit; praktikë profesionale, etj.<br><br>Po ashtu pjesë e programit të studimit janë edhe lëndët Sjellje konsumatore në turizëm apo Menaxhim Projektesh, që zhvillojnë aftesitë e studentëve në këto fusha. **[Evidenca II.2 Plani mësimor MP në Turizëm për vitin akademik 2021-2022; Evidenca II.5 Programet lëndore (syllabuset) MP në Turizëm]** |
| **Kriteri 3.** Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të | Në fillim të çdo semestri, në javën e parë të mësimit studentët prezantohen me lëndët përkatëse dhe informohen nga pedagogu i lëndës mbi programin e plotë të lëndës, |

| | |
|---|---|
| paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre, si dhe për detyrimet përmbyllëse. | objektivat kompetencat dhe aftësitë që pritet të fitojë studenti përgjatë gjithë semestrit të cilat gjithashtu janë pjesë edhe e hartimit të syllabuseve. Këto kompetenca dhe aftësi mund të testohen përgjatë semestrit me detyra kursi, kolokiume të parashikuara në program, projekte që duhen përgatitur nga studentët dhe në fund të semestrit, përgjithësisht gjatë orëve të fundit të tij, pedagogu i lëndës i orienton studentët për provimin final, në lidhje me çëshjet kryesore që duhet të kenë parasysh, apo sipas nevojës dhe kërkesës së studënteve ofrohen edhe konsultime për diskutimin e çështjeve/temave të paqarta në mënyrë që studëntet të jenë sa më të qartë përpara zhvillimit të testimit final.<br><br>**[Evidenca II.2 Plani mësimor MP në Turizëm për vitin akademik 2021-2022; Evidenca II.5 Programet lëndore (syllabuset) e lëndeve në MP]** |
| **Kriteri 4.** Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve. | Programet lëndore në programin e studimit MP në Turizëm, kanë të përfshirë rezultatet e të nxënit në formën e kompetencave që fiton studenti.<br><br>Njohuritë e marra teorikisht zhvillohen më tej në:<br><br>- Realizimin e orëve të ushtrimeve/ laboratoreve në auditor<br>- Studimin individual jashtë auditorit<br>- Realizimin e projekteve apo detyrave të kursit, etj.<br><br>**[Evidenca II.5 Programet lëndore (syllabuset) të programit të studimit MP në Turizëm 2022-2023]**<br><br>Personeli akademik i NJBPET mbështet diskutimet dhe punën në grup të studentëve në interpretimin dhe zgjidhjen e problematikave/çështjeve të caktuara duke krijuar kushtet dhe favorizuar organizimin e punës në grup gjatë orëve të seminareve, seancave laboratorike, detyrave të kursit dhe studimit individual.<br><br>Gjatë këtij procesi studentët kanë në dispozicion bibliotekën digjitale në UGJ dhe një fond librash, të cilat ndihmojnë studentin për të zhvilluar njohuritë, për t'u aftësuar në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve. Ky fond ndihmon studentin për studime të përparuara kërkimore shkencore.<br><br>**[Evidenca III.8 Informacion për bibliotekën U-Library, Fondi i librit]**<br><br>UGJ dhe personeli akademik i NJBPET mbështet studentët për të promovuar idetë dhe mendimin e tyre si dhe për të marrë pjesë në aktivitete të programit të studimit apo në programe mobiliteti, në konferenca, projekte apo seminare studentore. **[Evidenca I.20 Lista e mobiliteteve të UGJ]; [Evidenca I.19.2 Informacion, Zyra e Marrdhënieve me Jashtë UGJ].** |
| **Kriteri 5.** Personeli akademik efektiv dhe me kontratë realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit. | Personeli akademik, efektiv dhe me kontratë, realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.<br>**[Evidenca III.13 Plani i veprimtarive akademike kërkimore shkencore të UGJ 2019-2020; Evidenca III.13.1 Plani i veprimtarive akademike kërkimore shkencore të 2021-2022; Evidenca III.13.2 Plani i veprimtarive akademike kërkimore shkencore të UGJ 2022-2023; Evidenca III.13.3 Plani i veprimtarisë së FE; Evidenca I.20 Listë e mobiliteteve]**<br>Gjatë periudhës 2019-2023 Universiteti "E. Çabej" Gjirokastër dhe NJBPET, ka qenë partner në projektin ndërkombëtar TECOMP (Strengthening Teaching Competences in Higher Education in Natural and Mathematical Sciences) të programit Erasmus+.<br>Në kuadër të këtij projekti anëtarët morën pjesë në trajnime të vazhdueshme për |

| | |
|---|---|
| | aplikimin e metodave të reja të mësimdhënies duke përdorur teknologjitë e informacionit dhe komunikimit. Këto trajnime janë kryer si në distancë (online) ashtu dhe me pjesëmarrje fizike në universitetet partnere të cilat pasqyrohen edhe në faqen zyrtare të projektit.<br><br>Përveç lektoreve të ftuar të cilët trajtojnë tematika të ndryshme brenda apo jashtë programit të studimit, personeli akademik i UGJ-se realizon përgjatë gjithë vitit akademik leksione/seminare të hapura mbi zhvillimet të reja që kanë të bëjnë me programet e studimit që institucioni ofron. Në këto takime përfshihen edhe studentët e UGJ-së duke ju mundësuar atyre zgjerimin e njohurive që i takojnë posaçërisht programit të studimit që ata ndjekin dhe jo vetëm. |
| **Kriteri 6.** Institucioni nxit zhvillimin e ideve inovative, studimeve të përparuara kërkimore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato. | UGJ-ja ndjek një politikë mbështetëse të ideve inovative, projekteve kërkimore të studentëve dhe i mbeshtet financiarisht ato. Në strategjinë e zhvillimit të UGJ-së si objektiv i kërkimit shkencor midis të tjerave renditet edhe mbeshtetja financiare për përfshirje gjithnjë e më të gjerë në projektet kërkimore-shkencore jo vetëm të stafit akademik por edhe e studentëve **[Evidenca I.2. Strategjia e Zhvillimit të UGJ-se; Kërkimi dhe Studimet Shkencore; c) Objektivat]**<br><br>Në faqen zyrtare të UGJ, vazhdimisht publikohen njoftime/thirrje për studentët e interesuar në pjesëmarrje në konkurse, aplikime për fitimin e bursave të studimit, shkolla verore/dimërore apo programe Ersamus +.<br><br>https://uogj.edu.al/category/njoftime/page/2/<br><br>https://uogj.edu.al/programi-erasmus/<br><br>http://www.uogj.edu.al/upload/Konkursi%20Punimeve%20K%C3%ABrkimore%203.jpeg |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| **Standardi III.5**<br>**Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Institucioni harton procedurë të posaçme për detyrimet përmbyllëse, para realizimit të tyre dhe i bën ato publike dhe e bën atë publike. | Në rregulloren e Fakultetit janë të përcaktuara procedurat e vlerësimit të studentëve. Në përfundim të këtij program studimi, studentët i nënshtrohen provimit përfundimtar/punimit të diplomës. Gjithashtu në këtë rregullore, është i përcaktuar pragu i notës mesatare që i jep të drejtë studentit të përgatisë dhe mbrojë një punim diplome. Rregullorja e njësisë kryesore FE, është e publikuar në faqen zyrtare të UGJ-së. Gjithashtu këto specifika dhe procedura janë të parashikuara edhe në rregulloren e programit të studimit MP në Turizëm. **[Evidenca II.6 Rregullore e njësisë kryesore FE, kreu VII, neni 39; Evidenca I.6 Rregullore e brendshme e UGJ-së, neni 93; Evidenca I.5. Rregullore e programit të studimit MP në Turizëm Neni 11]**<br><br>Punimi i diplomës bëhet duke mbajtur në konsideratë udhëzimet në Manualin e punimit të diplomës, sipas shtojcës bashkëngjitur Rregullores së studimeve në UGJ **[Evidenca II.1 Rregullore e studimeve në Universitetin "Eqrem Çabej" Gjirokastër, Neni 61; Evidenca II.1 Rregullore e studimeve në Universitetin "Eqrem Çabej" Gjirokastër, Manuali i punimit të diplomës, Shtojcat e** |

| | |
|---|---|
| | **Rregullores së Studimeve].** |
| **Kriteri 2.** Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të të detyrimeve përmbyllëse. | Njësia bazë përgjegjëse për këtë program studimi bashkë me stafin akademik që është i angazhuar në këtë program, udhëzojnë studentët mbi procesin e diplomimit. Njësia bazë, në fillim të vitit të dytë, i vë në dispozicion studentëve programin përkatës me tema orientuese që ata të mund të zgjedhin për të përgatitur temën e diplomës brenda tematikave të lëndëve që kanë ndjekur në këtë program. Kjo listë miratohet me vendim të dekanit të FE-së dhe bazohet në fushat e studimit që mbulon njësia bazë. Ndërkohë kriteret e mbrojtjes së diplomës përcaktohen në rregulloren e njësisë kryesore FE.<br><br>**[Evidenca II.6. Rregullore e njësisë kryesore FE, kreu VII, neni 40; Evidenca II.15.1 Lista fushat e përgjithshme për hartimin e temave për mbrojtjen e diplomës]** |
| **Kriteri 3.** Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike. | Provimi i përgjithshëm përfundimtar/mbrojtja e punimit të diplomës realizohet përpara një komisioni të posaçëm, të përbërë nga personel akademik të departamentit, të fushave që mbulon programi i provimit të përgjithshëm përfundimtar. Anëtarët e komisionit propozohen nga NJBPET dhe miratohen nga Dekani i Fakultetit. **[Evidenca II.1 Rregullore e studimeve në Universitetin "Eqrem Çabej" Gjirokastër, Neni 62, pika 3, Neni 64]**<br><br>Programi i provimit të përgjithshëm përfundimtar është gjithëpërfshirës, me tematika nga fushat kryesore që mbulon programi i studimit. Programi hartohet nga personeli akademik i NJBPET, miratohet nga Përgjegjësi i Njësisë Bazë, si dhe Dekani i Fakultetit. **[Evidenca II.1 Rregullore e studimeve në Universitetin "Eqrem Çabej" Gjirokastër, Neni 62, pika 2; Evidenca II.15 Program i provimit të përgjithshëm përfundimtar MP në Turizëm]**<br><br>Tezat e provimit të përgjithshëm përfundimtar hartohen në përputhje me programin e provimit të përgjithshëm përfundimtar nga anëtarët e komisionit, firmosen nga Përgjegjësi i Njësisë Bazë dhe miratohen nga Dekani **[Evidenca II.1 Rregullore e studimeve në Universitetin "Eqrem Çabej" Gjirokastër, Neni 62, pika 4; Evidenca III.11.1 Model i unifikuar i tezës së provimeve]** |
| **Kriteri 4.** Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi i asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e punimit përmbyllës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit. | Në rastin kur studenti plotëson kriterin e notës mesatare të mbrojtjes së provimit të formimit me temë diplome, ai, në bashkëpunim me pedagogun udhëheqës përcakton temën e diplomës. NJBPET, në fillim të vitit të fundit të studimeve përcaktojnë fushat e studimeve për punimin e diplomës **Evidenca II.15.1 Lista fushat e përgjithshme për hartimin e temave për mbrojtjen e diplomës].** Udhëheqësi i temës së diplomës përgatit programin e punës së studentit duke vendosur afatet e përafërta të realizimit të tij, përcakton grafikun e konsultimeve të programuara me studentin përgjatë të cilave konsultohet dhe kontrollohet puna e bërë sipas programit të miratuar. Para mbrojtjes së tezës së diplomës udhëheqësi rishikon dhe miraton punimin e kryer nga studenti dhe lejon mbrojtjen e punimit duke firmosur tezën e diplomës.<br><br>Punimi i diplomës bëhet duke mbajtur në konsideratë udhëzimet në Manualin e punimit të diplomës sipas shtojcës bashkëngjitur Rregullores së studimeve në UGJ **[Evidenca II.1 Rregullore e studimeve në Universitetin "Eqrem Çabej" Gjirokastër, Neni 61; Evidenca III.10 Manuali i punimit të diplomës, Shtojcat e Rregullores së Studimeve; Evidenca II.6. Rregullore e njësisë kryesore FE, kreu VII, neni 40]** |
| **Kriteri 5.** Institucioni asiston studentët për kryerjen e | NjBPET ofron mundësitë për të shfrytëzuar infrastrukturën laboratorike të tij për përgatitjen e temës së diplomës nën drejtimin e udhëheqësit. **[Evidenca III.2.** |

| | |
|---|---|
| matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit. | **Inventari i mjeteve didaktike e teknologjike në NJBPET]** |
| **Kriteri 6.** Në përfundim të provimit përfundimtar të përgjithshëm ose të mbrojtjes së punimit të diplomës, studenti vlerësohet me notë. | Në përfundim të provimit të përgjithshëm përfundimtar ose të mbrojtjes së punimit të diplomës, studenti vlerësohet me notë. Vlerësimi i provimit të përgjithshëm përfundimtar ose mbrojtjes së punimit të diplomës pasqyrohet në procesverbalin përkatës. Procesverbali nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e komisionit të provimit të përgjithshëm përfundimtar ose mbrojtjes së punimit të diplomës. **[Evidenca II.1 Rregullore e studimeve në Universitetin "Eqrem Çabej" Gjirokastër, Neni 62, pika 5 dhe 6, Neni 64 pika 3 dhe 4; Evidenca III.10 Manuali i punimit të diplomës, Shtojcat e Rregullores së Studimeve]** |
| **Kriteri 7.** Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar. | Studenti që ka plotësuar të gjitha kërkesat e planit mësimor dhe ka shlyer provimin e formimit apo ka mbrojtur punimin e diplomës pajiset me diplomën përkatëse, shoqëruar, me fletën e notave dhe suplementin e diplomës. **[Evidenca II.6. Rregullore e njësisë kryesore FE, kreu VII, neni 41]**<br><br>Elementet përbërës, forma e diplomës, dhe procedura për regjistrim miratohen nga ministria përgjegjëse për arsimin. **[Evidenca I.1. Statuti I UGJ-se, neni 76 si edhe Aneksi III: Suplementi i Diplomës].**<br><br>Përveç diplomes, listës së notave dhe suplementit të diplomës, studentit i vihet në dispozicion sipas kërkesës së tij i gjithë programi ciklit të dytë Master Profesional në Turizëm. |
| **Kriteri 8.** Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen. | Institucioni ruan kopje të dokumentacionit të studentit në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe në perputhje me Rregulloren për Sekretarinë Mësimore. **[Evidenca V.5. Rregullore e Sekretarisë Mësimore, neni 7, 8]**<br><br>Gjithashtu në përputhje me këtë legjislacion studentët në rast të paraqitjes së kërkesës së tyre pajisen me informacione specifike përfshirë këtu kopje zyrtare të programit të studimit, etj.<br><br>**[Evidenca II.6. Rregullore e njësisë kryesore FE, kreu VII, neni 41]**<br><br>**[Evidenca I.1. Statuti I UGJ-së, neni 76].** |

| **Shkalla e përmbushjes sëstandardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| **Standardi III.6**<br>**Në rastin e programit të studimit në "Master Profesional" institucioni ndjek një procedurë të qartë të zbatimit të njohurive nëpërmjet praktikës laboratorike, praktikës profesionale, praktikave klinike dhe stazheve.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Njësitë përgjegjëse, në funksion të mësimdhënies dhe përftimit të njohurive, garantojnë mjedise brenda ose jashtë institucionit, të përshtatshme për realizmin e praktikës laboratorike, praktikës profesionale. | Në programin e studimit MP në Turizëm ofrohet praktika profesionale në fund të semestrit të IV. Për realizimin e praktikës profesionale, UGJ ka një bashkëpunim të gjere me institucionet e Administratës Publike si dhe Biznese Private që operojnë në fushën e Turizmit, për të mundësuar realizimin e praktikës mësimore në përputhje edhe me objektivat dhe specifikat që ka programi i praktikës profesionale. Ky bashkëpunimi është i konsoliduar nëpërmjet komunikimit të vazhdueshëm, duke garantuar mbikqyrjen e |

| | |
|---|---|
| | vazhdueshme të studentëve gjatë praktikave profesionale. Ky bashkëpunim i ndërsjelltë e ndihmon institucionin të evidentojë nevojat e tregut të punës, si edhe të riorganizojë programin e studimit duke e pasuruar me lëndë të orientuara më tepër drejt praktikës duke mundësuar në këtë mënyrë integrimin më të shpejtë të studentëve në tregun e punës.<br>Për realizimin e praktikës mësimore, UGJ-ja ka marrëveshje bashkëpunimi me këto institucione publike rajonale dhe lokale: Këshilli i Qarkut Gjirokastër, Dhoma e Tregëtisë dhe Industrisë, Drejtoria Rajonale e Shërbimit Kombëtar të Punësimit Gjirokastër, Bashkia Gjirokastër, DAR, Prefektura Gjirokastër, etj. **[Evidenca I.18. Lista e Marrëveshjeve të bashkëpunimit të Universitetit "Eqrem Çabej"]** |
| **Kriteri 2.** Institucioni, në bashkëpunim dhe partneritet, garanton realizimin e praktikave klinike dhe stazheve me format dhe teknologjinë më të fundit bashkëkohore me qëllim përfitimin më mirë të njohurive dhe kompetencave profesionale. | Përgjatë semestrit të IV, studenti falë bashkëpunimit të nënshkruar midis UGJ-së dhe institucioneve publike dhe private, asiston në mjediset e tyre dhe përdor teknologjinë që vetë këto insitucione zotërojnë për të parë nga afër mënyrën e realizimit të punës, procedurat e ndryshme që ndjekin këto institucione në varësi edhe të specifikave që vetë institucioni ka. Vetë afati 3 - mujor që korrespodon me kohëzgjatjen e semestrit të fundit, të vitit të dytë të studimeve MP në Turizëm, i jep mundësi studentit që të përshtatet me klimën dhe teknologjinë e e aplikuar në fushën e turizmit duke lejuar në këtë mënyrë përfitimin më të mirë të njohurive dhe kompetencave profesionale. |
| **Kriteri 3.** Praktikat profesionale, klinike dhe stazhet e zhvilluara gjatë studimeve, ekuivalentohen në kredite dhe dokumentohen në dokumente të posaçme duke e shoqëruar me mendimin e trajnerëve dhe vlerësimin përkatës. | Në përfundim të praktikës profesionale, studenti bën mbrojtjen e saj para një komisioni prej dy pedagogesh duke paraqitur nje listë me dokumenta si edhe vërtetimin përkatës lëshuar nga titullari/administrator i institucionit ku ai ka realizuar praktikën të cilat shqyrtohen dhe studenti vlerësohet me notën përkatëse. Kur studenti vlerësohet me notë kaluese nga komisioni I praktikës profesionale, përfiton dhe kreditet përkatëse të saj (në total 12 kredite)<br><br>**[Evidenca II.6. Rregullore e Njësisë Kryesore, FE, neni 29.]**;<br><br>**[Evidenca II.2 Plani mësimor i programit të studimit të ciklit të II: Master Profesional në Turizëm]** |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

## IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

| Standardi IV.1<br>**Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Personeli akademik efektiv dhe me kontratë, personeli ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbush kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e duhur të kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve mësimore të programit. Ka fushë kërkimore në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij. | NJBPET, që mbulon programin e studimit MP në Turizëm, ka një përvojë dhe burime njerëzore në fushën akademike në përshtatje me qëllimin kryesor të tij që është përcjellja e dijes tek studentët. Mënyra e organizimit të NJBPET dhe struktura hierarkike e saj janë në funksion të përmbushjes së misionit dhe objektivave të përcaktuara. Personeli akademik dhe ndihmës akademik, që angazhohen në realizimin e këtij programi përmbushin kërkesat ligjore në fuqi, bazuar në Nenin 25, pika 4 dhe Nenin 59, pikat 3, 4, 5 dhe 6 të Ligjit Nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" pasi ka nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin, dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve të programit të studimit dhe ka së paku kualifikim të ciklit pasardhës. **[ANEKS-Tabelat Përmbledhëse Tabelat 7. Cilësia e stafit mësimdhënës për programin e studimit MP në Turizëm]** Për këtë program studimi për vitin akademik 2022-2023 janë të angazhuar 10 personel staf akademik efektiv (PAE), (nga të cilët 4 pedagogë të vetë NJBPET, 4 pedagogë të Njësisë bazë të Kontabilitet Financës, 1 pedagog i Njesisë Bazë të Administrimit Publik, 1 pedagog i Departamentit Histori Gjeografi. Niveli i kualifikimit të personelit akademik që mbulon programin e studimit MP në Turizem është në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e lëndëve të tij.<br>**[ANEKS-Tabelat Përmbledhëse Tabela 7. Cilësia e stafit mësimdhënës për programin e studimit; Evidenca III.3 CV-të e personelit akademik dhe ndihmës akademik; Evidenca ANEKS-Tabelat Përmbledhëse, Tabelat 12.1, 12.2, 12.3 Plani mësimor i lidhur me personelin akademik përkatës].**<br>Kualifikimet dhe publikimet e personelit akademik pasqyrohen në Raportet Vjetor të veprimtarisë mësimore shkencore të NJBPET, dhe në Raportet Vjetore të veprimtarisë mësimore kërkimore të FE-së.<br>**[Evidenca I.14.12 Raporti i veprimtarisë mësimore shkencore në NJBPET 2019 -2020; Evidenca I.14.13 Raporti i veprimtarisë mësimore shkencore në NJBPET 2020-2021; Evidenca I.14.14 Raporti i veprimtarisë mësimore shkencore në NJBPET 2021-2022; Evidenca I.14.6 Raport vjetor i veprimtarisë mësimore kërkimore FE 2019-2020; Evidenca I.14.8 Raport vjetor i veprimtarisë mësimore kërkimore FE 2020-2021; Evidenca I.14.10 Raport vjetor i veprimtarisë mësimore kërkimore FE 2021-2022;** |
| **Kriteri 2.** Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi. | Personeli akademik efektiv mbulon ngarkesën mësimore të programit të studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi bazuar në Ligjin Nr. 80/2015, Neni 59, pikat 3, 4, 5, 6 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" si dhe V.K.M Nr.418, datë 10.05.2017 "Për standardet, kriteret dhe procedurat për hapjen, riorganizimin, ndarjen, bashkimin ose mbylljen e Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe të degëve të tyre".<br>**[Evidenca IV V.K.M Nr.418, datë 10.05.2017, pika 2, gërma a, nënpika** |

| | |
|---|---|
| | **xii, pika 2, gërma b, nënpika i, nënpika ii; Evidenca ANEKS-Tabelat Përmbledhëse, Tabelat 12.1, 12.2, 12.3 Plani mësimor i lidhur me personelin akademik përkatës; Evidenca II.18.3 Raporti i kapaciteteve pritëse viti akademik 2023-2024].**<br>Personeli akademik efektiv ka së paku kualifikimin e ciklit pasardhës dhe mbulon jo më pak se 70% të ngarkesës mësimore për programin e studimit Bachelor në Turizëm. Sipas listës së stafit akademik për programin e studimit Bachelor ne Turizëm rezulton se 100 % të nevojave plotësohen me staf akademik efektiv. Gjithashtu jane në dispozicion një sërë zyrash mbështetëse që mundësojne përmbushjen me sukses të objektivave të programit të studimit të ciklit të parë. |
| **Kriteri 3.** Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore. | Fakulteti Ekonomik, NJBPET ka një personel akademik efektiv të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore, informacion ky i konfirmuar edhe nga Zyra e Financës dhe Drejtoria e Burimeve Njerëzore të UGJ-së.<br>**[Evidenca IV.3 Listëpagesa, Sigurimet shoqërore dhe shëndetësore të personelit akademik Janar-Maj 2023; Evidenca IV.3.1 Model Kontratë punësimi]** |
| **Kriteri 4.** Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit. | UGJ harton dhe zbaton procedura për rekrutimin e personelit akademik, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore duke garantuar një proces transparent, të paanshëm dhe objektiv.<br>**[Evidenca I.1 Statuti i Universitetit "Eqrem Çabej", Gjirokastër, Neni 56; Evidenca I.6 Rregullore e Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastër, Nenet 27, 29; Evidenca II.12 Rregullore e punësimit të personelit akademik dhe administrativ, Nenet 3, 5, 8 dhe 9]**<br>NJBPET, bazuar në nevojat e tij, përcakton kriteret e përgjithshme **[Evidenca I.6 Rregullore e Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastër]** dhe specifike të punësimit të personelit akademik në përputhje me natyrën, strukturën, lëndët mësimore dhe përmbajtjen e programit të studimit<br>Dekani pasi i verifikon paraprakisht dhe është dakort me to, i përcjell për miratim në Rektorat për ndjekjen e mëtejshme të procedurave për shpalljen e vendeve të lira të punës në Buletinin e Prokurimeve Publike si dhe në faqen zyrtare web të Universitetit. Në rast se rektori konstaton parregullsi, kërkesa kthehet për rishqyrtim në njësinë bazë përkatëse. **[Evidenca I.1 Statuti i Universitetit Eqrem Çabej, neni 58]**. Pas miratimit të kërkesës dhe kritereve nga Rektori dhe shpalljes së tyre në Buletinin e Njoftimeve Publike, ai me urdhër ngre një komision "ad-hoc" për shqyrtimin dhe vlerësimin e kandidaturave për vendin vakant me 5(pesë) anëtarë, i përbërë nga Dekani i Fakultetit i cili kryeson komisionin **[Evidenca I.1 Statuti i Universitetit "Eqrem Çabej", Gjirokastër, Neni 33, gërma "h"]**, 3 (tre) anëtarë pjesë e e personelit akademik të Njësisë bazë përkatëse dhe 1(një) anëtar nga Rektorati. Struktura e manaxhimit të burimeve njerëzore mbështet komisionin "ad-hoc" në zhvillimin e procedurave konkurruese **[Evidenca IV.5 Procedurë e punësimit të personelit akademik në NJBPET]**<br>Në rastin e konkursit të punësimit të personelit akademik me kohë të pjesshme dhe kohëzgjatje të caktuar komisioni "ad-hoc" ngrihet nga Dekani i Fakultetit. **[Evidenca I.1 Statuti i Universitetit "Eqrem Çabej", Gjirokastër, Neni 33, gërma "f"]**<br>Modalitetet e plota mbi procedurat e punësimit të personelit akademik dhe ndihmës-akademik, si dhe ato të vlerësimit të kandidatëve konkurues përcaktohen në |

| | |
|---|---|
| | rregulloren "*Për punësimin dhe përzgjedhjen e stafit akademik dhe atij administrativ të UGJ-së*". **[Evidenca II.12 Rregullore e punësimit të personelit akademik].** Klasifikimi i kandidatëve i përcillet rektorit përmes strukturës së menaxhimit të burimeve njerëzore, i cili, në se nuk gjen parregullsi, shpall fitues kandidatin e parë në renditje dhe nënshkruan kontratën e punës.<br>Në përputhje me nenin 59, pika 6 e Ligjit 80/2015, të gjithë pedagogët e angazhuar në programin e aplikuar për akreditim Bachelor ne Turizem mbajnë gradë minimalisht të ciklit pasardhës kundrejt programit ku janë angazhuar në mësimdhënie. |
| **Kriteri 5.** Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit. | UGJ siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore.<br>**[Evidenca I.1 Statuti i Universitetit "Eqrem Çabej", Gjirokastër, Neni 45; Evidenca I.6 Rregullore e Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastër, Neni 37; Evidenca II.6 Rregullore e Fakultetit Ekonomik, Neni 15]**<br>Pjesë përbërëse e NJBPET në ndihmë të realizimit të orëve laboratorike dhe mirëmbajtjes së laboratorëve dhe pajisjeve përkatëse në to dhe mjediseve të tjera mësimore është edhe 1(një) personel ndihmës akademik me karakter mësimor, i cili zotëron aftësitë e nevojshme profesionale për vëndin përkatës të punës.<br>**[Evidenca II.13 Rregullorja e NJBPET; Evidenca I.12 Organograma e Fakultetit Ekonomik; Evidenca I.13 Organograma e NJBPET; Evidenca III.3 CV-të e personelit akademik dhe ndihmës akademik Evidenca II.12 Rregullore e punësimit të personelit akademik].** |
| **Kriteri 6.** Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ. | Bazuar në Statutin e UGJ-së **[Evidenca I.1 Statuti i Universitetit "Eqrem Çabej",Gjirokastër, Nenet 41, 42]**, funksionon Sektori i Shërbimeve Juridike, Personelit dhe Sekretari-protokoll, si pjesë e Drejtorisë së Shërbimeve Ndihmës-akademike Administrative (DSHNA), e cila është struktura përgjegjëse për mbledhjen, ruajtien dhe përditësimin e të dhënave personale të personelit akademik, ndihmës-akademik dhe administrative parashikuar në Rregulloren e saj dhe në në përputhje me legjislacionin në fuqi **[Evidenca IV.4 Rregullore për organizimin dhe funksionimin e DSHNA, nenet 4, 5; Evidenca IV.3.2 Model dosje personeli].**<br>Këto të dhëna përfshijnë CV-të e personelit (formati i CV-ve është i standartizuar sipas formatit europass), kartën e identitetit, pozicionin e punës, diplomat dhe listat e notave, gradat shkencore dhe titujt akademik, dëshmi të gjuhëve të huaja, dëshmi të trajnimeve dhe kualifikimeve të ndryshme, dëshmi penaliteti, raport mjeko-ligjor etj.<br>Përsa i përket promovimit akademik dhe aktivitetit kërkimor shkencor të personelit akademik në UGJ funksionon Sektori i Kërkimit Shkencor dhe Marredhënieve me Jashtë, i cili mbledh, ruan dhe përditëson të dhëna mbi kërkimin shkencor të personelit akademik, pjesmarrjes në projekte kombëtare/ndërkombëtare, zhvillimit të kapaciteteve didaktike dhe kërkimore shkencore nëpërmjet mobiliteteve të ndryshme në institucionet e arsimit të lartë jashtë vendit si dhe pjesëmarrjes në trajnime e workshope.<br>**[Evidenca IV.4 Rregullore për organizimin dhe funksionimin e DSHNA, Neni 17]**<br>Të dhënat përfshijnë gjithashtu edhe angazhimin e personelit akademik në çdo vit akademik dhe semester si dhe planifikimin e kohës vjetore të punës të personelit akademik dhe ndihmës akademik, të dhëna që arkivohen pranë DMIF-së. |



Geshkepije

| | |
|---|---|
| | **[Evidenca II.6 Rregullore e Fakultetit Ekonomik, Neni 13, pika 2]; [Evidenca II.13 Rregullore e NJBPET]; [Evidenca IV.6 Model i ngarkesës mësimore të personelit akademik; Evidenca IV.6.1 Model planifikimi i kohës vjetore të punës të personelit akademik]**<br>Në Statutin e UGJ-së, Rregulloren e UGJ-së, Rregulloren e FE-së si dhe Rregulloren e NJBPET përcaktohen edhe detyrat e personelit ndihmës akademik me karakter mësimor.<br>**[Evidenca I.1 Statuti i Universitetit "Eqrem Çabej", Gjirokastër, Neni 45, pika 3; Evidenca I.6 Rregullore e Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastër, Neni 41;**<br>Mbledhja, ruajtja dhe përditësimi për çdo vit akademik i këtyre të dhënave, bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale dhe Rregulloren për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale. **[Evidenca IV.1 Rregullore për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale]** |
| **Kriteri 7.** Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit. | UGJ, në bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit. Pedagogë të kualifikuar të këtij departamenti ndjekin studentët në praktikat mësimore duke i sqaruar e këshilluar për problemet e ndryshme që mund të dalin gjatë këtyre praktikave. NJBPET në fillim të vitit të dytë të studimeve në MP ne Turizëm, përcakton fushat e studimeve për punimin e diplomës. **[Evidenca II.15.1. Lista me fushat e përgjithshme për hartimin e temave për mbrojtjen e diplomës]** Udhëheqësi i temës së diplomës përgatit programin e punës së studentit, duke vendosur afatet e përafërta të realizimit të tij, përcakton grafikun e konsultimeve të programuara me studentin përgjatë të cilave konsultohet dhe kontrollohet puna e bërë sipas programit të miratuar. **[Evidenca II.1 Rregullore e studimeve në Universitetin "Eqrem Çabej" Gjirokastër, Neni 61, Evidenca III.10 Manuali i punimit të diplomës, Shtojcat e Rregullores së Studimeve]**<br>NJBPET ofron mundësitë për të shfrytëzuar infrastrukturën laboratorike të FE për përgatitjen e temës së diplomës nën drejtimin e udhëheqësit. |
| **Kriter 8.** Personeli mbikqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale. | Personeli mbikqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, vazhdimisht ndihmon studentët në përmbushjen e detyrimeve gjatë praktikës mësimore, raportin përfundimtar të praktikës si dhe jep gjykimin e vet në procesin e vlerësimit të studentëve për praktikën profesionale. |

| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

REPUBLIKA E SHQIPËRISË UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR



Geshkepijey

| Standardi IV.2<br>**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse. | UGJ ka nje traditë të gjatë si një univversitet i mirë-angazhuar dhe i kualifikuar në mësimdhënie. Në mjediset e tij përdorimi i teknologjive më të fundit përforcon ndërveprimin ndërmjet pedagogëve dhe studentëve duke përmirësuar përvojën e të mësuarit të studentëve. FEUGJ ka hapësira të mjaftueshme dhe cilësore në funksion të procesit mësimor të këtij programi studimi.<br><br>Auditorët e FE-së janë të mirë-pajisura me teknologjinë e duhur për të lehtësuar aktivitetet e punës në grup, diskutimet dhe simulimet e rasteve studimore, ndërsa sallat e laboratorëve si dhe vendosja e projektorëve dhe pajisjeve kompjuterike, mbulimi me *wi fi*, etj, në mjediset e fakultetit janë një mbështetje mjaft solide për stafin akademik dhe studentët. Nga ana tjetër, mbështetja e procesit të mësimdhënies nga sistemi TEAMS, edhe jashtë auditorëve, mundëson përdorimin e mjeteve të reja të dobishme për mësimdhënien dhe mësimin elektronik (e-learning).<br><br>UGJ ushtron aktivitetin e tij në 3 (tre) godina universitare: Godina A me sipërfaqe 3255.5 $m^2$, Godina B me sipërfaqe 1937 $m^2$ dhe godina C me sipërfaqe 729.6 $m^2$, **[Evidenca IV.7 Infrastruktura e UGJ]**. Këto godina janë të ndërtuara me materiale cilësore bashkëkohore të cilat plotësojnë kushtet higjieno-sanitare për studentët dhe personelin akademik e administrativ. **[Evidenca IV.7.1 Leje higjeno sanitare]**. Godinat plotësojnë standartet teknike dhe ofrojnë akustikë të mirë dhe janë të izoluara nga zhurmat, luhatjet e temperaturës dhe lagështirës. Godinat shtrihen në qendër të zonës urbane larg zonave të zhvillimit industrial apo me ndotje, të cilat gjenden në periferi të qytetit.<br>UGJ i plotëson normativat teknike të ndriçimit natyral, sipërfaqja e dritareve mbulon minimalisht (15 – 20) % të sipërfaqes së dyshemesë dhe ndriçimi është i orientuar nga krahu i majtë i studentit, dhe lartësia e ambienteve është jo më e vogël se 3.0 m (tavan-dysheme). UGJ ka një sistem të mbrojtjes së shkarkesave atmosferike si dhe një sistem të mbrojtjes kundra zjarrit. Çdo godinë është e pajisur me sinjalizues dhe në hollet e çdo godine janë të instaluara bombola kundra zjarrit si dhe hidratantë, të cilët janë të shoqëruar edhe me sinjalistikën përkatëse **[Evidenca IV.7.2 Çertifikatë për sigurinë nga zjarri]**.<br>Institucioni siguron në pjesën më të madhe të sallave dhe zyrave sisteme ajri të kondicionuar, ndërkohë që Godinat A, B dhe C kanë të instaluar sistemin e ngrohjes së centralizuar (kaldaja). UGJ disponon burime alternative për furnizimin me energji elektrike (një motogjenerator në Godinën A) dhe rezerva të mjaftueshme të ujit të përdorshëm, pasi uji është i pandërprerë 24 orë.<br>Bazuar në Raportin e MAS-së mbi "*Verifikimin e kapaciteteve pritëse për pranimet në programet e studimit, sipas kuotave të deklaruara për vitin akademik 2023-2024*", UGJ ofron një normativë të pritshme mesatare prej 2.5 $m^2$/student, llogaritur kjo në dy fasha orare kjo normativë shkon në 5 $m^2$/student **[Evidenca II.18.3 Raporti i kapaciteteve pritëse viti akademik 2023-2024]** |

| | |
|---|---|
| | UGJ siguron mjediset të përshtatshme në funksion të veprimtarisë mësimore dhe në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit Bachelor në Turizëm dhe lëndëve të tij, si dhe në përputhje me standartet dhe normativat për infrastrukturën, të përcaktuara në V.K.M Nr.418, datë 10.05.2017 "Për standardet, kriteret dhe procedurat për hapjen, riorganizimin, ndarjen, bashkimin ose mbylljen e Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe të degëve të tyre. **[Evidenca IV V.K.M Nr.418, datë 10.05.2017; Evidenca II.18.3 Raporti i kapaciteteve pritëse viti akademik 2023-2024; Evidenca IV.7 Infrastruktura e UGJ; ANEKS-TABELAT PËRMBLEDHËSE Mjediset e Fakultetit/Njësive Bazë (Tabela 16)]** Veprimtaritë mësimore si leksionet dhe seminaret e programit të studimit, zhvillohen në Godinën A, kurse laboratorët e Informatikës ndodhen në Godinën B. Mirembajtja dhe përditësimi i pajisjeve kompjuterike bëhet nga stafi i Degës se IT-së. Në të njëjtën kohë programet kompjuterike iu janë përshtatur programeve mësimore duke instaluar programet aplikative që kërkohen nga departamenti përgjegjës për këtë program studimi. |
| **Kriteri 2.** Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies. | Për realizimin me sukses të procesit mësimor në programin e studimit MP në Turizëm, UGJ ka vendosur në dispozicion të NJBPET infrastrukture hard dhe soft bashkëkohore te tilla si klasa, laboratorë, si dhe mjedise të tjera për personelin akademik dhe ndihmës akademik, të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që kanë akses të plotë në rrjetin Lan dhe WiFi Internet, në ndihmë të përgatitjes dhe të realizimit të procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies. **[Evidenca III.2. Inventari i mjeteve didaktike e teknologjike në NJBPET]** |
| **Kriteri 3.** Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimit teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi. | Laboratorët dhe mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimit teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi. Për plotësimin e kërkesave të lëndëve mësimore, aftësimit teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit Master Profesional në Turizëm në tërësi, NJBPET disponon 3 (tre) laboratorë të Informatikës (Godina B, Sallat 401, 402, 403) të pajisur me PC, rrjete kompjuterike dhe WiFi Internet, videoprojektorë dhe 2(dy) klasa dixhitale, (Godina B, sallat 301, 302) **[Evidenca III.2. Inventari i mjeteve didaktike e teknologjike në NJBPET]** |
| **Kriteri 4.** Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron. | UGJ në tërësi dhe FE në veçanti disponon disa laboratorë të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ai ofron. NJBPET disponon 3 (tre) laboratorë të Informatikës (Godina B, Sallat 401, 402, 403) të pajisur me programe kompjuterike ekonomike si Kontabiliteti Alfa etj. **[Evidenca IV.7 Infrastruktura e UGJ; Evidenca III.2. Inventari i mjeteve didaktike e teknologjike në NJBPET]** |
| **Kriteri 5.** Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera (vërtetuar nëpërmjet marrëveshjeve të posaçme të bashkëpunimit), që mjediset janë të | UGJ garanton, me kapacitetet që zotëron dhe në bashkëpunim me subjekte të tjera, si firmat që operojnë në fushën e turizmit dhe hotelerisë, operatorët turistikë dhe institucione publike etj. (vërtetuar nëpërmjet marrëveshjeve të posaçme të bashkëpunimit), që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike. Rajoni I Gjirokastrës me të gjithë zhvillimin e tij turistik, |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike. Në rastet e programeve të studimit në fushën mjekësore, institucioni duhet të sigurojë strukturat spitalore dhe ambulatore me kapacitetet e nevojshme. | shërben si një mbeshtetje e fuqishme trajnimi dhe praktike për studentët e fushës së turizmit. | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | X |

| **Standardi IV.3**<br>**Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit. | Në zbatim të Rregullores së studimeve në UGJ, literatura bazë e detyrueshme përbëhet nga tekstet mësimore dhe ciklet e leksioneve.<br>**[Evidenca II.1 Rregullore e studimeve në Universitetin "Eqrem Çabej" Gjirokastër, Neni 27; Evidenca II.6 Rregullore e Fakultetit Ekonomik, Neni 22; Evidenca II.13 Rregullore e NJBPET; Evidenca I.5 Rregullore e Programit të Studimit MP në Turizëm]**<br>Literatura bazë dhe ndihmëse e lëndeve që i përkasin Turizmit ofrohet kryesisht në gjuhën shqipe dhe mbështetet kryesisht në tekste mësimore të botuara nga autoritete të mirënjohur shkencorë të Universiteteve publike, kryesisht Universitetit të Tiranës, por edhe në gjuhën angleze dhe u përkasin autorëve të mirënjohur të huaj të kësaj fushe.<br>Literatura bazë dhe ndihmëse u vihet në dispozicion studentëve në formë fizike dhe/ose digjitale, dhe garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme të parashikuara në këtë program studimi.<br>Gjithashtu dhe fondi i literaturës fizike dhe online në Bibliotekën e Universitetit mbështet marrjen e dijeve të nevojshme në këtë program studimi.<br>Literatura bazë dhe ndihmëse propozohet nga anëtaret e personelit akademik, shqyrtohet dhe aprovohet nga NJBPET dhe pasqyrohet në programet lëndore të programit të studimit.<br>**[Evidenca II.6 Rregullore e Fakultetit Ekonomik, Neni 19, pika 7, Neni 21, pika 1, Neni 22 ; Evidenca II.13 Rregullore e NJBPET; Evidenca I.5 Rregullore e Programit të Studimit MP në Turizëm; Evidenca II.5.4 Miratimi i literaturës bazë në NJBPET; Evidenca II.5; II.5.1; II.5.2 Programet lëndore (syllabuset) të programit të studimit MP në Turizëm 2020-2023]** |
| **Kriteri 2.** Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësime të literaturës me botime të viteve të fundit. | FE dhe NJBPET, miraton literaturen e përditësuar, paraqet propozimin e tij për përditësimin e literaturës me botime të viteve të fundit. Propozimet e NJBPET miratohen sipas procedurave përkatëse të Institucionit. **[Evidenca IV.8 Raportime nga biblioteka për departamentin]**<br>Biblioteka paraqet kërkesat e saj për pasurimin e fondit të saj në çdo fillim viti akademik, duke kërkuar të ketë një zë përkatës në buxhetin institucional. Përveç pasurimit periodik që realizohet me fondet e UGJ-së, literatura e Bibliotekës pasurohet edhe përmes donacioneve të miqve të UGJ-së. |



Gjeshtëpjoj

| | |
|---|---|
| | **[Evidenca III.8 Informacion për bibliotekën U-Library, Fondi i librit]** |
| **Kriteri 3.** Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit. | UGJ vë në dispozicion të studentëve dhe personelit akademik, në mbështetje të procesit mësimor dhe formimit të tyre professional, Bibliotekën Akademike e cila ndodhet në Godinën C të Universitetit.<br>Biblioteka disponon 3 (tre) salla leximi, të cilat janë të pajisura me kompjutera dhe me mjete audio vizive. Biblioteka disponon fond librash në gjuhën shqipe dhe gjuhë të huaj, në të cilat gjëndet një numër tekstesh të fushës së programit të studimit MP në Turizëm. Biblioteka shërben edhe si sallë interneti **[Evidenca III.8 Informacion për bibliotekën U-Library, Fondi i librit]**<br>Të gjithë studentët kanë mundësi të barabartë në përdorimin e saj. Literatura mësimore mund të shfrytëzohet në ambjentët e Bibliotekës ose dhe jashtë saj. Studenti disponon një kartelë personale të përdoruesit, përmes së cilës siguron literaturën. Kartela personale e përdoruesit përmban informacione të tilla si numrin e kartelës, emër, mbiemër, atësinë, adresën e banimit, numrin personal të identifikimit, numrin e telefonit, fakultetin, degën etj, si dhe nënshkrimin e përgjegjësit të bibliotekës dhe lexuesit. **[Evidenca IV.9 Biblioteka, Kartelë personale e përdoruesit]**<br>UGJ ka vënë në dispozicion të studentëve edhe përdorimin e librarive elektronike ku ata mund të shfrytëzojnë edhe literaturë në gjuhë të huaj.<br>**[Evidenca III.8 Informacion për bibliotekën U-Library, Fondi i librit]** |
| **Kriteri 4.** Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit. | Biblioteka e Universitetit "Eqrem Çabej" është e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit në degën Kontabilitet – Financë dhe degëve të tjera. Literatura e ofruar, përmes Bibliotekës është multidisiplinare. Në Bibliotekë gjenden tituj nga fusha të ndryshme studimi, Të interesuarit gjejnë në Bibliotekë literaturë për çështje të përgjithshme, për shkencën dhe diturinë, për filozofinë, psikologjinë, shkencat shoqërore dhe nëndarjet e tyre, ekonominë dhe nëndarjet e saj, drejtësinë, matematikën dhe shkencat e natyrës, shkencat e aplikuara si mjekësia dhe teknologjia, linguistika dhe letërsia, historia, gjeografia, si dhe materiale që trajtojnë artin, kulturën dhe sportin.<br>**[Evidenca III.8 Informacion për bibliotekën U-Library, Fondi i librit]** |
| **Kriteri 5.** Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit. | UGJ në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, mbështur prej MAS, ka mundësuar për stafin akademik dhe studentet shërbimin "on-line" të Bibliotekës "ULibrary".**[https://ulibrary.rash.al/]**.<br>Në faqen zyrtare web të UGJ -së, **[https://uogj.edu.al/biblioteka-online/]**, personeli akademik dhe studentët kanë mundësi të aksesojnë "on-line", literaturë të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit duke ndjekur udhëzimet e manualit përkatës. Ky shërbim ofrohet pa pagesë për studentët dhe personelin akademik. **[Evidenca IV.9.1 Bibloteka,Manuali i përdorimit]**<br>Gjithashtu, nëpërmjet abonimit të Bibliotekës në revista shkencore ndërkombëtare online, studentëve/pedagogeve ju ofrohet mundësia e aksesimit të literaturës në gjuhë të huaj. **[Evidenca III.8 Informacion për bibliotekën U-Library, Fondi i librit]** |
| **Kriteri 6.** Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa | Biblioteka është e pajisur me kompjutera, programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët për kërkimin e literaturës qoftë për t'u përdorur përgjatë studimit qoftë për të realizuar temat e diplomës. |



Gjeshkepijey

| | |
|---|---|
| kufizim për të gjithë studentët. | **[Evidenca III.8 Informacion për bibliotekën U-Library, Fondi i librit]** |
| **Kriteri 7.** Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj. | Biblioteka ofron shërbimin prej punonjësve të saj për studentët dhe personelin akademik ditët e javës, e Hënë-e Premte (me përjashtim të ditëve zyrtare të pushimit), në orarin 8.00--19.00, në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor por dhe përtej tyre, në përgjigje të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj. Orari është i afishuar në mjediset e institucionit dhe në hyrje të Bibliotekës. Për çdo student ka kartelë personale të përdoruesit. Njëkohësisht, për shkak të disponimit të bibliotekës online, oraret e aksesimit të informacionit nga studentët janë fleksibël dhe çlirojnë kapacitetet për përdorimin optimal të mjedisit fizik të bibliotekës.<br>**[Evidenca IV.9.2 Rregullore e Bibliotekës; Evidenca IV.9 Biblioteka, Kartelë personale e përdoruesit]** |
| **Kriteri 8.**Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik. | Biblioteka ndjek dhe raporton mbi cilësinë e fondit fizik të saj dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah efektshmërinë e përpjekjeve për pasurim të fondit fizik, dhe atij online<br>**[Evidenca IV.8 Raportime nga biblioteka për departamentin; Evidenca III.8 Informacion për bibliotekën U-Library, Fondi i librit]** |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| **Standardi IV.4**<br>**Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit. | UGJ është pjesë e rrjetit akademik shqiptar RASH dhe QSHA. Nëpërmjet platformave të ofruara prej tyre realizohet procesi i aplikimit dhe regjistrimit on-line të kandidatëve (maturantëve U-Albania) në programet e UGJ-së, si dhe matrikullimi i studentëve, bazuar në të dhënat e detajuara të përcjella nga UGJ.<br>UGJ në përputhje me Neni 101 të Ligjit te arsimit te lartë, Statutin e UGJ-së **[Evidenca I.1 Statuti i Universitetit "Eqrem Çabej", Gjirokastër, Neni 44]** si dhe Rregulloren e Sekretarisë Mësimore **[Evidenca III.12 Rregullore e sekretarisë mësimore, Neni 4]** administron:<br>• Regjistrin themeltar të studentëve.<br>• Regjistrin e arritjeve akademike.<br>• Regjistrin e lëshimit të diplomave dhe çertifikatave. |



Gjeshkepijay

| | |
|---|---|
| | UGJ disponon gjithashtu sistemin elektronik Pitagora, aplikacion softuerik i sekretarisë online i zhvilluar nga RASH (Rrjeti Akademik Shqiptar), që ofron funksionalitete për administratën, sekretarinë dhe përdoruesit fundor (student, pedagog, etj.) **[https://uogj.pitagora.rash.al/login]**<br>Disa nga funksionalitetet kryesore të kësaj platforme janë:<br>**Hapësira didaktike:** Struktura Akademike, Menaxhimi i Karrierës së Studentit, Provime dhe Tema e Diplomës<br>**Hapësira administrative:** Pranimi dhe Regjistrimi, Orari dhe provimet, Menaxhimi i Studentëve<br>**Tarifat:** Menaxhimi i Tarifave të studimit, Bursa për studentët, Periudha Financiare<br>**Diplomimi:** Provimet e Shtetit, Praktika studentore, Diploma Online dhe Suplementi<br>Në UGJ ka funksionuar për disa vite edhe sistemi elekronik i automatizimit të proceseve të sekretarisë mësimore dhe shërbimeve online për studentët **ESSE3** me funksionalitetet e përcaktuara në Rregulloren e programit të dixhitalizimit të sistemit universitar Esse3.<br>**[Evidenca IV.10 Rregullore e programit të dixhitalizimit të sistemit universitar Esse3]** |
| **Kriteri 2.** Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit. | Në UGJ menaxhimi i dokumentacionit të personelit akademik, ndihmës akademik dhe administrativ realizohet nga Drejtoria e Shërbimeve Ndihmës Akademike – Administrative, nëpërmjet Sektorit të Shërbimeve Juridike, Personelit dhe Sekretari Protokol të cilët menaxhojnë:<br>• regjistrin themeltar<br>• dosjet personale të punonjësve<br>• librezat e punës së punonjësve<br>dhe çdo dokumentacion tjetër të dhënë nga Rektori, apo Administratori i Universitetit.<br>**[Evidenca IV.4 Rregullore për organizimin dhe funksionimin e DSHNA, Nenet 3, 4, 5]**<br>Sektori i Kërkimit Shkencor dhe Marrëdhënieve më Jashtë administron dhe përditëson bazën e të dhënave të kërkimit shkencor të personelit akademik dhe kërkimor. **[Evidenca I.1 Statuti i Universitetit "Eqrem Çabej", Gjirokastër, Neni 82]**<br>Bazuar Rregulloren e FE-së **[Evidenca II.6 Rregullore e Fakultetit Ekonomik, Neni 46]**, FE dhe NJBPET ruan me kujdes dokumentacionin përkatës në lidhje me personelin akademik si: ngarkesën vjetore mësimore, marrëveshjet e realizimit të kohës vjetore të punës, programet lëndore etj.<br>**[Evidenca IV.6 Model i ngarkesës mësimore të personelit akademik; Evidenca IV.6.1 Model planifikimi i kohës vjetore të punës të personelit akademik; Evidenca II.5; II.5.1; II.5.2 Programet lëndore (syllabuset) 2020-2023]** |
| **Kriteri 3.** Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit. | UGJ nëpërmjet sistemit elektronik Pitagora **[https://uogj.pitagora.rash.al/login]**, u siguron akses të dedikuar dhe konfidencial në informacione dhe dokumente, të gjithë personelit akademik, ndihmës-akademik dhe studentëve të Programit të Studimit MP në Turizëm.<br>Personeli akademik dhe ndihmës akademik (sekretaria mësimore) ka akses në llogaritë e tyre, ku shfaqen të dhëna mbi lëndët mësimore, sezonet e provimeve, oraret e tyre, lista e studentëve të regjistruar, procesverbale provimi etj. Ndërsa studentët mund të aksesojnë informacione dhe të dhëna rreth statusit të tyre, lëndëve që frekuentojnë, vlerësimet në çdo lëndë etj. Gjithashtu informacionet dhe dokumentacionet në lidhje me programin e studimit si Rregullore e programit të studimit, Misioni i programit të studimit, Plani mësimor, Struktura mësimore, Oraret mësimore etj. janë të publikuara edhe në faqen zyrtare web të UGJ -së. **[https://uogj.edu.al/]** |

| | |
|---|---|
| **Kriteri 4.** Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve. | Format e komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit aklademik dhe studentëve përfshijnë përveç faqes web dhe postës elektronike zyrtare edhe platformat elektronike si: Microsoft Office 365, Microsoft Teams etj. Këto platforma janë përdorur si për zhvillimin e leksioneve virtuale përgjatë pandemisë, po ashtu edhe për komunikimin në distancë ndërmjet stafit akademik dhe studentëve, për të diskutuar mbi mbarëvajtjen e punimit final të temës së diplomës, apo për paqartësi të ndryshme që mund të kishin studentët. **[https://uogj.edu.al/platforma-office-365-dhe-teams-per-mesimin-online/; Evidenca III.1.4 Manual i përdorimit të platformës TEAMS për stafin akademik; Evidenca III.1.5 Manual i përdorimit të platformës TEAMS për studentët]** |
| **Kriteri 5.** Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese. | Platformat elektronike (ESSE3, Pitagora, Microsoft Office 365, Microsoft Teams, LearningKey) garantojnë monitorim në kohë reale dhe vazhdimisht të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese. Sipas nevojave, këto sisteme mundësojnë raportime individuale mbi ecurinë akademike të studentëve, pagesën e tarifës së studimit, monitorimin dhe afatet e hedhjes së vlerësimeve nga ana e personelit akademik etj.<br><br>Përsa i përket aspektit administrativ, institucioni ka instaluar kamera dhe sisteme sigurie për të garantuar dhe raportuar në kohë mbi sigurinë dhe kujdesin e shërbimeve të ofruara. |
| **Kriteri 6.** Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe. | Në faqen zyrtare web të UGJ-së, bazuar në Statutin e UGJ **[Evidenca I.1 Statuti i Universitetit "Eqrem Çabej", Gjirokastër, Neni 60]**, NJBPET publikon:<br>• Informacione që lidhen me programin e studimit si: Rregullorja e programit të studimit, Misioni i programit të studimit, Plani mësimor i tij, Struktura mësimore, Orari mësimor, kalendari i provimeve etj,<br>• Informacione mbi NJBPET-në dhe personelin akademik të tij.<br>• Informacione mbi aktivitete të ndryshme etj<br>të cilat janë në gjuhën shqipe dhe angleze. **[http://uogj.edu.al/]** |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| **Standardi IV.5**<br>**Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi. | UGJ harton një raport financiar të kostove dhe mbështetjes financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit. Hartimi i këtij raporti financiar bazohet në Statutin e UGJ dhe bëhet sipas modelit të buxhetit të shtetit, i përcaktuar në udhëzimin përkatës të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë. **[Evidenca I.1 Statuti i Universitetit "Eqrem Çabej", Gjirokastër, Neni 103]** Projekt buxheti vjetor hartohet nga Administratori i UGJ-së, mbi bazën e propozimeve të Njësive Kryesore dhe Njësive Bazë, mbështetur në Planin Strategjik të zhvillimit të UGJ-së, Planin buxhetor afatmesëm, dhe miratohet nga Bordi i Administrimit me propozim të Senatit Akademik.<br>**[Evidenca IV.11 Propozim buxheti NJBPET; Evidenca IV.11.5 Propozim** |

| | |
|---|---|
| | **buxheti njësia kryesore; Evidenca I.3 Strategjia e zhvillimit të FE-së Kreu *Financat dhe Burimet Financiare*; Evidenca IV.11.4 Projekt Buxheti për vitin 2023 dhe programi i buxhetit afatmesëm 2023-2025]**<br>Pas miratimit buxheti i detajuar kalon për menaxhim në Drejtorinë e Shërbimeve Universitare dhe delegohet në varësi të kërkesave apo nevojave të njësive. |
| **Kriteri 2.** Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë. | Plani i financimit institucional përmban financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për Bibliotekën, për pasurimin e literaturës së saj si dhe aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.<br>**[Evidenca IV.11.1 Raporti vjetor financiar për vitin 2020; Evidenca IV.11.2 Raporti vjetor financiar për vitin 2021; Evidenca IV.11.3 Raporti vjetor financiar për vitin 2022; ANEKS-Tabelat Përmbledhëse-Të ardhurat dhe financimet e ndryshme në 3 vitet e fundit (Tabela 18)]** |
| **Kriteri 3.** Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. | Institucioni vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij në mënyre periodike. Drejtoria e Shërbimeve Universitare harton dhe paraqet Raportin Financiar Vjetor, sipas kërkesave ligjore në fuqi ku paraqiten të gjitha të ardhurat dhe shpenzimet.<br>**[Evidenca IV.11.1 Raporti vjetor financiar për vitin 2020; Evidenca IV.11.2 Evidenca IV.11.2 Raporti vjetor financiar për vitin 2021; Evidenca IV.11.3 Raporti vjetor financiar për vitin 2022]**<br>Gjithashtu në mënyre periodike UGJ, si çdo institucion publik, i nënshtrohet auditit financiar prej Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe MAS.<br>**[Evidenca IV.12 Raporti përfundimtar i Auditit për performancën e Universiteteve; Evidenca IV.12.1 Raport i MASR AUDIT 2018; Evidenca IV.12.2 Raport i MAS AUDIT 2022]** |
| **Kriteri 4.** Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës. | Drejtoria e Shërbimeve Universitare dhe Administratori i UGJ-së raportojnë për realizimin e buxhetit të miratuar në vitin paraardhës në Senatin akademik të UGJ-së dhe Bordin e Administrimit.<br>**[Evidenca IV.11.1 Raporti vjetor financiar për vitin 2020; Evidenca IV.11.2 Raporti vjetor financiar për vitin 2021; Evidenca IV.11.3 Raporti vjetor financiar për vitin 2022]** |
| **Kriteri 5.** Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programeve të studimeve. | Burimet e financimit të Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastër, si institucion publik janë dy:<br>• Financim nga buxheti i shtetit.<br>• Financim nga të ardhurat dytësore të cilat sigurohen nëpërmjet studentëve si: tarifat e regjistrimit, tarifat e shkollimit, dhe të ardhurat nga shërbime të tjera që ofron institucioni.<br>Më qëllim mirëmenaxhimin e këtyre fondeve dhe sigurimin e një qëndrueshmërie financiare, gjatë analizës financiare vjetore shqyrtohet edhe realizimi i treguesve mbi zbatimin e politikës financiare të vet institucionit.<br>**[Evidenca IV.11.1 Raporti vjetor financiar për vitin 2020; Evidenca IV.11.2 Raporti vjetor financiar për vitin 2021; Evidenca IV.11.3 Raporti vjetor financiar për vitin 2022; ANEKS-Tabelat Përmbledhëse, Të** |

| | ardhurat dhe financimet e ndryshme në 3 vitet e fundit (Tabela 18)] | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | X |

| **Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

## V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

| **Standardi V.1**<br>**Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore. | UGJ harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.<br><br>Pranimet e studentëve në UGJ në të gjitha programet e studimeve bëhen me vendim të Senatit Akademik, në përputhje me standartet shtetërore, të kapaciteteve akademike dhe infrastrukturore, kuotave dhe kritereve të propozuara nga Njësia bazë si dhe legjislacionin në fuqi.<br><br>**[Evidenca I.1 Statuti i Universitetit "Eqrem Çabej",Gjirokastër, Neni 62; Evidenca I.6 Rregullore e Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastër, Neni 42, 50 dhe 51; Evidenca II.6 Rregullore e Fakultetit Ekonomik, Neni 18; Evidenca II.13 Rregullore e Njësisë Bazë të Politikave Ekonomike dhe Turizmit, Neni 12; Evidenca II.19 Baza ligjore për aplikimet dhe regjistrimet ne IAL; Evidenca II.19.1 Baza ligjore QSHA dhe RASH për pranimet e reja; Evidenca II.17 Vendim SA për kuotat 2021-2022 dhe kriteret e pranimit 2022-2023; II.17.4 Vendim SA për kuotat 2022-2023 dhe kriteret e pranimit 2023-2024 dhe II.18 Vendim SA për kuotat 2023-2024 dhe kriteret e pranimit 2024-2025]**<br><br>Kohëzgjatja normale e studimeve në programin e studimit Master Profesional në "Turizëm" është 2(dy) vite akademike. Programi i studimit është i organizuar në lëndë mësimore dhe i vlerësuar me 120 kredite sipas Sistemit Europian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).<br><br>Studentët në programin e studimit Master Profesional në "Turizëm" diplomohen me provim të përgjithshëm përfundimtar ose punim diplome.<br><br>Me përfundimin e këtij programi studimi, lëshohet Diplomë Universitare Master Profesional në "Turizëm".<br><br>**[Evidenca II.2 Plan mësimor Master Profesional në Turizëm 2021-2022; Evidenca I.5 Rregullore e Programit të Studimit Master Profesional në Turizëm; Evidenca II.4 Model diplome Master Profesional në Turizëm]** |



Geshkepyley

| | |
|---|---|
| **Kriteri 2.** Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit. | Statuti i UGJ-së **[Evidenca I.1 Statuti i Universitetit "Eqrem Çabej",Gjirokastër, Neni 66, pika 6 dhe KREU X]**, përshkruan qartë kriteret e pranimit të studentëve në ciklin e dytë të studimeve si dhe të drejtat dhe detyrimet e studentëve gjatë studimeve universitare, të cilat udhëhiqen nga parimi i barazisë.<br>Rregullorja e UGJ-së , Rregullorja e FE-së dhe Rregullorja e NJPET-së **[Evidenca I.6 Rregullore e Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastër; Evidenca II.6 Rregullore e Fakultetit Ekonomik; Evidenca II.13 Rregullore e Njësisë Bazë të Politikave Ekonomike dhe Turizmit; Evidenca II.1 Rregullore e studimeve në Universitetin "Eqrem Çabej" Gjirokastër]** përmbajnë në mënyrë të detajuar procedurat dhe praktikat e trajtimit të studentëve që nga regjistrimi i tyre, e deri në përfundim të studimeve, apo procedurat dhe praktikat e transferimit të tyre, gjë që garanton qartësisht politika dhe procedura transparente për trajtim të barabartë dhe të drejtë për të gjithë kandidatët dhe studentët e programit Master Profesional në "Turizëm<br>Në faqen zyrtare web të UGJ-së publikohen informacione mbi kriteret dhe kuotat e pranimeve për çdo vit akademik, si dhe Rregulloret institucionale për ecurinë akademike të studentëve.<br>**[https://uogj.edu.al/kriteret-dhe-kuotat-e-pranimit/; https://uogj.edu.al/statuti-i-universitetit/; https://uogj.edu.al/rregullore-e-universitetit/]** |
| **Kriteri 3.** Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse. Kriteret parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj. | UGJ harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve propozohen nga Njësitë Bazë në përgjigje të kërkesës së MAS dy vite përpara, ndërsa kuotat e pranimeve një vit përpara fillimit të vitit akademik.<br>Propozimet nga Njësitë bazë, përcillen në Rektorat dhe miratohen nga Senati Akademik. **[Evidenca II.17 Vendim SA për kuotat 2021-2022 dhe kriteret e pranimit 2022-2023; Evidenca II.17.4 Vendim SA për kuotat 2022-2023 dhe kriteret e pranimit 2023-2024 dhe Evidenca II.18 Vendim SA për kuotat 2023-2024 dhe kriteret e pranimit 2024-2025, https://uogj.edu.al/kriteret-dhe-kuotat-e-pranimit/]**<br>Këto kritere janë në përputhje me VKM-të në fuqi. **[Evidenca II.19 Baza ligjore për aplikimet dhe regjistrimet në IAL]**<br>Kuotat e pranimit të studentëve për Master Profesional në Turizëm, parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj nga Republika e Kosovës si dhe nga trojet shqipfolëse të shteteve të tjerë. |
| **Kriteri 4.** Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku. | Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.<br>Në Rregulloren e UGJ-së, Rregulloren e studimeve në UGJ, Rregulloren e FE-së, Rregulloren e NJBPET-së përshkruhen kriteret e pranimit dhe përzgjedhjes, ecuria akademike, procesi i transferimit dhe kriteret dhe procedurat e diplomimit. **[Evidenca I.6 Rregullore e Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastër Kreu V, VI, VII dhe VIII; Evidenca II.1 Rregullore e studimeve në Universitetin "Eqrem Çabej" Gjirokastër Kreu V, VI, VII dhe VIII; Evidenca II.6 Rregullore e Fakultetit Ekonomik, Kreu IV, Kreu V, Kreu VI, Kreu VII; Evidenca II.13 Rregullore e Njësisë Bazë të Politikave Ekonomike dhe Turizmit, Kreu IV, Kreu V, Kreu VI, Kreu VII]**<br>Informacioni mundësohet nëpërmjet faqes zyrtare web të Universitetit **[www.uogj.edu.al]**, sekretarisë mësimore të FE-së, sistemit të sekretarisë mësimore **[https://uogj.pitagora.rash.al/login]** si dhe shpalljeve në stendat e njoftimeve. |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Kriteri 5.** Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit. | Përpara fillimit të çdo viti akademik, UGJ informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat dhe kriteret e përgjithshme e të veçanta të programeve të studimit. UGJ nëpërmjet zyrës së Alumni, Këshillimit të Karrierës dhe Vlerësimit të Vazhduar, në bashkëpunim me Fakultetet e tij, përfshirë Fakultetin Ekonomike dhe NjBPET, realizojnë komunikimin me publikun e interesuar për ndjekjen e programeve të studimit, nëpërmjet:<br>- Publikimit në faqen web të UGJ të informacioneve rreth programeve të studimit, përmbajtjes së tyre, diplomave që ofron dhe mundësive të punësimit, kritereve të përgjithshme e të veçanta për ndjekjen e tyre etj.<br>- Informimit nëpërmjet rrjeteve sociale.<br>- Informimit nëpërmjet mediave lokale.<br>- Informimit nëpërmjet fletëpalosjeve dhe posterave<br>**[Evidenca II.17.4 Vendimi i Senatit Akademik për kuotat për vitin akademik 2022-2023 kriteret e pranimit për vitin akademik 2023-2024; Evidenca II.18 Vendimi i Senatit Akademik për kuotat për vitin akademik 2023-2024 kriteret e pranimit për vitin akademik 2024-2025; http://uogj.edu.al]** | | | |
| **Kriteri 6.** Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të margjinalizuara. | UGJ parashikon kuota dhe kritere për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të margjinalizuara si dhe zbaton udhëzimet përkatëse për aplikimin dhe regjistrimin e tyre.<br>**[Evidenca II.17.4 Vendimi i Senatit Akademik për kuotat për vitin akademik 2022-2023 kriteret e pranimit për vitin akademik 2023-2024; Evidenca II.18 Vendimi i Senatit Akademik për kuotat për vitin akademik 2023-2024 kriteret e pranimit për vitin akademik 2024-2025; Evidenca II.19.1. Baza ligjore QSHA dhe RASH për pranimet e reja]** | | | |
| **Kriteri 7.** Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera. | UGJ parashikon kuota dhe kritere për përzgjedhjen për kandidatët nga shtetet e tjera dhe kryesisht nga Republika e Kosovës si dhe nga trojet shqipfolëse të shteteve të tjere si Maqedoni e Veriut, Mali i Zi, Preshevë, Bujanovc dhe Medvegjë (Serbi) dhe të Huaj **[Evidenca II.17.4 Vendimi i Senatit Akademik për kuotat për vitin akademik 2022-2023 kriteret e pranimit për vitin akademik 2023-2024; Evidenca II.18 Vendimi i Senatit Akademik për kuotat për vitin akademik 2023-2024 kriteret e pranimit për vitin akademik 2024-2025; (shtojcat)]** | | | |
| **Kriteri 8.** Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit. | Nëpëmjet vendimarrjeve dhe procedurave përkatëse institucionale, UGJ implementon politikat e saj të ndihmës/bursave për shtresat në nevojë si dhe për rritjen e cilësisë së pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.<br>**[Evidenca II.7 Vendime Bordi i Administrimit për bursat dhe mbështetje për kategoritë e veçanta;]** | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | X |

| **Standardi V.2**<br>**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në | UGJ informon në mënyrë të plotë dhe të hollësishëm studentët që në vitin e parë të studimeve të tyre, në lidhje me procedurat e përparimit akademik dhe kalimin nga një vit në tjetrin. |

| | |
|---|---|
| lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin. | Me fillimin e viti akademik, studentët marrin informacione të rëndësishme, në lidhje me procesin mësimor, planin mesimor, strukturën mësimore, orarin mësimor, pedagogun e lëndës, të publikuara në ambjentet e FE-së si dhe në faqen zyrtare web të UGJ-së. **[https://uogj.edu.al/]**<br>Në fillim të çdo semestri pedagogët ju prezantojnë studentëve programet lëndore(syllabuset), procedurat për përparimin akademik, detyrimet mbi frekuentimin e lëndës, format e kontrollit të dijeve të fituara dhe vlerësimit të studentëve etj.<br>Informacionet në lidhje me kriteret dhe procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimin nga një vit në tjetrin janë të përshkruara hollësisht në Rregulloret institucionale.<br>**[Evidenca I.6 Rregullore e Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastër, Kreu VI, VII; Evidenca II.1 Rregullore e studimeve në Universitetin "Eqrem Çabej" Gjirokastër, Kreu III, IV, V, VI, VII, VIII; Evidenca II.6 Rregullore e Fakultetit Ekonomik, Kreu V, VI, VII; Evidenca II.13 Rregullore e Njësisë Bazë të Politikave Ekonomike dhe Turizmit, Kreu V, VI, VII].** |
| **Kriteri 2.** Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme. | UGJ informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme, njohjes dhe transferimit të krediteve midis programeve të të njëjtit cikël studimi, dhe në fusha studimi të njëjta ose të përafërta, në fillim të vitit akademik, brenda UGJ-së dhe në institucione të tjera të arsimit të lartë sipas përcaktimeve në Statutin e UGJ-së dhe rregulloreve përkatëse.<br>**[Evidenca I.1 Statuti i Universitetit "Eqrem Çabej",Gjirokastër, Neni 72; Evidenca I.6 Rregullore e Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastër, Neni 65; Evidenca II.6 Rregullore e Fakultetit Ekonomik, Nenet 30 dhe 31; Evidenca II.13 Rregullore e Njësisë Bazë të Politikave Ekonomike dhe Turizmit, Nenet 24 dhe 25]**<br>Informacion më i detajuar, sidomos në lidhje me dokumentacionin e nevojshëm, merret pranë sekretarisë mësimore dhe nëpërmjet shpalljes së njoftimeve në stendat e informimit në UGJ. |
| **Kriteri 3.** Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit. | Bazuar ne Rregulloret institucionale **[Evidenca I.6 Rregullore e Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastër, Kreu VI, VII; Evidenca II.1 Rregullore e studimeve në Universitetin "Eqrem Çabej" Gjirokastër, Kreu III, IV, V, VI, VII, VIII; Evidenca II.6 Rregullore e Fakultetit Ekonomik, Kreu V, VI, VII; Evidenca II.13 Rregullore e Njësisë Bazë të Politikave Ekonomike dhe Turizmit, Kreu V, VI, VII]**, NJBPET informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të tyre në programin e studimit, duke përfshirë sistemin e vlerësimit, format e vlerësimit, format e kontrollit te dijeve, kushtet për hyrjen ne provim, sezonet e provimeve, organizimin e provimeve, komisionet e provimeve, zhvillimin e provimeve, shpalljen e rezultateve, ankimimin dhe përmirësimin e notës. Ky informacion u bëhet me dije studentëve në fillim si dhe gjatë vitit akademik. |
| **Kriteri 4.** Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit. | Mbështetur në Kreun VIII Diplomimi, të Rregullores së Studimeve në UGJ, **[Evidenca II.1 Rregullore e studimeve në Universitetin "Eqrem Çabej" Gjirokastër]**, në Rregulloren e UGJ-së **[Evidenca I.6 Rregullore e Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastër, Nenin 93]** në Kreun VII Diplomimi, të Rregullores së FE-së **[Evidenca II.6 Rregullore e Fakultetit Ekonomik, Nenet 39, 40]** në Rregulloren e programit të studimit Master Profesional në "Turizëm" **[Evidenca I.5 Rregullore e Programit të Studimit Master Profesional në Turizëm, Neni 11]**, si dhe planin mësimor të programit të studimit Master Profesional në "Turizëm" **[Evidenca II.2 Plan mësimor Master Profesional në Turizëm 2021-2022]**, studentët në programin e studimin Master Profesional në "Turizëm" diplomohen me provim të përgjithshëm përfundimtar ose punim diplome.<br>Në rregulloren e studimeve në UGJ, Rregulloren e FE-së dhe Rregulloren e programit të studimit Master Profesional në "Turizëm" përcaktohet qartë pragu i notës mesatare që i jep të drejtën studentit për të përgatitur dhe mbrojtur një punim diplome. **[Evidenca II.1 Rregullore e studimeve në Universitetin "Eqrem Çabej" Gjirokastër, Neni 59, pika 5;** |



Gjeshkepije

| | |
|---|---|
| | **Evidenca II.6 Rregullore e Fakultetit Ekonomik, Neni 39, pika 2; Evidenca I.5 Rregullore e Programit të Studimit Master Profesional në Turizëm, Neni 11].**<br>NJBPET asiston studentët, duke vënë në dispozicion të tyre informacione, udhëzime dhe materiale të nevojshme në funksion të punimit të diplomës ose të provimit të përgjithshëm përfundimtar.<br>NJBPET, në fillim të vitit të fundit të studimeve përcakton fushat e studimeve për punimin e diplomës **[Evidenca II.15.1 Lista me fushat e përgjithshme për hartimin e temave për mbrojtjen e diplomës]**. Udhëheqësi i temës së diplomës përgatit programin e punës së studentit duke vendosur afatet e përafërta të realizimit të tij, përcakton grafikun e konsultimeve të programuara me studentin përgjatë të cilave konsultohet dhe kontrollohet puna e bërë sipas programit të miratuar. Para mbrojtjes së tezës së diplomës udhëheqësi rishikon dhe miraton punimin e kryer nga studenti dhe lejon mbrojtjen e punimit duke firmosur tezën e diplomës.<br>Punimi i diplomës bëhet duke mbajtur në konsideratë udhëzimet në Manualin e punimit të diplomës, sipas shtojcës bashkëngjitur Rregullores së studimeve në UGJ **[Evidenca II.1 Rregullore e studimeve në Universitetin "Eqrem Çabej" Gjirokastër, Neni 61; Evidenca Evidenca II.1 Rregullore e studimeve në Universitetin "Eqrem Çabej" Gjirokastër, Shtojcat e Rregullores së Studimeve]**.<br>Studentët të cilët diplomohen me provim të përgjithshëm përfundimtar asistohen nga NJBPET, duke ju vënë në dispozicion të tyre Programin e provimit të përgjithshëm. përfundimtar **[Evidenca II.15 Programi me pyetje për provimin e përgjithshëm përfundimtar]** |
| **Kriteri 5.** Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit. | Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, UGJ organizon takime të hapura dhe publikon udhëzues të posaçëm për informimin e studentëve që kanë mbaruar Ciklin e Parë të studimeve ose që kanë mbaruar dhe një Cikël të Dytë.<br>UGJ informon gjithashtu edhe nëpërmjet spoteve televizive dhe fletëpalosjeve promovuese në lidhje me programet e studimit që ofron. |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| **Standardi V.3**<br>**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit. | Rregullorja e studimeve në UGJ, Rregullorja e UGJ-së si dhe Rregullorja e Programit të Studimit Master Profesional në "Turizëm" përcaktojnë qartë strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.<br>**[Evidenca II.1 Rregullore e studimeve në Universitetin "Eqrem Çabej" Gjirokastër; Evidenca I.6 Rregullore e Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastër, Kreu VI, VII, Evidenca I.5 Rregullore e Programit të Studimit Master Profesional në Turizëm, Kreu II, III]**.<br>Në fillim të çdo viti akademik, NJBPET organizon takim informues me studentët e vitit të parë të studimeve, ku informohen rreth procesit mësimor, strukturës |



Gjeshkëpijej

| | |
|---|---|
| | mësimore të vitit akademik, kohëzgjatjes së vitit akademik, ndarjes së tij në semestra, sezoneve të provimeve, planit mësimor dhe lëndëve mësimore përkatëse, objektivave formues të programit të studimit, Rregullores së Programit të studimit si dhe Rregulloreve të tjera institucionale, vendndodhjes së auditorëve, laboratorëvë mësimore, zyrave dhe sekretarive, orarit mësimor, orarit të shfrytëzimit të Bibliotekës, përdorimit të faqes zyrtare ueb të UGJ-së etj.<br>Informacionet e mësipërme mund të aksesohen elektronikisht edhe nëpërmjet faqes zyrtare web të UGJ-së. |
| **Kriteri 2.** Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese. | UGJ vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit Master Profesional në "Turizëm" informacion dhe dokumentacion udhëzues si Rregulloren e programit të studimit, plani mësimor me lëndët përkatëse, programet lëndore, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese të tyre etj.<br>**[Evidenca I.5 Rregullore e Programit të Studimit Master Profesional në Turizëm; Evidenca II.2 Plan mësimor Master Profesional në Turizëm 2021-2022; Evidenca II.5 Programet lëndore (syllabuset) të programit të studimit Master Profesional në Turizëm]**<br>Informacion i detajuar për studentët gjendet edhe në faqen zyrtare web të UGJ-së **[www.uogj.edu.al].** |
| **Kriteri 3.** Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës. | UGJ-ja informon, mbështet institucionalisht dhe orienton studentët drejt tregut të punës. Në këtë kuadër, UGJ merr pjesë në Panairin e Punës, ku shumë studentë prezantohen me informacione për punësim dhe punëdhënës të ardhshëm potencialë.<br>Zyra e Alumni, Këshillimit të Karrierës dhe Vlerësimit të Vazhduar u shërben studentëve të UGJ-së si urë lidhëse me tregun e punës, duke krijuar kontaktet e duhura me punëdhënësit potencialë, me qëllim promovimin e studentëve dhe kërkimin e mundësive të reja të punësimit.<br>**[Evidenca II.21 Të dhëna statistikore nga Zyra e Alumni; Evidenca ANEKS-Tabelat Përmbledhëse, Të dhëna për diplomimin dhe punësimin e studentëve (Tabela 23)]**<br>Gjithashtu, UGJ-ja, ka realizuar një sërë marrëveshjesh me institucione të ndryshme, të cilat krahas ndihmës për procesin mësimor kanë shërbyer edhe si mundësi reale për punësimin e studentëve që përfundojnë studimet në UGJ. **[Evidenca I.18 Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit të UGJ]** |
| **Kriteri 4.** Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij. | Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të këtij procesi nëpërmjet:<br>• Stendës së Informimit (struktura mësimore, plani mësimor, orari mësimit, kalendari i provimeve, njoftime etj<br>• Pranë Njësisë bazë (Përgjegjësi i Njësisë bazë, titullarët e lëndëve)<br>• Sekretarisë mësimore<br>• Faqes zyrtare web<br>• Njoftimi përmes postës zyrtare elektronike<br>• Njoftime në rrjetet sociale |
| **Kriteri 5.** Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë. | Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet dhe është lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë, nëpërmjet faqes zyrtare web të UGJ, postës zyrtare elektronike si dhe sistemit të sekretarisë mësimore **[www.uogj.edu.al; https://uogj.pitagora.rash.al/login].** |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| **Standardi V.4**<br>**Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit. | UGJ disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit Master Profesional në "Turizëm".<br>Specislisti i Statistikës në bashkëpunim me Sekretarinë mësimore mbledh, përpunon, ruan dhe paraqet informacione statistikore nëse kërkohen. bazuar në:<br>• regjistrin themeltar të studentëve;<br>• regjistrin e arritjeve akademike;<br>• regjistrin e lëshimit të diplomave dhe çertifikatave<br>**[Evidenca I.1 Statuti i Universitetit "Eqrem Çabej", Gjirokastër, Neni 92; [Evidenca V.5 Rregullore e sekretarisë mësimore, Neni 4; Evidenca ANEKS-Tabelat Përmbledhëse-Cilësia në hyrje dhe në dalje e studentëve (Tabela 21); Tabelat Raport statistikor student-pedagog për çdo fakultet; Evidenca II.21 Të dhëna statistikore nga Zyra e Alumnit dhe Këshillimit të Karrierës].** |
| **Kriteri 2.** Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve. | UGJ disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar, klasifikimin e studentëve të rinj në programet e studimeve sipas gjinisë, grupmoshave dhe vendbanimeve, të diplomuar, të tërhequr apo të larguar para përfundimit të programit etj.<br>**[Evidenca I.14 Raporti vjetor UGJ viti akademik 2019-2020; Evidenca I.14.2 Raporti vjetor UGJ viti akademik 2020-2021; Evidenca I.14.4 Raporti vjetor UGJ viti akademik 2021-2022; Evidenca ANEKS-Tabelat Përmbledhëse-Cilësia në hyrje dhe në dalje e studentëve (Tabela 21)]** |
| **Kriteri 3.** Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar. | Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen manualisht dhe elektronikisht nëpërmjet Sekretarisë Mësimore (sistemin ESSE3, tashmë në sistemin Pitagora). Të gjitha proceset e ruajtjes dhe përpunimit të të dhënave personale nga UGJ bazohen në parimin e konfidencialitetit dhe në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi. Këto të dhëna statistikore janë lehtësisht të aksesueshme nga personat e autorizuar.<br>**[Evidenca I.1 Statuti i Universitetit "Eqrem Çabej", Gjirokastër, Neni 92, pika 3; Evidenca V.1 Rregullore për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale]** |
| **Kriteri 4.** Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik të përvitshëm pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse. | UGJ mbështet me akte, kontrollin periodik të dokumentacionit pranë Njësive bazë, Njësive kryesore dhe Sekretarive mësimore, vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse<br>REPUBLIKA E SHQIPERISE · UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" · GJIROKASTËR |
| **Kriteri 5.** Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e | UGJ bazuar në Raportet Vjetore të Njësive bazë, Raportet Vjetore të Fakulteteve, në raportime të Sekretarive mësimore, Drejtorisë së Shërbimeve Akademike-ndihmës akademike (Zyrës së Alumni Këshillimit të Karrierës dhe Vlerësimit të Vazhduar), harton Raportin Vjetor Institucional ku përfshihen veprimtaria mësimore dhe |

| | |
|---|---|
| cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve. | shkencore, ecuria e programeve të studimit, informacione për cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve. **[Evidenca I.14 Raporti vjetor UGJ viti akademik 2019-2020; Evidenca I.14.2 Raporti vjetor UGJ viti akademik 2020-2021; Evidenca I.14.4 Raporti vjetor UGJ viti akademik 2021-2022; Evidenca II.21 Të dhëna statistikore nga Zyra e Alumnit dhe Këshillimit të Karrierës,; Evidenca ANEKS-Tabelat Përmbledhëse-Cilësia në hyrje dhe në dalje e studentëve (Tabela 21); Evidenca ANEKS-Tabelat Përmbledhëse-Të dhëna për diplomimin dhe punësimin e studentëve (Tabela 23)]** |

| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| **Standardi V.5**<br>**Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit. | UGJ bazuar në Statutin e tij **[Evidenca I.1 Statuti i Universitetit "Eqrem Çabej", Gjirokastër, Neni 88, Neni 91]** nxit, përfshin dhe angazhon studentët dhe/ose përfaqësues të tyre në organet kolegjiale të tij.<br>Studentët janë të përfaqësuar në Senatin Akademik të UGJ-së **[Evidenca I.1 Statuti i Universitetit "Eqrem Çabej",Gjirokastër, Neni 18; Evidenca II.27.1 Lista e anëtarëve të Senatit Akademik]**, në Këshillin e Etikës **[Evidenca I.1 Statuti i Universitetit "Eqrem Çabej", Gjirokastër, Neni 24, pika 3]**, janë të organizuar në Këshillin Studentor dhe kanë statutin e organizimit dhe funksionimit të tyre **[Evidenca II.28 Statuti i Këshillit Studentor]**, janë të përfaqësuar në Njësinë e Sigurimit të brendshëm të Cilësisë **[Evidenca VI.4.1 Anëtarët e NjBSC; ANEKS-TABELAT PËRMBLEDHËSE Të dhëna për anëtarët e NJBSC (Tabela 24)]** dhe kanë Shoqatën Sportive Studentore të tyre. **[Evidenca V.2 Statuti i shoqatës sportive UGJ]** |
| **Kriteri 2.** Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme. | UGJ garanton përfshirjen e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik. **[Evidenca I.1 Statuti i Universitetit "Eqrem Çabej", Neni 88, pika 1 gërma b, Neni 91, pika 5]** Ata përfaqësohen ose janë pjesë në organe në nivel institucional dhe gjithashtu në organe në nivel njësie kryesore.<br>Në Senatin akademik të UGJ-së studentët përfaqësohen në masën 10%. **[Evidenca I.1 Statuti i Universitetit "Eqrem Çabej",Gjirokastër, Neni 18, pikat 2, 3; Evidenca II.27.1 Lista e anëtarëve të Senatit Akademik]**<br>Përfaqësuesit e studentëve në Senatin Akademik të UGJ-së shprehin mendime dhe propozime për të gjitha problemet me interes të përgjithshëm, si për planet mësimore dhe programet e studimeve, rregulloret e studimeve etj.<br>Studentët marrin pjesë në procese të rëndësishme të jetës institucionale dhe akademike, duke qënë anëtar të komisioneve zgjedhore institucionale. **[Evidenca V.3 Rregullore e zgjedhjeve të 2020]**<br>Studentët organizohen lirisht në Këshillat Studentore, institucionale dhe në njësi kryesore **[Evidenca II.28 Statuti i Keshillit Studentor]**<br>Studentët janë anëtar të Grupeve të Vlerësimit të Brendshëm për Akreditimin Institucional si dhe Akreditimin e programeve të studimit . **[Evidenca V.4 Urdhër** |

| | |
|---|---|
| | **për ngritjen e GVB institucional; Evidenca V.4.1 Urdhër për ngritjen e GVB të programit të studimit Bachelor në Turizëm]**<br>Studentët janë të përfaqësuar në Këshillin e Etikës **[Evidenca I.1 Statuti i Universitetit "Eqrem Çabej",Gjirokastër, Neni 24, pika 3; Evidenca III.9 Kodi i Etikës dhe vendimi për miratimin e Kodit të Etikës]** si dhe pjesë aktive e sondazheve vjetore të studentëve organizuar nga ASCAL dhe e sondazheve të organizuar nga UGJ. **[ANEKS-TABELAT PËRMBLEDHËSE-Të dhëna për anëtarët e NJBSC (Tabela 24)]** |
| **Kriteri 3.** Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sUGJerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj. | UGJ në Statutin e tij, **[Evidenca I.1 Statuti i Universitetit "Eqrem Çabej", Gjirokastër Çabej, Neni 88, gërma h, Neni 91, pika 5]** garanton që studentët të shprehin mendime dhe propozime për planet dhe programet e studimeve, rregulloret për veprimtaritë mësimore, të drejtën për të studjuar, cilësinë e shërbimeve, përcaktimin e tarifave të studimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët, ndarjen e burimeve financiare, zhvillimin e veprimtarive të ndryshme kulturore, artistike, sportive etj.<br>Përmes sondazheve të organizuara nga UGJ, konkretizohet e drejta e studentëve për t'u shprehur mbi cilësinë e mësimdhënies për çdo program studimi që ndjekin, si edhe për performanceën e personelit akademik. Rezultatet dhe sugjerimet e marra nga procesi i anketimit të studentëve, pasqyrohen në Raportin e Analizës dhe Vlerësimit të Pyetësorëve të përgatitur nga Njësia e Brendshme e Sigurimit të Cilësisë. Raporti diskutohet më pas në NjBPET, nga ku jepen sugjerimet konkrete për përmirësimin e rezultateve të matura.**[Evidenca III.5. Pyetësor Studentor; Evidenca III.6 Raport mbi rezultatet e pyetesorit studentor]** |
| **Kriteri 4.** Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës. | Procesi i vlerësimit dhe kontrollit të dijeve përfshirë këtu edhe procesin e ankimimit të rezultatit nga studenti është i sanksionuar në të gjitha Rregulloret institucionale. **[Evidenca I.6 Rregullore e Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastër, Kreu VII; Evidenca II.6 Rregullore e Fakultetit Ekonomik, Kreu VI, VII; Evidenca II.13 Rregullore e Njësisë Bazë të Politikave Ekonomike dhe Turizmit, Kreu VI, VII; Evidenca II.1 Rregullore e studimeve në Universitetin "Eqrem Çabej" Gjirokastër, Kreu V]**<br>Çdo kërkesë, ankimim prej studentëve në lidhje me saktësinë dhe korrektësinë e vlerësimit të dijeve nëpërmjet të gjitha formave të kontrollit, parashikohet hollësisht në Rregulloren e studimeve në UGJ. **[Evidenca II.1 Rregullore e studimeve në Universitetin "Eqrem Çabej" Gjirokastër, Neni 46]**<br>Ankesa bëhet me shkrim brenda afatit të ankimimit dhe i drejtohet Dekanit të Fakultetit. Ai përcakton nëse kërkesa e studentit është e drejtë apo jo dhe merr vendimin përkatës. Në rast se vërtetohen praktika që bien ndesh me rregulloren atëherë me propozim të Përgjegjësit të Njësisë Bazë, Dekani vendos për ndryshimin e komisionit të provimit dhe ridhënien e provimit.<br>**[Evidenca II.1 Rregullore e studimeve në Universitetin "Eqrem Çabej" Gjirokastër, Neni 46, pika 2]** |

| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

REPUBLIKA E SHQIPËRISË UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR

| **Standardi V.6**<br>**Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit. | Drejtoria e Shërbimeve Ndihmës-akademike Administrative dhe Sektori i Shërbimeve Biblotekare Arkivore dhe Studentore, nëpërmjet zyrës së Alumni Këshillimit të Karrierës dhe Vlerësimit të Vazhduar, informojnë dhe mbështesin studentët për të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me procesin mësimor në UGJ, shpërndarjen e informacionit për orientimin e aplikantëve dhe studentët e rinj, dhënien e informacioneve për programet, kurrikulat e studimeve, diplomat, këshillimin e studentëve të UGJ-së që diplomohen në nivelin e parë të studimeve për mundësitë e studimeve në nivelin e dytë në UGJ ose Universitete të tjera, këshillimin e studentëve për mundësitë e punësimit në tregun e brendshëm të punës në sektorin publik dhe privat, bashkëpunon ngushtë me njësitë bazë dhe kryesore për organizimin dhe vijueshmërinë e praktikave profesionale të studentëve të UGJ-së, ofron për studentët trajnime, info day, takime të hapura etj. **[Evidenca I.1 Statuti i Universitetit "Eqrem Çabej",Gjirokastër, Neni 42; Evidenca V.6 Rregullore për organizimin dhe funksionimin e DSHNA, Neni 14]**<br>Informimi i studentëve realizohet edhe nëpërmjet Sekretarive mësimore, Zyrës së IT-së, Dejtorisë së Shërbimeve Universitare, Sektorit të Kërkimit Shkencor dhe Marrëdhënieve me Jashtë, ku studenti merr asistencën e nevojshme në lidhje me regjistrimin, ecurinë akademike diplomimin, detyrimet dhe shërbimet financiare, pjesmarrje në mobilitete etj. **[Evidenca I.1 Statuti i Universitetit Eqrem Çabej, Nenet 42, 43, 44.]**<br>Një rol të rëndësishëm në informimin dhe mbështetjen e studentëve për çdo problematikë në procesin mësimor ka edhe NjBPET.<br>Informimi i studentëve bëhet edhe nëpërmjet faqes zyrtare web të Universitetit dhe njoftimeve në rrjetet sociale (si Facebook etj.). |
| **Kriteri 2.** Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit. | Informimi, këshillimi, ndjekja dhe përparimi i studentëve dhe mbështetja e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit realizohet nëpërmjet:<br>– Njësisë bazë (Përgjegjësi, Përgjegjësat e grupeve mësimore/kërkimore, titullarët e lëndëve, stendës së Informimit)<br>– Sekretarisë Mësimore të Fakultetit Ekonomik<br>– Sektorit të Standarteve dhe Kurrikulave<br>– Zyrës së Alumni Këshillimit të Karrierës dhe Vlerësimit të Vazhduar,<br>– Faqes zyrtare web<br>– Sistemit të Sekretarisë mësimore (Pitagora)<br>– Njoftimi përmes adresave zyrtare elektronikë<br>– Njoftime në rrjetet sociale (Facebook) etj |
| **Kriteri 3.** Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione | Zyra e Alumni, Këshillimit të Karrierës dhe Vlerësimit të Vazhduar, mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me procesin mësimor në UGJ, informacion për programet dhe kurrikulat e studimeve, diplomat, informon dhe këshillon studentët e UGJ-së që diplomohen në nivelin e parë për mundësitë e studimeve në nivelin e dytë në UGJ ose Universitete të tjera, informon dhe këshillon studentët për mundësitë e punësimit në tregun e brendshëm të punës në sektorin publik dhe privat, bashkëpunon ngushtë me njësitë bazë dhe kryesore për organizimin dhe vijueshmërinë e praktikave profesionale të studentëve të UGJ-së, ofron për studentët trajnime, info day, takime të hapura etj |



Gjeshkepyjej

| | |
|---|---|
| të tjera dhe orientimin në tregun e punës. | **Evidenca I.1 Statuti i Universitetit "Eqrem Çabej",Gjirokastër, Neni 42; Evidenca V.6 Rregullore për organizimin dhe funksionimin e DSHNA, Neni 14]** |
| **Kriteri 4.** Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse. | Zyrës e Alumni Këshillimit të Karrierës dhe Vlerësimit të Vazhduar ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe i vë në dispozicion të studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse. [**Evidenca II.21 Të dhëna statistikore nga Zyra e Alumnit dhe Këshillimit të Karrierës]** |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| **Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

## VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT

| **Standardi VI.1**<br>**Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve. | UGJ ka si objektiv zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies/mësimnxënies si dhe promovimin e kulturës së rritjes së vazhdueshme prandaj UGJ i kushton rëndësi shumë të madhe këtyre metodave dhe përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies.<br>UGJ harton udhëzues, manuale dhe kryen trajnime në nivel institucional, për zhvillimin dhe përdorimin e tyre në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.<br>UGJ ka hartuar edhe udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies [**Evidenca III.1.1 Implementimi i platformës së mësimit online Classroom; Evidenca III.1.2 Implementimi i platformës së mësimit online Edumeet; Evidenca III.1.3 Implementimi i platformës së mësimit online Office365; Evidenca III.1.4 Manual i përdorimit të platformës TEAMS për stafin akademik; Evidenca III.1.5 Manual i përdorimit të platformës TEAMS për studentët; Evidenca III.4 Udhëzues institucional mbi metodat innovative në mësimdhënie]**. Bazuar në Rregulloren e Programit të Sudimit, [**Evidenca I.5 Rregullore e Programit të Studimit Master Profesional në Turizëm, Neni 17**] dhe duke pasur parasysh natyrën e programit të studimit dhe specifikën e çdo lënde të tij, mësimdhënia përfshin përveç metodave didaktike tradicionale edhe metoda didaktike innovative, nëpërmjet përdorimit të teknologjive të informacionit dhe komunikimit në mësimdhënie. |
| **Kriteri 2.** Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të | Në UGJ, strukturat përgjegjëse përdorin forma nga më të ndryshmet për monitorimin dhe vlerësimin në mënyrë periodike të aftësive mësimdhënëse të |

| | |
|---|---|
| monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmës akademik. | personelit akademik dhe ndihmës akademik, sepse UGJ është përgjegjës për sigurimin e brendshëm të cilësisë në të gjitha njësitë përbërëse organizative. Për këtë funksionon Sektori i Standarteve të Cilësisë dhe Kurrikulave (SSCK) me përgjegjësinë e ngritjes, zbatimit dhe përmirësimit të vazhdueshëm të sistemit të cilësisë në UGJ, mbështetur në Kodin e Cilësisë në Arsimin e Lartë si dhe standartet dhe udhëzimet evropiane për sigurimin e cilësisë në hapësirën Evropiane të Arsimit të lartë **[Evidenca I.1 Statuti i Universitetit Eqrem Çabej, neni 93]**<br>SSCK-ja bazuar në Statutin e UGJ **[Evidenca I.1 Statuti i Universitetit Eqrem Çabej, neni 94, pika 5]** kryen procesin e vazhdueshëm të monitorimit, vlerësimit dhe promovimit të cilësisë së veprimtarive mësimore dhe atyre kërkimore shkencore, organizon pyetësorin studentor për cilësinë e mësimdhënies në lëndët e çdo programi studimi, realizon studime gjurmuese për të vlerësuar ecurinë e punësimit të studentëve dhe efikasitetin e programeve të studimit të ofruara, organizon vlerësimin periodik të brendshëm të cilësisë së programeve të studimit si dhe të vlerësimit të brendshëm institucional. **[Evidenca III.5 Pyetësor studentor; Evidenca III.6 Raport mbi rezultatet e pyetësorit studentor; Evidencat nga I.14 deri I.14.14 Raportet vjetore të UGJ, FE dhe NJBPET për vitet akademike 2019-2020, 2020-2021, 2021-2022]**<br>Gjithashtu në UGJ funksionon Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC), strukturë përgjegjëse për hartimin e politikave dhe procedurave për sigurimin e brendshëm të cilësisë, implementimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të sistemit të cilësisë në UGJ, mbështetur në standartet shtetërore të cilësisë [https://uogj.edu.al/kodi-cilesise/] dhe udhëzimeve Europiane për sigurimin e cilësisë në hapësirën Europiane të Arsimit të lartë. **[Evidenca VI.4, rregullore e NJSCB, neni 3; Evidenca VI.4.1, anëtarët e NJSBC]** |
| **Kriteri 3.** Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimimeve. | UGJ garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies dhe të vlerësimit të dijeve **[Evidenca I.1 Statuti i Universitetit Eqrem Çabej, neni 88, gërma h, neni 91, pika 5]**, pasi studentët luajnë një rol shumë të rëndësishëm në përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies.<br>Përfshirja e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve arrihet nëpërmjet:<br>• Pjesëmarrjes së studentëve në procesin e anketimit për cilësinë e mësimdhënies në lëndët e çdo programi studimi<br>• Pjesëmarrjes së studentëve nëpërmjet përfaqësuesve të tyre në organet në nivel institucional dhe gjithashtu në organe në nivel njësie kryesore. **[Evidenca I.1 Statuti i Universitetit Eqrem Çabej, neni 88, pika 1 gërma b]**<br>• Pjesëmarrjes së studentëve në Grupet e vlerësimit të brendshëm të programeve të studimit **[Evidenca V.4.1 Urdhër për ngritjen e grupit të vlerësimit brendshëm të programit të studimit MP në Turizëm, në NJBPET]**<br>• Garantimit të së drejtës së studentit për ankimimin e rezultatit të vlerësimit të dijes sipas procedurës së përcaktuar në Rregulloren e studimeve në UGJ **[Evidenca I.6 Rregullore e studimeve ne UGJ, Neni 88]** |
| **Kriteri 4.** Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit. | SSCK mbështetur në Statutin e UGJ **[Evidenca I.1 Statuti i Universitetit Eqrem Çabej, neni 94, pika 5, gërma h,]** hartojnë dhe bëjnë publike rezultatet e vlerësimit duke identifikuar pikat e forta dhe të dobëta, së bashku me rekomandimet përkatëse. **[Evidenca III.6 Raport mbi rezultatet e pyetesorit studentor]** |

| | |
|---|---|
| | UGJ nëpërmjet faqes zyrtare web [https://uogj.edu.al/transparenca/; **[Evidenca VI.5 Vendimi i Senati Akademik për miratimin e programit të transparencës 2021; Evidenca VI.5.1 Vendimi i Senati Akademik për miratimin e programit të transparencës 2023 i rishikuar]** pasqyron në mënyrë trasparente dhe bën publike politikat, strategjinë, organizimin dhe veprimtaritë për studentët dhe të gjithë të interesuarit. në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë **[Evidenca I.14.4 Raporti vjetor UGJ viti akademik 2021-2022; Evidenca I.14.10 Raport vjetor FE 2021-2022; Evidenca I.14.4 Raporti i veprimtarisë mësimore shkencore NJBPET 2021-2022]** |
| **Kriteri 5.** Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies. | UGJ, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.<br>Të dhënat e pasqyruara nga mekanizmat e vlerësimit **[Evidenca VI.3 Raport vjetor i Sektorit të Standarteve të Cilësisë dhe Kurrikulave 2021-2022; Evidenca VI.3.1 Raport vjetor i Sektorit të Standarteve të Cilësisë dhe Kurrikulave 2020-2021; Evidenca I.14.2 Raporti vjetor UGJ viti akademik 2020-2021; Evidenca I.14.4 Raporti vjetor UGJ viti akademik 2021-2022; Evidenca I.14.8 Raport vjetor FE 2020-2021; Evidenca I.14.10 Raport vjetor FE 2021-2022; Evidenca I.14.13 Raport vjetor NJBPET 2020-2021; Evidenca I.14.14 Raport vjetor NJBPET 2021-2022]** shërbejnë si istrument i rëndësishëm për përmirësimin e veprimtarive mësimdhënëse dhe kërkimore shkencore të personelit akademik.<br>Këto rezultate nxitin personelin akademik për përmirësimin e veprimtarive të tyre mësimdhënëse dhe kërkimore shkencore nëpërmjet zhvillimit të kapaciteteve didaktike dhe kërkimore shkencore, përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies, përmirësimit të aftësive të mësimdhënies, përdorimit të metodave dhe teknologjive bashkëkohore mësimdhënëse etj. |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi VI.2**<br>**Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale. | UGJ, mbështetur në Ligjin e Arsimit të Lartë Nr. 80/2015, Neni 103, Institucioni ka hartuar politika si dhe ka ngritur struktura në funksion të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. **[Evidenca I.2 Strategjia e zhvillimit të UGJ 2020-2025]**<br>Në UGJ funksionon dhe Njësia e Sigurimit të Brendshëm të cilësisë (NJSBC) si strukturë përgjegjëse për hartimin e politikave dhe procedurave për sigurimin e brendshëm të cilësisë, implementimit dhe përmirësimit të vazhdueshëm të sistemit të cilësisë në UGJ, mbështetur në standartet shtetërore të cilësisë (Kodin e cilësisë në arsimin e Lartë) dhe udhëzimeve Europiane për sigurimin e cilësisënë hapësirën Europiane të Arsimit të lartë. **[Evidenca VI.4 Rregullore e NJSBC, neni 3; Evidenca VI.4.1 Anetarët e NJSBC]**<br>Në Statutin e UGJ **[Evidenca I.1 Statuti i Universitetit Eqrem Çabej, Neni 94]** si dhe Rregulloren e NJSCB **[EvidencaVI.4 rregullore e NJSCB, neni** |


Geshkepijaj

| | |
|---|---|
| | **5,6,7]** përcaktohen qartë politikat dhe procedurat për për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.<br>Në UGJ funksionon Sektori i Standarteve të Cilësisë dhe Kurrikulave **[Evidenca I.1 Statuti i Universitetit Eqrem Çabej, Neni 93]** strukturë përgjegjëse për realizimin dhe sigurimin e vazhdueshëm të cilësisë së mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe zhvillimin cilësor të UGJ **[Evidenca I.11 Organograma e Universitetit Eqrem Çabej]**<br>Në Statutin e UGJ **[Evidenca I.1 Statuti i Universitetit Eqrem Çabej, neni 94, pika 5]** përcaktohen qartë politikat dhe funksionet e Sektorit të Standarteve të Cilësisë dhe Kurrkulave. Ky sektor monitoron në mënyrë të vazhdueshme dhe vlerëson, periodikisht, rezultatet e veprimtarisë mësimore dhe kërkimore shkencore, e cila ka sjellë cilësi dhe përmbushje të standardeve në këtë program studimi **[Evidenca III.5 Pyetësor Studentor; Evidenca II.22 Informacion mbi analizen e përshtashmërisë së kurrikulave; Evidenca III.6 Raport mbi rezultatet e pyetesorit studentor; Evidenca VI.3 Raport vjetor i sektorit të Standarteve të Cilësisë dhe Kurrikulave 2021-2022; Evidenca VI.3.1 Raport vjetor i Sektorit të Standarteve të Cilësisë dhe Kurrikulave 2020-2021; Evidenca VI.3.2 Plani vjetor i Sektorit të Standarteve të Cilësisë dhe Kurrikulave 2022-2023]** |
| **Kriteri 2.** Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm. | UGJ, ka ngritur sistemin e brendshëm të sigurimit të cilësisë ( Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, Sektori i Standarteve të Cilësisë dhe Kurriculave, Fakultetet, Njësitë bazë), i cili zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë dhe bashkëpunon me aktorë të ndryshëm **[Evidenca I.2 Strategjia e zhvillimit të UGJ 2020-2025]** ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.<br>Në bazë të Rregullores se NJSBC, **[Evidenca VI.4 rregullore e NJSBC, neni 4]** Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë është strukturë pranë Rektoratit. Ajo përbëhet nga 7(shtatë) anëtarë, 4(katër) anëtarë janë përfaqësues të personelit akademik të njësive kryesore, 2(dy) përfaqësues administrativ (zyra e kurrikulave dhe kërkimi shkencor) dhe 1(një) përfaqësues studentor.<br>Në bazë të Statutit të UGJ **[Evidenca I.1 Statuti i Universitetit Eqrem Çabej, Neni 96, pika 2]** për vlerësimin e brendshëm të programeve të studimit dhe kërkimit shkencor apo vlerësimin e brendshëm institucional përfshihet një përfaqësues nga organizata studentore.<br>Si pjesë e strategjisë institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, është edhe përfshirja e bashkëpunëtorëve dhe ekspertëve të jashtëm nëpërmjet marrëvëshjeve të ndryshmë të bashkëpunimit, aktiviteteve dhe eventeve të ndryshme të zhvilluar në bashkëpunim me studentët dhe aktorë të tjerë nga tregu i punës, duke ndarë eksperiencat, konsultuar dhe marrë parasysh propozimet e tyre **[Evidenca I.18 Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit të UGJ; Evidenca II.21.1 Informacion nga Zyra e Alumnit dhe Këshillimit të Karrierës].** |
| **Kriteri 3.** Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë | Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë. Në funksion të sigurimit të cilësisë, UGJ ka realizuar me sukses procesin e Sigurimit të Jashtëm të Cilësisë. UGJ-ja ka marrë akreditimet periodike institucionale, me Vendim Nr.67, datë 21.09.2017 dhe Vendim Nr.55, datë 16.12.2021 të Bordit të Akreditimit të ASCAL. **[https://uogj.edu.al/vendim-i-ba-dhe-crtifikata-e-akreditimit/; Evidenca I.9 Vendim i Akreditimit Institucional periodik; Evidenca I.9.1 Miratimi i planit të veprimit për rekomandimet e** |


Gjeshkëpijaj

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| në programin e studimit. | **akreditimit; Evidenca I.9.2 Plani i veprimit]** Gjithashtu, UGJ-ja përveç akreditimit institucional iu nënshtrua edhe vlerësimit nëpërmjet Sondazhit Kombëtar të Studentëve 2019 dhe 2022, rezultatet e të cilit janë bërë publike prej ASCAL. **[Evidenca VI.2. Procedura për zhvillimin me sukses të Sondazhit Kombëtar të studentëve].** | | | |
